المؤسسة الإسلامية للشباب

# Fondacioni i Rinisë Islame
# Stiftung der Islamischen Jugend
# Foundation of Islamic Youth

---

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ

Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

# FRANKMASONERIA GLOBALE

## Harun Yahya

Botuar nga: e pabotuar

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë autorit

PËR LEXUESIN ... 6
HYRJE ... 8
I NGA TAMPLIERËT DERI NË EGJIPTIN E VJETËR KRYQËZATAT (LUFTA E KRYQËZATAVE) ... 11
TAMPLIERËT ... 14
TAMPLIERËT DHE KABALA ... 19
MAGJISTARËT E EGJIPTIT TË VJETËR ... 23
BESIMI I EGJIPTASËVE TË VJETËR NË EVOLUCIONIN MATERIALIST ... 26
-II- HISTORIA E FSHEHTË E KABALAS ... 29
VIÇI I ARTË ... 30
NGA EGJIPTI I VJETËR DERI TEK KABALA ... 33
DOKTRINAT PAGANE QË HYNË NË TORA ... 36
KABALA- DOKTRINË E KUNDËRT E KREACIONIZMIT ... 39
NGA TAMPLIERËT DERI TEK MASONËT ... 43
III RISHQYRTIMI I HUMANIZMIT ... 47
RRËNJËT E HUMANIZMIT NË KABALA ... 57
HUMANIZMI MASONIK: ADHURIMI I HUMANIZMIT ... 62
TEORIA E MORALIT HUMANIST ... 65
QËLLIMI I MASONËVE: THEMELIMI I NJË BOTE HUMANISTE ... 71
IV RISHIKIMI I MATERIALIZMIT ... 77
MASONËT DHE EGJIPTI I VJETËR ... 78

SIMBOLET E EGJIPTIT TË VJETËR NË LLOZHAT MASONIKE ..... 82
PIRAMIDA NËN SYRIN ..... 84
KUPTIMI MASONIK I YLLIT GJASHTËCEPËSH ..... 85
SHTYLLA E DYFISHTË ..... 86
TERMINOLOGJIA EGJIPTIANE E LLOZHAVE ..... 87
"FYELLI MAGJIK" NGA MOCARTIT ..... 88
OBELISKËT ..... 89
LEGJENDA E IZISIT- VEJUSHËS ..... 89
KOMPASI DHE TREKËNDËSHI ..... 90
FILOZOFIA PAGANE E MASONERISË ..... 91
MATERIALIZMI NË BURIMET MASONIKE ..... 93
BESIMI NË MATERIEN ABSOLUTE ..... 93
MOHIMI I EKZISTIMIT TË SHPIRTIT ..... 97
DHE BOTËS SË ARDHSHME ..... 97
MOSPAJTIMI SHKENCOR I MOHIMIT TË EKZISTIMIT TË SHPIRTIT ..... 100
MATERIALIZMI MASONIK: HYJNIZIMI I MATERIES ..... 103
V RISHQYRTIMI I TEORISË SË EVOLUCIONIT. ..... 108
MITI I EVOLUCIONIT, NGA GREQIA ANTIKE DERI NË EUROPËN MODERNE ..... 109
ILUMINIZMI DHE SHFAQJA E MITIT TË TEORISË SË EVOLUCIONIT ..... 114
ERASMUS DARWINI ..... 116

MASONËT DHE FILOZOFIA NATYRALISTE ..... 118
TEORIA MASONIKE E ORIGJINËS SË JETËS ..... 123
DOGMATIZMI DHE TRADICIONALIZMI MASONIK ..... 128
VI LUFTA MASONIKE KUNDËR RELIGJIONIT ..... 134
SHEMBULLI I LOZHËS MASONIKE: "KLUBI I FERRIT" ..... 136
FUSHATA ANTIFETARE NË GJERMANI: "*KULTURKAMPF*" ..... 146
LUFTA KUNDËR RELIGJIONIT NË ITALI ..... 148
AGJENDA E REVOLUCIONEVE MASONIKE ..... 151
MASONERIA E SHEKULLIT NJËZET: E HESHTUR DHE E LARGËT ..... 153
PËRFUNDIM ..... 157

## PËR LEXUESIN

Në të gjitha librat e autorit, çështjet që kanë të bëjnë me religjionin janë shpjeguar nën dritën e ajeteve të Kur'anit famëlartë, kështuqë njerëzit janë të ftuar që të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë me to. Të gjitha temat që kanë të bëjnë me ajetet kuranore janë të spjeguara në atë mënyrë saqë nuk lënë vend për dyshim apo paqartësi në mendjen e lexuesit. Stili i sinqertë, i çiltër dhe i rrjedhshëm i përdorur bën që çdokush i çfardo moshe dhe prej secilit grup shoqëror mund t'i kuptojë librat me shumë lehtësi. Tregimi efektiv dhe kthjelltë bën që librat të lexohen me një frymë. Bile edhe ata që në mënyrë rigoroze e kanë mohuar natyrën shpirtërore janë ndikuar nga faktorët që hasen në këto libra dhe nuk mund të hedhet poshtë e vërteta e përmbajtjes së tyre.

Kjo libër dhe të gjitha veprat e Harun Jahjasë mund të lexohen individualisht apo të diskutohen në grup.

Ata lexues që dëshirojnë të përfitojnë nga këto libra do të bëjnë debat të frytshëm mund të tregojnë mendimet dhe përjetimet e veta edhe tjetërkujt.

Përveç kësaj, është një shërbim i madh i religjionit që të prezanton dhe të shpërndaj këto libra, të cilat janë shkruar vetëm e vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit. Të gjitha librat e autorit janë skajmërisht bindëse, kështuqë, për ata që dëshirojnë të komunikojnë religjionin njerëzve tjerë, njëra ndër metodat më efektive është që të inkurajohen me leximin e këtyre librave.

Shpresohet se lexuesi do të ketë kohë që të shikojë në prezentimet e shkurta të librave tjerë në faqet e fundit të kësaj libre, dhe të vlerësoj burimin e pasur të çështjeve që kanë të bëjnë me fenë, që janë shumë të dobishme dhe lexohen me kënaqësi.

Në këto libra, dikush nuk mund të gjej sikurse në disa libra tjerë, pikëpamjet personale të autorit, shpjegime të bazuara në burime të dyshimta, stile jorespektuese dhe jonderuese sa i përket temave të shenjta, apo vlerësim i pashpresë, krijim të dyshimit dhe pesimizëm që shkakton vetëm devijime në zemër.

# HYRJE

Frankmasoneria është temë që ka ngjallur diskutime të shumta gjatë shekujve. Disa kanë akuzuar Masonerinë për krime dhe keqbërje përrallore. Në vend që të përpiqen që t'a kuptojnë "vëllazërinë" dhe t'a kritikojnë atë në mënyrë objektive, kritikën ndaj organizatës e kanë ashpërsuar deri në armiqësi. Nga ana e tyre, masonët kanë thelluar edhe më shumë heshtjen e tyre tradicionale ndaj këtyre akuzave, duke preferuar që të prezentojnë veten e tyre si një klub i zakonshëm shoqëror- çfarë në të vërtetë ata nuk janë.

Kjo libër përmban shpjegim korrekt të Masonerisë si një shkollë filozofike ku ndikimi më i rëndësishëm për bashkim ndër masonët është filozofia e tyre- që më së miri mund të përkufizohet me termet, si "materializëm" dhe "humanizëm laik". Por, në të vërtetë kjo është një filozofi e çoroditur e bazuar në supozimet falso dhe është një teori me defekte. Kjo është pika themelore fillestare nga e cila duhet të kritikohet masonizmi. Është me rëndësi të ceket që në fillim se kriticizmi i tillë është i rëndësishëm, jo vetëm që të informohen jo-masonët mbi këtë çështje, por gjithashtu edhe t'i ftojë vetë masonët që të shohin të vërtetën. Natyrisht, masonët, si çdokush tjetër janë të lirë të zgjedhin, dhe mund të marrin cilëndo pikëpamje globale që dëshirojnë dhe të jetojnë sipas asaj pikëpamjeje. Kjo është e drejtë e tyre natyrale. Por edhe të

tjerët gjithashtu kanë të drejtë që t'i tregojnë gabimet e tyre dhe t'i kritikojnë, çka është edhe synimi i këtij libri.

Ne bëjmë gjithashtu çasjen e njejtë në kriticizmin tonë edhe ndaj bashkësive tjera,. Sikurse ndaj çifutëve, p.sh. Kjo libër, pjesërisht, merret me historinë e çifutëve dhe ofron kriticizëm mjaft i rëndësishëm. Duhet të ceket se kjo fare nuk ka të bëjë me anti-semitizëm apo teori e fshehtë të "judeo-masonizmit". Në të vërtetë, antisemitizmi është një gjë e huaj për muslimanin e vërtetë: Çifutët janë ata që për një kohë kanë qenë popull i zgjedhur i Zotit dhe u janë dërguar shumë profetë. Gjatë historisë ata vuajtën shumë mizori, bile kanë qenë të ekspozuar edhe gjenocidit, por ata kurrë nuk e mohuan identitetin e tyre. Në Kur'an, Zoti i quan ata, së bashku me të krishterët, njerëzit e Librit, dhe urdhëron muslimanët që të sillen mirë dhe drejt me ta. Por, një pjesë e domosdoshme e kësaj drejtësie është që të kritikohen besimet dhe veprimet e çoroditura të disave prej tyre, ashtuqë t'u tregohet atyre rruga e vërtetë. Por natyrisht, e drejta për të jetuar sipas besimit të caktuar është jashtë çdo diskutimi.

Libri Frankmasoneria Globale shpalos nga kjo hyrje, dhe hulumton rrënjët e Masonerisë, si dhe qëllimet dhe aktivitetet e saj. Në këtë libër, lexuesi do të gjej edhe përmbledhjen e historisë së luftës së masonëve kundër feve. Masonët kanë luajtur rol të rëndësishëm në distancimin e Europës nga feja, dhe në vend të saj, formuan rend të ri të bazuar në filozofitë e materializmit dhe humanizimit laik. Gjithashtu do të shohim se Masonizmi ka ndikuar në imponimin e këtyre dogmave edhe në qytetërimet joperëndimore.

Më në fund, do të debatojmë për metodat e Masonerisë që janë përdorur për të ndihmuar themelimin dhe përjetësimin e një rregulli shoqëror të bazuar në këto dogma. Filozofia dhe

metodat e tyre që i përdorin për të themeluar këtë filozofi do të nxirren në shesh dhe do të kritikohen.

Shpresohet se faktet e rëndësishme në lidhje me këtë libër do të jenë mjete me të cilat shumë njerëz, duke përfshirë edhe masonët, që do të mundësohet të shohin botën me një sy më të mirë.

Pas leximit të këtij libri, lexuesi do të jetë në gjendje që t'a vras mendjen për shumë çështje, që nga shkollat filozofike deri tek titujt kryesorë të gazetave, nga rok këngët deri tek ideologjitë politike, me një kuptim më të thellë, njohje më të mirë të kuptimeve dhe qëllimeve pas ngjarjeve dhe faktorëve.

# I

# NGA TAMPLIERËT DERI NË EGJIPTIN E VJETËR

## KRYQËZATAT (LUFTA E KRYQËZATAVE)

Mendim i përbashkët i shumicës së historianëve të Frankmasonerisë është se origjina e organizatës rrjedh nga Kryqëzatat. Në fakt, edhepse Masonizmi zyrtarisht ishte i themeluar dhe i pranuar vetëm në Angli në fillim të shek. 18-të, rrënjët e organizatës zejnë fill gjatë kryqëzatave nga shek.12-të. Në qendër të këtij tregimi të njohur është një rend i kryqëzatave i quajtur Tamplierët Kalorës (The Knights Templar) apo vetëm Tamplierët.

Gjashtë vjet para kësaj vepre, libri ynë i titulluar "Rendi i ri i Masonëve", ka shtjelluar historinë e Tamplierëve në mjaft hollësi. Për këtë shkak, tani do të japim vetëm një përmbledhje. Duke analizuar rrënjët e Masonerisë dhe ndikimit të saj në botë, zbulohet kuptimi i fjalës "Frankmasoneria globale".

Pa marrë parasysh se nëse dikush këmbëngul në atë se kryqëzatat ishin në të vërtetë ekspedita ushtarake që bëheshin në emër të fesë së krishterë, në të vërtetë, kanë qenë të ndërmarra për përfitime materiale. Në kohën kur Europa ishte duke përjetuar urinë dhe mjerimin më të madh gjatë historisë së saj, në Lindje lulëzonte përparimi dhe pasuria sidomos tek muslimanët në Lindjen e Mesme, e që ishin karrem për europianët. Kjo tendencë duke marrë pamje religjioze, e

zbukuruar me simbole të krishterizmit; edhepse, në të vërtetë, idea për Kryqëzata ka lindur nga dëshira për përfitime të kësaj bote. Kjo ishte arsyeja për ndryshim të papritur ndër të krishtarët europianë nga politikanët e tyre të mëhershëm që ishin paqësore, në një agresion ushtarak.

Themelues i luftërave të Kryqzatave ishte Papa Urbani II. Ai thirri Këshillin e Clermontit në vitin 1095, në të cilën ish-doktrina pacifiste e krishterë u lë anash. Lufta e shenjtë ishte thirrur për qëllim që të rrëmbejnë tokat e shenjta nga muslimanët. Duke pasuar Këshillin, një armatë e madhe e luftëtarëve të Kryqzatave u formua, e përbërë nga ushtarët profesionalë dhe me dhjetëra mijëra njerëz.

Historianët besojnë se aventura e Papës Urban II kishte lindur nga dëshira e tij që të pengojë konsolidimin e kundërshtarit të tij për Papë. Përveç kësaj, derisa mbretërit europianë, princërit, aristokroatët dhe të tjerët përshëndetën thirrjen e Papës me kënaqësi, qëllimet e tyre ishin kryesisht të zakonshme. Ashtu siç shprehet Donald Queller nga Universiteti në Illinois; kalorësit francezë dëshironin më shumë hapsirë të tokës. Tregtarët italianë shpresonin t'a zgjeronin tregtinë edhe në portet e Lindjes së Mesme. Numër i madh i të varfërve iu bashkangjitën ekspeditave vetëm për shkak se të largohen nga jeta e vështirë e tyre." 1 Gjatë rrugës, kjo masë lakmitare heqte kokat e shumë muslimanëve, bile edhe të çifutëve, me shpresë se do të gjejnë arin dhe stoli. Luftëtarët e kryqëzatave bile bile u kanë çarë barkun atyre që i kanë vrarë ashtuqë të gjenë arin dhe gurët e çmuar që viktimat kanë mundur t'i përpinin para se të vdisnin. Lakmia materiale ishte aq e madhe saqë fare nuk i brente ndërgjegja gjatë plaçkitjes së Konstantinopolit (Stambollit të sotëm) që atëherë ishte qytet i krishterë gjatë Kryqëzatës së Katërt, kur ata zhveshnin shtresën e arin nga freskat e krishtera në Aja Sofi.

Pas udhëtimit të gjatë dhe të vështirë, pas shumë plaçkitjeve dhe masakrave ndaj muslimanëve, kjo hordhi e egër të quajtur Luftëtarë të Kryqëzatave arrinë në Jerusalem në vitin 1099. Kur qyteti u mposht pas rrethimit prej afër 5 javësh, luftëtarët e kryqëzatave arrijnë të hyjnë brenda në të. Ata treguan egërsi të ashpër që bota kurrë ndonjëherë nuk ka pasur rastin t'a shoh. Të gjithë muslimanët dhe çifutët ishin vën nën tehun e shpatës. Sipas fjalëve të një historiani. Thuhet se: "Ata vranë të gjithë Saraçenët (arabët) dhe turqit që i ka në gjetur... si meshkujt ashtu edhe femrat" 2 Njëri ndër luftëtarët e Kryqëzatave, Raymond of Aguiles, bile edhe mburret me këtë ashpërsi të paparë:

"Aty mund të shiheshin pamje të bukura. Disa nga njerëzit tanë (e kjo ishte gjëja më e mëshirshme) kanë këputur kokat armiqëve të tyre; tjerët i kanë gjuajtur me shigjeta, ashtuqë binin nga kështjellat; tjerët i torturonin më gjatë duke i hedhur në flakë. Grumbuj të mëdhenj të kokave, duarve dhe këmbëve mund të vëreheshin nëpër rrugët e qytetit. Ishte e pamundur që të gjesh ndonjë rrugë të kalueshme nga trupat e njerëzëve dhe kujave. Por këto ishin gjëra të imta në krahasim me çfarë ndodhi në Tempullin e Solomonit, vend ku shërbimet fetare zhvilloheshin normalisht... në Tempullin dhe oborrin e Solomonit, njerëzit laheshin në gjakun që arrinte deri në gjunj. 3

Për dy ditë armata e Kryqëzatave vranë nja 40.000 muslimanë në mënyrën më barbare. 4 Luftëtarët e Kryqëzatave bënë Jerusalemin kryeqytet të vetin dhe themeluan Mbretërinë Latine që shtrihej që nga kufiri me Palestinën e deri në Antioch.

Më vonë, luftëtarët e Kryqëzatave inicuan një luftë në mënyrë që të mbajnë pozitën e tyre në Lindjen e Mesme. Në mënyrë që të mbajnë shtetin që e formuan, ishte e nevojshme që ai disi të organizohej. Në fund, ata themeluan njësinë ushtarake, që nuk kishte ekzistuar kurrë më parë.

Antarët e këtyre njësiteve vinin nga Europa në Palestinë dhe jetonin në një lloj manastiri ku bënin ushtrime ushtarake dhe pregaditeshin të luftonin kundër muslimanëve.

Një njësi nga kjo ushtri, në veçanti, ndryshonte nga të tjerat. Ajo pësoi transformim që do të ndikojë dukshëm edhe në rrjedhat historike. Ky rend (njësi) ishte Tamplierët.

## TAMPLIERËT

Tamplierët apo emri i tyre i plotë Bashkëluftëtarët e varfër të Jezu Krishtit dhe Tempulli i Solomonit (The Poor Fellow-Soldiers of Jesus Christ and the Temple of Solomon), ishte formuar në vitin 1118, apo, 20 vite pasi luftëtarët e Kryqëzatave pushtuan Jerusalemin. Themeluesit e rendit ishin dy kalorës francezë, Hugh de Payens dhe Godfrey de St. Omer. Në fillim ishin 9 antarë, por rendi vazhdimisht rritej. Arsyeja që ata emëroheshin sipas Tempullit të Solomonit ishte vendi që ata zgjodhën për bazë, e ai ishte bazamenti i Tempullit ku gjindeshin mbeturinat e Tempullit. Ishte lokaliteti i njejtë ku gjindeshin edhe Kubeja (Koka) e Shkëmbit (Dome of the Rock) apo (Qubbet as-Sakhrah).

Tamplierët u vetëquajtën “luftëtarë të varfër”, por për një kohë shumë të shkurtër u bënë shumë të pasur. Pelegrinët e krishterë, që vinin nga Europa në Palestinë, ishin nën kontroll të plotë të këtij rendi, e që me të hollat e tyre ata u bënë shumë të pasur. Përpos kësaj, ata për herë të parë rregulluan sistemin e çeqeve dhe kredive, të ngajshëm me atë bankar. Sipas autorëve britanikë, Michael Baigent dhe Richard Leigh, ata themeluan një tip të kapitalizmit mesjetar; dhe bënë nismën e mënyrës moderne të veprimtarisë bankare përmes transakcioneve të tyre me bazë interesi. 5

Tamplierët ishin ata që bartinin përgjegjësinë më të madhe për sulmet e luftëtarëve të kryqëzatave ndaj muslimanëve dhe vrasjen e tyre. Për këtë shkak, komandanti më i madh islamik Saladini, që e mposhti armatën e kryqëzatave më 1187, në betejën e Hattinit e që pastaj e çliroi edhe Jerusalemin, ku mëpastaj dënoi për vdekje Tamplierët për krimet e bëra, edhepse pëkundër kësaj ai përndryshe fali edhe një numër të madh të krishterëve. Edhepse humbën Jerusalemin dhe patën dëme të mëdha, Tamplierët vazhduan së ekzistuari. Dhe, përkundër zvoglimit të pranisë së krishterëve në Palestinë, ata e shtuan fuqinë e tyre në Europë, së pari në Francë e pastaj edhe në vendet tjera, duke u bërë shtet përbrenda shtetit.

Nuk ka dyshim se fuqia e tyre politike bëri që të shqetësohen edhe monarkët e atëhershëm europianë. Por ishte edhe një aspekt tjetër i Tamplierëve, ata gjithashtu shqetësuan edhe klerin: rendi gradualisht heqte dorë nga feja e krishterë dhe derisa ishin në Jerusalem, adoptuan një varg doktrinash të çuditshme mistike. Flitej se organizonin edhe rituale të çuditshme në mënyrë që t’i japin formë këtyre doktrinave.

Më në fund, më 1307, mbreti francez Philip Le Bel vendosi që t'i arrestojë antarët e rendit. Disa nga ata arritën që të ikin por shumica e tyre u kapën. Papa Klementi V iu bashkangjit spastrimit. Pas gjykimit të gjatë, shumë Tamplierë pranuan se ishin heretikë, kishin refuzuar fenë e krishterë dhe kanë ofenduar Jezunë në meshat e tyre. Përfundimisht, udhëheqësit e Tamplierëve që veten e quanin "grandmasters" apo "kryetarë të urdhërit", duke filluar që nga kryesori i tyre, Jacques de Molay, ekzekutohen më 1314 me urdhërin e Kishës dhe mbretit. Shumica e tyre u futën në burg, ashtuqë rendi u shpërbë dhe zyrtarisht pushojnë së ekzistuari.

Disa historianë kanë tentuar që t'a paraqesin gjykimin e Tamplierëve si komplot nga ana e mbretit të Francës dhe përshkruanin kalorësit si të pafajshëm ndaj akuzave. Por, ky lloj interpretimi dështon në disa aspekte. Nesta H. Webster, historiane e famshme britanike me njohuri të mëdha për historinë okulte (dukurive të jashtënatyrshme), analizon këto aspekte në librin e saj "Shoqëritë sekrete dhe lëvizja subverzive (armiqësore)" (Secret Societies and Subversive Movement). Sipas Webster tentativa për shfajsimin e Tamplierëve nga herezia që ata e kishin pranuar gjatë kohës së gjykimit është e pabazë. Së pari, gjatë marrjes në pyetje, përkundër pohimeve standarde, nuk janë torturuar të gjithë Tamplierët.

Sidoqoftë, pranimi i fajit nga ana kalorsëve del se është rezultat i imagjinatës së njeriut që mund të shpiket nën ndikimin e torturës? Është vështirë e besueshme se shpjegimet e ritualit të pranimit që janë të njohura në detale nga tregimet e njerëzëve nga vendet e ndryshme, ku tregojnë ngjajshmëri njëri me tjetrin, edhepse, në frazeologji të ndryshme, mund të jetë një trillim i pastër. A kanë qenë viktimat të shtyera që të trillojnë, ata sigurisht se do të ishin në kundërshtim me njëri tjetrin, dhe se janë ankuar në agoni se të gjitha llojet e ritualeve të egra dhe të pabesueshme janë bërë me të njejtin qëllim që të plotësojnë dëshirat e akuzuesëve të tyre. Por jo, secila del me

përshkrim të ceremonisë së njejtë pak a shumë kompakte, me hollësi karakteristike që tregon personalitetin e folësit dhe kryesisht të gjitha tregimet përputhen me njëra tjetrën. 6

Sidoqoftë, gjykimi i Tamplierëve përfundoi me shkatërrimin e rendit. Porse, edhepse rendi "zyrtarisht" pushoi së ekzistuari, në të vërtetë ai nuk u zhduk rrënjësisht. Gjatë arrestimit të papritur më 1307, disa Tamplierë ikën dhe arritën që t'i fshehin gjurmët. Sipas tezës së bazuar në dokumente të ndryshme historike, një numër i konsiderueshëm i tyre u shpërngulën në mbretërinë e vetme europiane që nuk e njihte autoritetin e Kishës Katolike në shek. e14-të, në Skoci. Atje, ata organizohen nën patronatin e mbretit të Skocisë, Robert the Bruce. Pas një kohe, ata gjetën një metodë të përshtatshme për maskim me të cilën ata vazhduan ekzistencën e tyre klandestine: ata u infiltruan në gilderinën (shoqatën) më të rëndësishme në Britaninë e mesjetës-lozhën (degën) e muratorve dhe përfundimisht ata morën nën kontroll këto llozha. 7

Llozha e muratorëve ndërroi emrin dhe në fillim të periudhës bashkëkohore, e quajnë veten "lozha masonike". Rituali skocez është dega më e vjetër e Masonerisë, ku i ka fillet në fillim të shek. të 14-të, nga Tamplierët që u arratisën në Skoci. Kështuqë, emrat e dhënë shkallëve më të larta në Ritualin Skocez janë titujt që u janë dhënë kalorsëve në rendin e Tamplierëve. Këta tituj përdoren edhe sot.

Shkurtimisht, Tamplierët nuk janë zhdukur, por filozofia, besimi dhe ritualet e tyre ende vazhdojnë nën maskën e Frankmasonerisë. Kjo tezë mbështetet në shumë fakte historike dhe është e pranueshme nga një numër i madh i historianëve perëndimorë, pa marrë parasysh a janë apo nuk janë frankmasonë. Në librin tonë "Rendi i ri masonik", e shtjelluam këtë çështje evidente në detale.

Teza që dërgon nga rrënjët e masonëve tek Tamplierët shpesh referohet nga revistat e publikuara nga masonët që iu dedikohen antarëve të vet. Masonët me të madhe e pranojnë këtë ide. Një revistë e tillë e quajtur Mimar Sinan (botim për masonët turq), shpjegon mardhënjen mes Rendit të Tamplierëve dhe Masonëve në këtë mënyrë:

Në vitin 1312, kur mbreti francez, nën presionin e Kishës mbylli Rendin e Tamplierëve dhe ia dha pasurinë e tyre kalorsëve të Shën Xhonit në Jerusalem, aktivitetet e Tamplierëve nuk pushuan. Shumica e Tamplierëve ikën në llozhat e frankmasonëve që ishin aktivë në Europë atë kohë. Udhëheqësi i Tamplierëve, Mebeignac, me disa antarë tjerë, gjetën strehim në Skoci, nën maskën e muratorit me emrin Mac Benach. Mbreti skocez, Robert the Bruce, i mirëpriti ata dhe iu lejoi që të ushtrojnë ndikim të madh mbi llozhat e masonëve në Skoci. Si rrjedhim, llozhat skoceze fituan rëndësi të madhe nga pikëpamja e mjeshtrisë dhe ideve të tyre.

Sot masonët përdorin emrin Mac Benach me respekt të madh. Masonët skocezë, që vazhduan trashëgiminë e Tamplierëve, u kthyen në Francë shumë vjet më vonë dhe themeluan atje bazën e ritualit të njohur si Rituali Skocez." 8

Prapë, Mimar Sinan paraqet vend me shumë informata rreth mardhënieve mes Tamplierëve dhe masonëve. Në artikullin me titull, "Tampliert dhe Masonët", thuhet se "ritualet e pranimit në Rendin e Tempularëve janë të ngjajshme me ato të frankmasonëve të sotëm." 9 Sipas artikullit të njejtë, sikur në Masoneri, antarët e Rendit të Tamplierëve e thërrasin njëri tjetrin "vëlla". 10 Nga fundi i artikullit, thuhet:

Rendi i Tamplierëve dhe organizatat e masonerisë kanë ndikuar në njëri tjetrin në një masë të konsiderueshme. Bile edhe ritualet e tyre janë aq të ngjajshme sikurse të ishin të kopjuara nga

Tamplierët në këtë aspekt, masonët në masë të konsiderueshme e identifikojnë veten si Tamplierë dhe mund të thuhet se çdo gjë që shihet si fshehtësi origjinale masonike në një masë të rëndësishme është trashëguar nga Tamplierët. Si përmbledhje, siç thamë në titullin e këtij eseu, mund të themi se pikënisja e artit mbretëror masonik dhe vija sekrete e pranimit që i takonte Tamplierëve dhe pika përfundimtare i takonte frankmasonëve. 11

Përfundimisht, themi se është e qartë se rrënjët e Frankmasonerisë zgjaten deri tek Rendi i Tamplierëve, dhe se masonët kanë adoptuar filozofinë e këtij rendi. Vetë masonët e kanë pranuar këtë. Por sigurisht, çështja kryesore për vlerësimin tonë është natyra e kësaj filozofie. Pse Tamplierët lanë anash krishterizmin dhe u bënë një rend heretik? Çfarë ndikoi në këtë? Pse ata pësuan ndryshim të tillë? Përmes veprimit të Masonerisë, çfarë ka qenë ndikimi në botë i kësaj filozofie marrë nga Tamplierët?

## TAMPLIERËT DHE KABALA

Libri i shkruar nga dy masonë Christopher Knight dhe Robert Lomas me titull "Çelësi i Hiramit" (Hiram Key) shpalos disa fakte të rëndësishme mbi rrënjët e Frankmasonerisë. Sipas këtyre autorëve, është evidente se masoneria është vazhdimësi e Tamplierëve. Përveç kësaj, autorët gjithashtu ekzaminuan origjinën e Tamplierëve.

Sipas tezës së tyre, Tamplierët pësuan ndryshim të madh derisa ishin në Jerusalem. Në vendin e krishterizmit, ata adoptuan doktrina tjera. Në zanafillë të kësaj gjendet një të fshehtë që ata e zbuluan në Tempullin e Solomonit në Jerusalem, nën gërmadhat e të cilit ata kërkonin.

Shkrimtarët spjegojnë se Tamplierët shtireshin dhe shfrytëzonin rolin e mbrojtësëve të pelegrinëve të krishterë që vizitonin Palestinën, por qëllimi i tyre i vërtetë ishte krejtësisht tjetër.

...Nuk ka fakte që Tamplierët ndonjë herë kanë mbrojtur pelegrinët, por bile shumë shpejt janë gjetur dëshmitë përfundimtare kur ata gërmuan nën gërmadhat e Tempullit të Herodit... 12

Autorët e "Çelësit të Hiramit" nuk ishin të vetmit që kishin gjetur dëshmi për këtë gjë. Historiani francez Geatan Delaforge pohon ngjajshëm:

Detyra e vërtetë e nëntë kalorsëve ishte që të bëjnë hulumtimin e rajonit ashtuqë të fusin në dorë reliktet dhe dorëshkrimet origjinale që përmbajnë thelbin e traditave sekretet të judaizmit dhe Egjiptit të vjetër. 13

Kah fundi i shek. të 19-të, Charles Wilson nga Inxhinierët Mbretërorë, filluan hulumtimet arkeologjike në Jerusalem. Ai arriti tek mendimi se Tamplierët kanë shkuar në Jerusalem që të studiojnë gërmadhat e tempullit. Wilsoni gjeti gjurmët e gërmimeve nën themelin e tempullit dhe erdhën në përfundim se këto gërmime janë bërë nga veglat që iu takonin Tamplierëve. Këto gjësende ende janë në koleksionin e Robert Brydonit, që posedon një arkivë të madhe të informatave sa i përket Tamplierëve. 14.

Autorët e "Çelësit të Hiramit" sjellin dëshmi se gërmimet e Tamplierëve nuk kanë qenë edhe pa rezultate; rendi zbuloi në Jerusalem relikte origjinale gjë që ndryshuan pikëpamjet e tyre të

përgjithshme në botë. Përveç kësaj, shumë hulumtues kanë mendim të njejtë. Ka qenë diçka që ka bërë që Tamplierët, pavarsisht nga fakti që ata më herët ishin të krishterë dhe të ardhur nga pjesa e krishterë botës, të adoptojnë një sistem krejtësisht tjetër nga ai i krishterë të besimit dhe filozofisë, të mbajnë mesha heretike dhe të kryejnë rituale të magjisë së zezë.

Sipas mendimeve të shumë hulumtuesëve, kjo "diçka" ishte KABALA. Domethënia e fjalës Kabala (Kabbalah) është "traditë gojore". Enciklopeditë dhe fjalorët e definojnë si degë mistike dhe sekrete e fesë çifute. Sipas këtij definicioni, Kabala hulumton domethënien e fshehtë të Torës (Tevratit) dhe shkrimeve tjera fetare çifute. Por, kur shqyrtojmë çështjen edhe më për së afërmi, do të dalin në shesh faktet e që janë diçka tjetër. Këto fakte n'a shpiejnë në përfundim se Kabala është një sistem që i ka rrënjët në idhujtarinë pagane; dhe që ka ekzistuar edhe para Torës dhe është përhapur në Judaizëm pas shpalljes së Torës.

Fakt interesant për Kabala, është spjeguar nga një burim mjaft interesant. Murat Ozgen, një mason turk, jep shpjegimin në librin e tij "Çka është Masoneria dhe si duket?" (Masonluk Nedir ve Nasildir?).

Nuk është e qartë se nga ka ardhur Kabala dhe si është zhvilluar ajo. Është emër i përgjithshëm në filozofinë unike, e përbërë metafizikisht, sekrete dhe mistike e lidhur veçanarisht me besimin çifut. Është pranuar si misticizëm çifut, por disa elemente tregojnë se është e përpiluar shumë më herët se Tora. 15

Historiani francez, Gougenot des Mousseaux, shpjegon se në të vërtetë Kabala është shumë më e vjetër se Judaizmi. 16

Historiani çifut, Theodore Reinach, thotë se Kabala është "helm tinzar që depërton në damarët e judaizmit dhe e pllakosë atë të tërin". 17 Salomon Reinach definon Kabalan si "njërin ndër lajthitjet më të dëmshme të mendjes njerëzore". 18

Arsyeja që Reinach pohon se Kabala është "njëra ndër lajthitjet më të dëmshme të mendjes njerëzore" është se kjo doktrinë jë pjesë të madhe të saj e ka të lidhur me magjinë. Për mijëra vjet, Kabala ka qenë njëri ndër gurthemelet e çdo-lloji të ritualeve magjike. Besohej se rabitë që kanë studiuar Kabalan, posedonin fuqi të madhe magjike. Gjithashtu, shumë joçifutë kanë qenë nën ndikimin e Kabalas dhe janë përpjekur që të praktikojnë magjinë duke përdorur doktrinat e saj.

Tentimet e fshehta që mbretëronin në Europë gjatë mesjetës së vonshme, veçanarisht që praktikohej nga alkimistët, rrënjët i kanë në njëfarë mase, në Kabala.

Gjë e çuditshme është se "judaizmi është fe monoteiste, e cila ka filluar me shpalljen e Torës, Moisiut (hz. Musës, paqja qoftë mbi të), por brenda në këtë religjion ekziston sistemi i quajtur Kabala, që aplikon praktikën e magjisë, gjë që ndalohet në fe. Faktet e paraqitura më lart, demostrojnë se Kabala në të vërtetë është një element që në Judaizëm ka hyrë nga jashtë.

Por, kush është burimi i këtij elementi?

Historiani çifut Fabre d'Olivet thotë se kjo ka ardhur nga Egjipti i vjetër. Sipas këtij shkrimtari, rrënjët e Kabalës shtrihen deri tek Egjipti i vjetër. Kabala është traditë që mësohet nga disa udhëheqës të izraelitëve në Egjiptin e vjetër dhe është transmetuar si traditë gojore prej gjeneratës në gjeneratë. 19

Për këtë shkak, duhet që të shikojmë në Egjiptin e vjetër ashtuqë të gjejmë origjinën themelore të zingjirit Kabala-Tamplierë- Frankmasonë.

## MAGJISTARËT E EGJIPTIT TË VJETËR

Egjipti i vjetër i faraonëve ishte njëra ndër qytetrimet më të lashta në botë. Ishte gjithashtu edhe njëra ndër qytetërimet më shtypëse. Monumentet përrallore që ende qëndrojnë mbi tokë që nga koha e Egjiptit të vjetër- piramidat, sfingat dhe obeliskët- janë ndërtuar nga qindra mijëra robër, të cilët kanë punuar deri në vdekje, nën kërcnimin dhe ulurimën e urisë. Faraonët, si sundues absolutë në Egjipt, dëshironin që t'a paraqitnin vetveten si zotëra dhe të adhuroheshin nga njerëzit si zotëra.

Njëra ndër burime tona për Egjiptin e Lashtë janë mbishkrimet e tyre. Këto janë zbuluar në shek. e 19-të, dhe pas një pune intenzive, ishte deshifruar alfabeti egjiptian, duke hedhur më shumë në dritë mbi informata e këtij vendi. Por pasi mbishkrimet ishin të shkruajtur nga historianët shtetërorë të vendit, ato ishin të mbushura me të dhëna që lavdërojnë shtetin.

Për ne, natyrisht, burimi më i sigurtë për këtë çështje është Kur'ani.

Në Kur'an, në tregimin mbi Musanë (Moisiun) ekzistojnë informata të rëndësishme për sistemin e Egjiptit. Ajetet zbulojnë se atje ishin dy pika qëndrore të qeverisë në Egjipt: faraoni dhe Këshilli i tij i brendshëm. Ky Këshill synonte që të ketë ndikim më të fortë mbi faraonin; pasiqë faraoni

shpesh këshillohej me të dhe kohë pas kohe ai dëgjonte edhe sygjerimet e tyre. Ajeti i poshtë shënuar tregon ndikimin që ky Këshill kishte në faraonin:

Musai tha: O faraon, s'ka dyshim, unë jam i dërguar prej Zotit të botëve".

Është dinjitet për mua ta them për All-llahun vetëm të vërtetën. Unë u kam ardhur me argumente nga Zoti juaj, lejoi pra beni israilët të vijnë me mua!"

Ai (faraoni) tha: "Nëse ke ardhur me ndonjë argument, dhe nëse je ai që thua, na trego pra atë argument".

Ai (Musai) e hodhi shkopin e vet, kur ja, u shfaq gjarpër i vërtetë.

Dhe e nxori dorën e vet, kur qe, për shikuesit dritë e bardhë.

Rrethi i parisë nga populli i faraonit tha: "Ky nuk është tjetër pos magjistar i përsosur".

Ai dëshiron t'ju nxjerrë prej tokës suaj: "E çka më urdhëroni (propozoni ju)?"

Ata (krerët) thanë: "Ndale atë dhe vëllain e tij, e dërgo nëpër qytete tubues (të magjistarëve).

Të sjellin çdo magjistarë të dijshëm (të aftë).

Kur’an (7: 104-112)

Mund të vërehet qartë se Këshilli që këshillonte faraonin e nxiste atë kundër hs. Musës, dhe i rekomandonin atij metoda të caktuara. Nëse shikojmë në shënimet nga historia egjiptase, vërejmë se dy komponenete themelore të këtij këshilli ishin armata dhe priftërinjtë.

Nuk ka nevojë që të shpjegohet rëndësia e armatës; ajo përbëhej nga forca ushtarake e regjimit të faraonëve. Por, duhet shikuar për së afërmi rolin e priftërinjëve.

Priftërinjtë në Egjiptin e vjetër ishin klasë që në Kur'an referohen si magjistarë. Ata paraqesin kultin që përkrahej nga regjimi. Besohej se ata kishin fuqi të veçantë dhe se posedonin njohuri të fshehta. Me këtë autoritet ata ndikonin në egjiptasit dhe siguronin pozitë brenda administratës së faraonëve. Kjo klasë, e njohur nga shënimet e Egjiptit si "Priftërinjët e Amonit", përqëndronte vëmendjen në praktikimin e magjisë dhe në qeverisjen me anë të kultit të tyre pagan; dhe përveç kësaj, ata gjithashtu studionin edhe shkenca të ndryshme si astronominë, matematikën dhe gjeometrinë.

Klasa e priftërinjëve ishte një rreth i mbyllur që posedonte (siç mendonin ata) dituri të veçantë. Rendet e tilla përgjithsisht njiheshin si organizata sekrete. Në revistën e quajtur Mason Dergisi (Gazeta e masonëve), publikim që u shpërndahet masonëve turq tregon se rrënjët e frankmasonizmit gjenden tek këto rende sekrete, dhe vëmendja përqëndrohet tek priftërinjtë e Egjiptit të vjetër:

Pasi mendja zhvillohet tek qeniet njerëzore, zhvillohet njëkohësisht edhe shkenca, e me zhvillimin e shkencës, rritet edhe numri i fshehtësive brenda traditës së sistemit sekret. Në këtë zhvillim, ky projekt i fshehtë, që fillon në Lindje, Kinë dhe Tibet, mandej përhapet edhe në Indi, Mesapotami dhe Egjipt, formon bazën e njohurisë së priftërinjëve që është praktikuar me mijëra vjet dhe formonte themelin e fuqisë së priftërinjëve në Egjipt. 20

Çfarë mardhënie mund të ekzistonte atëherë në mes të filozofisë sekrete të priftërinjëve të Egjiptit të vjetër dhe frankmasonëve të sotëm? Egjipti i vjetër- si një shembull klasik i shpjeguar

në Kur'an si sistem ateist politik- i zhdukur para mijëra vjetëve. A mund të ketë ndonjë ndikim në ditët e sotme?

Që të gjenden përgjegjet në këto pyetje, duhet që të shikohet në besimin e priftërinjëve të Egjiptit të vjetër në lidhje me origjinën e universit dhe jetës.

## BESIMI I EGJIPTASËVE TË VJETËR NË EVOLUCIONIN MATERIALIST

Në librin e tyre "Çelësi i Hiramit" autorët anglezë, Christopher Knight dhe Robert Lomas prezentojnë Egjiptin e vjetër si një vend shumë të rëndësishëm sa i përket lidhshmërisë me origjinën e Masonerisë. Sipas këtyre autorëve, çështja më e rëndësishme që u përhap në masonerinë moderene, është se gjithësia ekziston vetvetiu dhe evolvon nga rasti. Ata e spjegojnë këtë këndvështrim me këto fjalë:

Egjiptasit besonin se materia ekzistonte gjithmonë dhe për ta ishte jashtë logjikës që të marrin me mend se Zoti mund të bëjë diçka nga hiçgjëja absolute. Pikëpamja e tyre ishte se bota fillon kur fillon rregulli të ndahet nga kaosi, dhe që nga atëherë ekziston beteja në mes të forcave të rregullit dhe kaosit...Kjo gjendje kaotike quhej NUN dhe sikurse... përshkrimi... Sumerian..., çdo gjë ishte e errët, humnerë e lëngtë dhe padiell me një fuqi, forcë kreative brenda në të, që urdhëron rregullin të fillojë. Kjo forcë latente (e fshehtë) që ishte brenda substancës së kaosit nuk dinte të

ekzistonte; ishte një probabilitet (gjasë), një potencial që ishte e gërshetuar brenda rastit të çrregullsisë. 21

Do të shihet se besimet e përshkruara këtu janë në harmoni me pohimet e establishmentit të sotëm materialist, që promovohet në agjendat e bashkësive shkencore me termet si "teoria e evolucionit", "teoria e kaosit" si dhe "organizimi thelbësor i materies". Knight dhe Lomas vazhdojnë debatin e tyre të mëparshëm duke thënë:

Për çudi, ky përshkrim i krijimit, përshkruan në mënyrë të përsosur pikëpamjet e shkencës bashkëkohore, e posaçërisht "teoria e kaosit" që paraqet modele të ndërlikuara që evolvojnë dhe përsëriten matematikisht brenda ngjarjeve krejtësisht të pastrukturuara. 22

Knight dhe Lomas pohojnë se aty qëndron harmonia mes besimeve të egjiptasëve të vjetër dhe shkencës moderne, por çfarë mendojnë ata për shkencës moderne, siç kemi theksuar, janë koncepte materialiste, siç është Teoria e Evolucionit dhe ajo e Kaosit. Përkundër faktit se këto teori nuk kanë bazë shkencore, ato kanë qenë të imponuara në fushën e shkencës gjatë dy shekujve të kaluar, dhe janë të paraqitura si shkencërisht të arsyeshme. (Në seksionet e ardhshme do të vështrojmë ata që patën imponuar këto teori në botën shkencore).

Tani, kemi arritur tek një pikë e rëndësishme në këtë etapë të librit. Të përmbledhim çfarë kemi zbuluar deri më tani:

Filluam debatin mbi Rendin e Tamplierëve që mendohet të jetë origjina e Masonerisë. Pamë se, edhepse Tamplierët ishin themeluar se rend i krishterë, ata ishin të ndikuar nga disa doktrina

sekrete që ata i zbuluan në Jerusalem, duke e lënë anash kretësisht krishterizmin dhe bëhet organizatë antifetare duke kryer rituale heretike.

Kur pyetëm se çfarë ishte kjo doktrinë që ndikoi në Tamplierë, zbuluam se në parim ishte Kabala.

Kur shqyrtuam Kabalan, rrodhi fakti se, pa marrë parasysh se mund t'i ngjajë misticizmit çifut, dhe që është doktrinë pagane edhe më e vjetër se Judaizmi, e që më vonë hyn në religjion dhe se rrënjat e vërteta janë gjetur në Egjiptin e vjetër.

Egjipti i vjetër është qeverisur nga një sistem pagan i faraonëve, dhe është zbuluar një çështje që përbën themelin e filozofisë moderne ateiste: se gjithësia ekzistom vetvetiu dhe evoluohet nga rasti.

E gjithë kjo sigurisht paraqet një pikëvështrim interesant. A është e rastësishme që filozofia e priftërinjëve të Egjiptit të vjetër ende lulëzon dhe mu aty gjenden gjurmët e zingjirit (Kabala-Tamplier-Masoneri) që ka qenë përgjegjëse për sigurimin e superioritetit të kësaj filozofie deri në ditët e sotme.

A është e mundur që Masonët, që kanë lënë gjurmët e tyre në historinë botërore që nga shek. i 18-të, ashtuqë kanë nxitur revolucione, duke promovuar filozofi dhe sisteme politike, e të jenë njëkohësisht trashëgimtarë të magjistarëve të Egjiptit të vjetër?

Me qëllim që të jepet një përgjegje sa më e qartë në këtë pyetje, së pari duhet të shqyrtohen më për së afërmi ngjarjet historike që tani shkurtimisht do t'i nënvizojmë.

## -II-
## HISTORIA E FSHEHTË E KABALAS

"Eksodi" është titulli i kapitullit të dytë të Toras. Kjo libër përshkruan se si Izraelitët, të udhëhequr nga Mojsiu, lëshojnë Egjiptin dhe ikën nga tirania e Faraonit. Faraoni ka shfrytëzuar Izraelitët si robër dhe kurrë nuk i ka liruar. Por, kur është ballafaquar me mrekullitë e Zotit, të bëra përmes Mojsiut, dhe shkatërrimet që Ai u shkaktoi njerëzëve të tij, Faraoni lëshoi pe. Në këtë mënyrë, një natë Izraelitët u bashkuan në një masë dhe filluan migrimin e tyre nga Egjipti. Më vonë, faraoni sulmoi Izraelitët, por Zoti i shpëtoi ata përmes mrekullisë që Ai e bëri përmes Mojsiut.

Por, në Kur'an u gjetën të dhënat më të sakta për eksodin nga Egjipti, pasi Tora ka pësuar ndryshime të mëdha pasiqë i ishte shpallur Mojsiut. Fakt i rëndësishëm është se në 5 kapitujt e Torës- Gjeneza, Eksodi, Levitikusi, Numrat dhe Deuteronomi- ka mjaft kundërthënie.

Fakti që libri i Deuteronomisë përfundon me një tregim të vdekjes dhe varrimit të Mojsiut është dëshmi e padiskutueshme, pasi shihet qartë se ajo pjesë duhet të jetë shtuar pas vdekjes së Mojsiut. Në Kur'an, në tregimin për eksodin e Izraelitëve nga Egjipti, si dhe në të gjitha tregimet që kanë lidhshmëri me këtë, nuk ka bile asnjë kundërthënie sado e vogël; tregimi rrëfehet bindshëm. Çka më tepër, sikurse me tregimet tjera, Zoti zbulon shumë mençuri dhe shumë

fshehtësi gjatë rrëfimit. Për këtë shkak, kur të shtjellohen këto tregime më hollësisht, mund të nxirren një sërë mësimesh nga to.

## VIÇI I ARTË

Njëri nga faktet më të rëndësishme sa i përket eksodit të Izraelitëve nga Egjipti, siç tregohet në Kur'an, është se ata kundërshtuan fenë e shpallur atyre nga Zoti, pavarsisht nga fakti se Zoti i kishte shpëtuar ata përmes Mojsiut nga tirania e Faraonit. Izraelitët nuk ishin të aftë që të kuptonin monoteizmin që Mojsiu iu komunikoi atyre, por vazhdimisht anonin drejt idhujtarisë.

Kur'ani e përshkruan këtë prirje të çuditshme kështu:

Beni israilët i kaluam përtej detit, e ata me një popull që adhuronte do statuja të tyre, dhe thanë: "O Musa, na e bën edhe ne një zot (statujë) si zotët që i kanë ata (ai popull)". Ai (Musai) tha: "Ju jeni popull që nuk dini".

Vërtet, ai popull (që po adhuron idhuj) është i shkatërruar në atë (adhurim) dhe ajo që vepruan është e asgjësuar (s'ka dobi).

Kur'an ( 7: 138-139)

Musai u kthye te populli i vet i hidhëruar e i pikëlluar dhe tha: "O populli im, a nuk u premtoi juve Zoti juaj premtim të mirë, a mos u bë kohë e gjatë e ju e harruat premtimin, ose dëshiruat të ju godasë hidhërimi nga Zoti juaj, andaj e thyet besën që ma keni dhënë?"

Ata thanë: "Ne nuk e thyem besën tënde me dëshirën tonë, por ne ishim ngarkuar me barrë të rënda nga stolitë e popullit e i hodhëm ato (në zjarr), e ashtu i hodhi edhe Samirija".

E ai (Samirija) ua mbaroi atyre një viç me trup që pëlliste, e ata thanë: "Ky është zoti juaj dhe Zoti i Musait, po ai (Musai) e ka harruar".

Kur'an ( 20: 86- 88)

Pse ekzistonte kjo tendencë këmbëngulëse në mesin e Izraelitëve që t'i ndërtojnë idhujt dhe t'i adhurojnë ata? Ku ishte burimi i kësaj tendence?

Shumë qartë, pasiqë një shoqëri që kurrënjëherë nuk ka besur në idhuj nuk mundet që përnjëherësh të sillen në mënyrë aq të pamenduar siç është punimi i një idhulli dhe adhurimi i tij. Vetëm ata që idhujtarinë e kanë prirje natyrore mund të bëjnë marrëzira të tilla.

Sidoqoftë, Izraelitët ishin popull që kishin besuar në një zot që nga ditët e paraardhësit të tyre Abrahamit (hz. Ibrahimit). Emri "Izraelitë" apo "Bijtë e Izraelit" së pari u është dhënë djemëve të Jakovit (Jakupit), nipit të Abrahamit, e më vonë të gjithë çifutëve që kanë rrjedhur nga ai. Izraelitët kanë ruajtur besimin monoteist që e kishin trashëguar nga paraardhësit e tyre Abrahamit, Isakut dhe Jakovit, paqja qoftë mbi ta. Së bashku me Jozefin (Jusufin) paqja qoftë mbi ta, shkuan në Egjipt dhe ruajtën monoteizmin e tyre për një kohë të gjatë, përkundër faktit se ata duhej të jetonin në mesin e idhujtarëve në Egjipt. Është e qartë nga tregimet që gjenden në Kur'an, se kur Mojsiu erdh tek ata, Izraelitët ishin një popull që besonin në një Zot.

Shpjegimi i vetëm i kësaj është se Izraelitët, pa marrë parasysh se sa e zbatonin besimin monoteist, kishin ndikim nga paganët që jetonin me ta dhe filluan që t'i imitojnë, duke zëvendësuar fenë e zgjedhur për ta nga Zotu me idhujtari nga popujt tjerë.

Kur të shqyrtojmë këtë çështje nën dritën e të dhënave historike, shohim se paganizmi që ndikoi në Izraelitët ishte nga Egjipti i vjetër. Dëshmi e rëndësishme që mund të mbështetë këtë konkluzion ishte se viçi i artë që izraelitët adhuronin derisa Mojsiu ishte në malin Sinai, ishte në të vërteë një replikë (kopje) e idhujve egjiptianë Hator dhe Afis. Në librin e tij, "Gjatë nën diell", të autorit të fesë krishtere Richard Rives, shkruan:

Hatori dhe Afisi, zotëra egjiptianë në formë të lopës dhe kaut, ishin pjesë e adhurimit të diellit. Adhurimi i tyre ishte vetëm një periudhë e historisë së gjatë egjiptiane të adhurimit të diellit. Viçi i artë në malin Sinaj është më shumë se dëshmi e mjaftueshme që tregon se festa fetare kishte lidhmëri me adhurimin e diellit... 23

Ndikimi i fesë pagane egjiptase në Izraelitët u bë në etapa të ndryshme. Posa kanë takuar paganët, ata anuan kah besimi heretik, siç thotë edhe ajeti: Dhe kur i thatë: Beni israilët i kaluam përtej detit, e ata me një popull që adhuronte do statuja të tyre, dhe thanë: "O Musa, na e bën edhe ne një zot (statujë) si zotët që i kanë ata (ai popull)". Ai (Musai) tha: "Ju jeni popull që nuk dini". Kur'an (7: 138) e ata i thanë profetit: "O Musa, ne nuk të besojmë ty derisa ta shohim All-llahun haptazi, e atëherë juve u rrëmbeu rrufeja (zjarri) dhe ju e shihnit. Kur'an (2: 55) tregon se ata kishin tendencë kah adhurimi i qenieve materiale që mund të shiheshin, në të njejtën mënyrë si paganizmi ndër egjiptasit.

Prirja e Izraelitëve për paganizmin e Egjiptasëve, që është nënvizuar, është e rëndësishme dhe hedh pak dritë mbi devijimin e tekstit në Tora dhe origjinën e Kabalas. Kur shqyrtojmë këto dy çështje me kujdes do të shohim se, në zanafillën e tyre, gjendet paganizmi i Egjiptasve të vjetër dhe filozofia materialiste.

## NGA EGJIPTI I VJETËR DERI TEK KABALA

Kur Mojsiu ishte ende gjallë, Izraelitët filluan të punojnë idhuj të ngjajshëm siç janë parë në Egjipt dhe kanë filluar t'i adhuronin. Pas vdekjes së Mojsiut, ishte vështirë të frenohet rrëshqitja e mëtutjeshme për në zvetëni. Natyrisht, e njejta gjë nuk mund të thuhet për të gjithë çifutët, por disa prej tyre pranuan paganizmin egjiptian. Në të vërtetë, ata zbatonin doktrinat e priftërinjëve egjiptianë (magjistarëve të faraonit), që shtriheshin në bazën e atij besimi shoqëror dhe devijuan fenë e tyre me futjen e këtyre doktrinave në të.

Doktrina që ishte futur në Judaizëm nga Egjipti i vjetër ishte Kabala. Sikur sistemi i priftërinjëve egjiptas, edhe Kabala ishte një sistem sekret, ku bazohej në praktikimin e magjisë. Është interesant pasi Kabala jepte të dhëna të ndryshme nga ato që mund të gjendeshin në Tora. Është një vlerësim materialist, bazuar në idenë e Egjiptit të vjetër të ekzistimit të përhershëm të materies. Murat Ozgen, një frankmason turk, flet për këtë çështje:

Është evidente se Kabala ishte themeluar shumë vjet para Toras. Kapitulli më i rëndësishëm në Kabala është teoria mbi krijimin e gjithësisë. Kjo teori është një teori tjetër nga tregimi i krijimit të

pranuar në fetë teiste. Sipas Kabalas, në fillim të krijimit, lindin krijesat e quajtura Sefiroth, që dmth. "rrathë" apo "orbita", me karakteristika materiale dhe shpirtrore.

Numri i përgjithshëm i këtyre krijesave ishte 32. E 10 të parat paraqitnin sistemin diellor ndërsa tjerat paraqitnin tufën e yjeve në gjithësi. Kjo veçori e Kabalas tregon se është e lidhur ngushtë me besimin e lashtë të sistemeve astrologjike... Prandaj, Kabala është shumë larg nga besimi çifut ndërsa është shumë më e afërt me religjionet e lashta dhe misterike të Lindjes. 24

Çifutët me adoptimin e këtyre doktrinave të fshehta dhe materialiste nga Egjipti i vjetër që ishin themeluar në baza të magjisë, kanë imponuar ndalesat në Tora. Ata morën ritualet magjike nga paganët tjerë dhe në këtë mënyrë, Kabala bëhet doktrinë mistike brenda Judaizmit, por ndryshon nga Tora. Në librin e saj, "Shoqëritë sekrete dhe lëvizjet armiqësore", shkrimtarja angleze thotë:

Magjia, siç e dijmë, ka qenë e praktikuar nga Kananitët (Canaanites) para okupimit të Palestinës nga izraelitët; Egjipti, India dhe Greqia gjithashtu kishin falltarët dhe parashikuesit e vet. Pavarsisht nga kundërshtimet ndaj magjisë që përmbanë Ligji i Mojsiut, çifutët nuk përfillnin këto vërejtje, "infektoheshin" dhe përziheshin me traditën e tyre të shenjtë që ata trashëguan me ide të magjisë, pjesërisht të marra nga popujt tjerë dhe pjesërisht të trashëguara. Në të njejtën kohë ana teorike e Kabalës çifute e huazuar nga filozofia e Magive Persianë, të Neo-platonistëve dhe Neo-pitagorianëve. Kjo ishte një lloj arsyetimi për lidhshmërinë anti-kabaliste që sot njihet si Kabala, nuk është me origjinë të pastër çifute. 25

Ja ajeti kuranor që i referohet kësaj çështje. Zoti thotë se izraelitët mësuan ritualet e magjisë satanike nga burimet që ishin jashtë fesë së tyre.

...(e hodhën librin e Zotit) E ndoqën atë që thonin djajt në kohën e sundimit të Sulejmanit. Por Sulejmani nuk ishte i pafé, djajt ishin të pafé, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (Ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thonin: "Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pa fé!" E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejën e All-llahut me atë askujt nuk mund t'i bënin dëm dhe ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (jehuditë) e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata se për ç'ka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe.

Kur'an (2: 102)

Ky ajet tregon se disa çifutë edhepse e dinin se do t'a humbnin veten në jetën e pastajshme, mësuan dhe adoptuan praktikimin e magjisë. Kështuqë, ata u shmangën Ligjit të Zotit që iu është dërguar dhe duke shitur shpirtin e tyre, ranë në besimin pagan (doktrinë magjike). "Ata e shitën vetveten" për një gjë të ligë, dhe me fjalë tjera, ata lëshuan rrugën e fesë së tyre.

Faktet në këtë ajet tregojnë veçoritë kryesore të një konflikti të rëndësishëm në historinë çifute. Kjo luftë ishte, në një anë, mes profetëve që Zoti i kishte dërguar çifutëve dhe atyre çifutëve që iu bindeshin atyre, dhe nga ana tjetër, atyre çifutëve të çoroditur që mohonin urdhërat e Zotit, duke imituar kulturën pagane të njerëzëve përreth tyre, që pasonin kulturën e tyre më tepër se Ligjin e Zotit.

# DOKTRINAT PAGANE QË HYNË NË TORA

Është me rëndësi të ceket se mëkatet e çifutëve që kishin devijuar shpesh tregohet edhe në librin e shenjtë të çifutëve- Dhjatën e Vjetër. Në librin e Nehemijas, një lloj libri brenda Dhjatës së Vjetër, çifutët pranojnë mëkatet e tyre dhe pendimin.

Atëherë ata që kishin prejardhje izraelite të ndarë nga të gjithë të huajt; duruan dhe pranuan mëkatet dhe ligësitë e paraardhësve. Ata qëndruan në vendet e tyre dhe lexuan Librin e ligjit të Zotit të tyre (për një të katërtën) e ditës; dhe për katërtën (tjetër) ata luteshin dhe adhuronin Zotit. Pastaj Xheshua, Bani, Kadmieli, Shebanijhu, Buni, Sherebijahu, Bani (dhe) Çenani qëndronin në shkallët e Levitetit dhe thirrën me zë të lartë Zotin.

...(Ata thanë:) "...ata (paraardhësit tanë) ishin të pabindur dhe mohues ndaj teje, flakën ligjin tënd pas shpinës dhe vranë profetët Tuaj, që dëshmonin kundër tyre dhe që të ktheheshin kah Ti; dhe bënë iritime të mëdha. Prandaj ti dorëzove ata në duart e armiqëve, që i shtypnin; dhe kur ishin në vështirësi, ata Ty ndihmë të kërkuan.

Ti i dëgjove nga qielli; dhe sipas Mëshirës Sate Ti iu dhe atyre të dërguar, ashtuqë t'i shpëtojë ata nga dora e armiqëve të tyre. Por, pastaj ata prapë bënin mëkate para syve Tuaj. Prandaj Ti i le ata në duart e armiqëve të tyre, ashtuqë ata sundonin mbi ta; pastaj ata u penduan dhe kërkuan ndihmën Tënde, Ti i dëgjove nga qielli; dhe shumë herë Ti i çlirove me mëshirën Tënde, dhe dëshmove kundër tyre, se mund mund T'i kthesh prapë në ligjin Tënd. Pastaj ata prapë ngrenë kryet, dhe nuk përfillën urdhërat Tuaj, por vazhduan me mëkate kundër vendimeve Tuaja, që

nëse njeriu i bën, atëherë do të jetojë me to. Ata rrodhën supet e tyre, u bënë kokëfortë dhe nuk dëgjonin.

...Prapseprapë në Mëshirën Tënde nuk i ke shkatërruar apo braktisur krejtësisht; Për këtë Ti je Zoti, I larti, Mëshirëploti.

Dhe kështu, Zoti ynë, i Madh i Fuqishëm, i Madhëruari Zot... Ti (je) në të gjithat që neve n'a ndodhë; Ti ke vepruar besnikërisht, por ne kemi punuar gjëra të liga. As mbretërit as princërit tanë, priftërinjtë dhe etërit tanë, nuk iu përmbajtën ligjit Tënd, as nuk i përfillën urdhërat Tuaja dhe dhuratat Tuaja, me çka Ti dëshmove kundër tyre. Për atë që ata nuk të shërbyen Ty në mbretërinë e tyre, apo në shumë (gjëra) të mira që Ti iu fale, apo në tokën e gjërë dhe të pasur që Ti iu shtrove atyre; dhe ata nuk iu shmangën punëve të tyre të mbrapshta." (Nehemia 9: 2-4, 26-29, 31-35)

Ky fragment tregon dëshirën e një numri çifutësh që ishin kthyer në besimin në Zotin, por në historinë e çifutëve një segment tjetër gradualisht forcohej dhe filloi të dominojë mbi çifutët dhe më vonë krejtësisht ndërroi edhe vetë fenë. Për këtë arsye, në Tora dhe në librat tjerë të Dhjatës së Vjetër, ekzistojnë elemente që kanë prej ardhjen e doktrinave heretike pagane, gjithashtu edhe të lartpëmendurat që synojnë kthimin në fenë e vërtetë. Për shembull:

Në librin e parë të Toras, thuhet se Zoti krijoi tërë gjithësinë për 6 ditë nga hiçgjëja. Kjo është e saktë dhe rrjedh nga shpallja origjinale. Por, mandej thuhet se Zoti pushoi në ditën e shtatë, që është pohim krejtësisht i shpikur. Është ide e prapshtë që rrjedh nga paganizmi ashtuqë i jepen Zotit veti njerëzore. Në Kur'an, Zoti spjegon këtë gjë në ajetinn në vazhdim:

Ne krijuam qiejt e tokën dhe gjithçka ka ndërmjet tyre brenda gjashtë ditësh dhe Ne nuk ndiem lodhje.

Kur'an (50: 38).

Në pjesët tjera të Toras, ekziston një stil i të shkruarit që nuk respektohet madhëria e Zotit, sidomos në ato vende ku Atij rrejshëm i emrohen dobësitë njerëzore. (Zoti është sigurisht larg asaj). Këto antropomorfozime janë bërë që të përngjajnë në dobësitë njerëzore që paganët u kishin mveshur zotrave të tyre të imagjinuar.

Pohim i ngjajshëm tjetër blasfemie është kur thuhet se Jakovi, paraardhësi i Izraelitëve, luftoi (mundej) me Zotin, dhe fitoi. Ky tregim qartë tregon se është i shpikur ashtuqë t'iu jap izraelitëve një superioritet racial, në garë të ndjenjave raciale të përhapura mes paganëve (apo me fjalët kuranore "tërbimi fanatik").

Ekziston tendencë në Dhjatën e Vjetër që Zotin t'a prezentojnë si zot nacional- se Ai është Zot i vetëm izraelitëve. Sidoqoftë Zoti është Zot i tërë gjithësisë dhe i tërë qenieve njerëzore. Termi zot nacional, në Dhjatën e Vjetër, i përgjigjet prirjes për në paganizëm, ku çdo fis adhuronte zotin e vet.

Në disa libra të Dhjatës së Vjetër (p.sh. Xhoshua), janë dhënë urdhëra që të kryhet dhunë e tmerrshme kundër joçifutëve. Urdhërohet për vrasje masive, duke mos kursyer as femrat, fëmijët dhe të vjetrit. Kjo egërsi e pamëshirë është krejtësisht e kundërt me drejtësinë e Zotit, dhe të përkujton barbarizmat e kulturave pagane, që adhuronin zotëra mistikë të luftës.

Këto ide pagane që paraqiten në Tora duhet të kenë origjinën e vet. Duhet të jenë çifutët ata që kishin adoptuar, nderuar dhe lartësuar një traditë që ishte e huaj në Tora, dhe më vonë e ndërruan duke shtuar në të ide që rrjedhnin nga tradita që ata përqafuan. Origjina e kësaj tradite ka rrënjët tek priftërinjtë e Egjiptit të vjetër (magjistarët nga regjimi i faraonëve). Kjo ishte në të vërtetë, Kabala që kishte arritur atje nga disa çifutë. Kabala merr pamje që i mundëson doktrinës së Egjiptit të vjetër dhe doktrinave tjera që të futen pa u diktuar në Judaizëm dhe aty të zhvillohen. Kabalistët, natyrisht, pohojnë se Kabala thjeshtë shpjegon në më shumë detale fshehtësitë sekrete të Torës, por në realitet, siç thotë një historian çifut i Kabalës, Theodore Reinach, se Kabala është "një helm tinzar që hyn në damarët e Judaizmit dhe e pllakos të tërin." 26

Është e mundur, atëherë, që të gjenden në Kabala gjurmë të qarta të ideologjisë materialiste të Egjiptit të vjetër.

## KABALA- DOKTRINË E KUNDËRT E KREACIONIZMIT

Zoti në Kur'an tregon se Tora është libër hyjnor dhe që është dërguar si dritë njerëzimit:

Ne e zbritëm Tevratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij gjykuan ndaj atyre që ishin jehudi, pejgamerët që ishin të bindur, gjykuan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, ngase ishin të obliguar ta ruanin librin e Allahut dhe ishin mbrojtës të tij...

Kuran (5: 44)

Prandaj, Tora, sikurse Kur'ani, është libër që përmban njohuri dhe urdhëresa në lidhje me çështjet si ekzistenca e Zotit, njëshmëria e Tij, vetitë e Tij, krijimi i qenieve njerëzore dhe qenieve tjera, qëllimi i krijimit të njeriut dhe dispozitat morale të Zotit për njerëzimin. (Por Tora origjinale sot nuk është i ruajtur. Sot çfarë kemi është një version "i ndryshuar" i Toras, i ndryshuar nga dora njerëzore).

Ekziston një hollësi e rëndësishme, e ajo është se të dyjat, Tora e vërtetë dhe Kur'ani kanë një gjë të përbashkët: Zoti pranohet si Krijues. Zoti është absolut, dhe ka ekzistuar që nga fillimi i kohës. Çdo gjë tjetër përpos Zotit është krijesë e Tij, krijuar nga hiçgjëja. Ai ka krijuar tërë gjithësinë, trupat qiellorë, materien jo të gjallë, qeniet njerëzore dhe të gjitha qeniet e gjalla. Zoti është Një; Ai është i vetëm!

Pasiqë kjo është e vërtetë, në Kabala është gjetur një interpretim shumë më ndryshe, ai "helm tinzar që hyn në damarët e Judaizmit dhe e pllakos të tërin"; doktrina e saj është krejtësisht e kundërt ndaj "faktit të krijimit", që gjenden në Torën e vërtetë dhe në Kur'an. Në njërën ndër punimet mbi Kabalën, hulumtuesi amerikan, Lance S. Owens, paraqet pikëpamjet e tij në lidhje me origjinat e mundshme të kësaj doktrine:

Përvoja kabalistike që sjell disa perceptime për hyjnoren, shumica e tyre janë sjellur nga pikëpamja ortodokse. Doktrina kryesore e besimit çifut ka qenë shpallja se "Zoti ynë është Një". Por Kabala pohon se derisa Zoti ekziston në formën më të lartë si njësi e pakrahasueshme- e quajtur Ein Sof, i paskajshmi- kjo veçori e panjohur kishte zënë fill në një numër të madh të formave hyjnore; një shumicë zotërash. Këtë kabalistët e quajtën Sefiroth, apo fytyrat e Zotit. Mënyra me të cilën Zoti rrjedh nga njësia e paimagjinueshme në shumicë ishte një mister ndaj të cilës Kabalistët i

kushtonin shumë meditime. Siç duket, ky pasqyrim shumëfytyrshëm i Zotit pranon akuzat e të qenurit politeist, akuzë që ishte me pasion, edhepse jo plotësisht e suksesshme, kundërshtuar nga Kabalistët.

Nuk ishte në shumës vetëm çështja hyjnore në teosofinë kabaliste, por në zanafillën e parë të saj nga njësia e panjohur Zoti kishte marrë formë të dyfishtë: si mashkull dhe si femër; babë dhe nënë hyjnore, Hokhmah dhe Binah, ishin format e para të Zotit. Kabalistët përdorën metaforat e hapura gjinore që të shpjegojnë se si mardhënia krijuese e Hakhmahut dhe Binahut prodhuan krijimin e mëtutjeshëm... 27

Një cilësi interesante e kësaj teologjie mistike është që, sipas saj, qeniet njerëzore nuk janë të krijuara, por në një mënyrë janë hyjnore. Owens e spjegon këtë legjendë kështu:

Pasqyrimi kompleks i Hyjnisë... ishte gjithashtu e përshkruar nga Kabala si diçka që ka formë unitare, antropomorfe. Zoti ishte, sipas një recenzioni kabalist, Adam Kadmon : njeriu i parë fillestar apo arketip. Njeriu ndante së bashku me Zotin një formë organike thelbësore, shkëndijë hyjnore e pakrijuar dhe komplekse. Ky barazim i Adamit me Zotin mbështetej me shifra kabaliste: vlera numerike në hebraishte të emrave Adam dhe Jehova (Zoti) (Tetragramatoni, Yod he vav he), së bashku ishte 45. Prandaj në interpretimin kabalist Jehova barazohet me Adamin: Adami ishte Zoti. Me këtë konfirmim zhvillohet edhe mendimi se e gjithë njerëzia në kuptimin më të lartë ishte si Zoti. 28

Kjo teologji përbëhej nga një mitologji pagane, dhe formonte bazën e degjenerimit të Judazimit. Kabalistët çifutë thyenin kufijtë e arsyes së zakonshme deri në atë masë saqë bile u munduan që t'i transformojnë njerëzit në zotëra. Përpos kësaj, sipas kësaj teologjie, nuk ishte krejt njerëzimi

me karakter hyjnor, por njerëzimi përfshinte vetëm çifutët; ndërsa popujt tjerë nuk konsideroheshin njerëz. Si rezultat, brenda judaizmit, që kishte origjinën themelore në bazat e shërbimit dhe bindjes ndaj Zotit, kjo doktrinë e bastardhuar filloi të zhvillohej, me tentativë që t'a ngopte arrogancën çifute. Pavarsisht nga natyra kundërthënëse e Torës, Kabala kishte hyrë në Judaizëm. Por përfundimisht ajo filloi që t'a bastardhojë Torën.

Çështje tjetër interesante rreth bastardhimit të doktrinës së Kabalës është ngjajshëm me idenë pagane të Egjiptit të vjetër. Siç debatuam edhe më herët, egjiptasit e vjetër besonin se materia ka ekzistuar gjithmonë: me fjalë tjera, ata mohuan idenë se materia ishte krijuar nga hiçgjëja. Kabala pohon gjënë e njejtë në lidhje me qeniet njerëzore; ajo thotë se qeniet njerëzore nuk janë krijuar, dhe ato kanë përgjegjësinë për ekzistencën e vet.

Kjo shprehet edhe me fjalor modern: egjiptianët e vjetër ishin materialistë dhe para së gjithash Kabala do të mund të quhej HUMANIZËM LAIK (jofetar).

Është interesant të ceket se këto dy koncepte- materializmi dhe humanizmi laik- përshkruajnë ideologjinë që ka dominuar botën në dy shekujt e fundit.

Është provokative të pyetet se nëse ekzistojnë forca që kanë transmetuar doktrinën e Egjiptit të vjetër dhe Kabalës që nga mesi i historisë së vjetër e deri në ditët e sotme.

## NGA TAMPLIERËT DERI TEK MASONËT

Kur më herët përmendëm Tamplierët, theksuam se ky rend i veçantë i luftëtarëve të kryqëzatave ishte i ndikuar nga një ”e fshehtë” e zbuluar në Jerusalem, si rezultat i të cilit ata lënë anash krishterizmin dhe filluan t'i praktikojnë ritualet e magjisë. Thamë se shumë hulumtues mbanin opinionin se kjo fshehtësi kishte lidhje me Kabalën. Psh. në librin e tij "Historia e magjisë" të shkrimtarit francez, Eliphas Lévi, paraqet dëshminë e detalizuar, se Tamplierët ishin futur në doktrinat misterioze të Kabalës, përndryshe, ata fshehurazi ishin trajnuar në këtë doktrinë. 29 Prandaj, doktrina që kishte rrënjët në Egjiptin e vjetër ishte transmetuar përmes Kabalës tek Tamplierët.

Libri "Foucault's Pendulum", të novelistit të famshëm italian, Umberto Eco, tregon për këto fakte gjatë përbetimit. Përgjatë novelës, ai tregon përmes fjalëve të personazheve të tij, se Tamplierët ishin ndikuar nga Kabala dhe se Kabala, ishte një fshehtësi që mund të dërgoj tek faraonët e Egjiptit të vjetër. Sipas Ecos, disa çifutë të shquar mësuan disa fshehtësi të marra nga egjiptasit e vjetër dhe më vonë këto i futën në pesë librat e parë të Dhjatës së Vjetër (Pentateuch). Por kjo fshehtësi që ishte transmetuar fshehurazi, mund të kuptohej vetëm nga kabalistët. (Zohari ishte shkruar më vonë në Spanjë, dhe duke formuar librin themelor të Kabalës merret me fshehtësitë e këtyre 5 librave). Pas deklaratës se kabalistët lexojnë këtë fshehtësi të egjiptasëve të vjetër si dhe nga matjet gjeometrike të Tempullit të Solomonit, Eco shkruan se Tamplierët mësuan këtë nga rabit kabalistë në Jerusalem:

Fshehtësia- çfarë Tempullli veçse e thoshte të tërën- mbahej vetëm nga një grup rabish që mbetën në Palestinë... dhe Tamplierët e mësuan nga ata. 30

Kur Tamplierët adoptuan këtë doktrinë egjiptaso-kabaliste, natyrisht, ata erdhën në konflikt me etablishmentin kristian që dominonte Europën. Këtë konflikt ata e ndanin me një forcë tjetër të rëndësishme- çifutët. Pasi arrestohen Tamplierët, me urdhërin e përbashkët të mbretit francez dhe Papës më 1307, rendi kaloi në ilegalitet, por vazhdoi ndikimi i tij dhe atë në mënyrë edhe më të vendosur dhe më radikale.

Siç thamë më herët, një numër Tamplierësh arriti që t'i shmangen arrestit dhe iu drejtuan mbretit skocez që të arratisën atje, që atëherë ishte mbretëria e vetme që nuk e pranonte autoritetin e Papës. Në Skoci, ata u infiltruan në shoqatën e muratorëve dhe në kohën e duhur e pushtuan atë.

Shoqatat adoptuan traditën e Tamplierëve dhe në këtë mënyrë fuqia e Masonizmit ishte e mbjellur në Skoci. Ende, edhe sot, vija kryesore e masonëve quhet "Riti i vjetër dhe i pranuar skocez".

Siç shqyrtuam në hollësi librin "Rendi i ri masonik", që nga fillimi i shek. të 14-të, mund të vërehen gjurmët e Tamplierëve- ashtuqë edhe disa çifutë iu bashkangjitën-në etapa të ndryshme të historisë europiane. Pa hyrë thellë në detale ja disa nënvizime:

Në Provencë, Francë, ishte një strehim i rëndësishëm i Tamplierëve. Gjatë arrestimeve, shumë prej tyre u fshehën këtu. Një veti tjetër e rëndësishme e këtij regjioni është se është njëra ndër qendrat më të njohura të kabalizmit në Europë. Provenca është vend ku është shkruar si libër, tradita gojore e Kabalës.

Kryengritja fshatare në Angli, më 1381, sipas disa historianëve, ishte nxitur nga një organizatë sekrete. Ekspertët që studiojnë historinë e Masonerisë vijnë në përfundim dhe pajtohen se kjo

organizatë sekrete ishte Tamplierët. Ajo ishte më shumë se një kryengritje e zakonshme fshatare, ishte një sulm i planifikuar mbi Kishën Katolike. 31

Gjysmë shekulli pas kryengritjes, një klerik nga Çekia i quajtuar John Huss, filloi një kryengritje kundër Kishës Katolike. Prapa skenës së kryengritjes, ishin prapë Tamplierët. Përveç kësaj, Huss ishte shumë i interesuar për Kabalën. Ben Isaac Kara ishte njëri ndër emrat më të rëndësishëm që kishte ndikuar në zhvillimin e doktrinave të tija. Kara ishte një rabi i bashkësisë çifute në Pragë dhe kabalist. 32

Shembujt e tillë janë shenja të qarta se aleanca mes Tamplierëve dhe kabalistëve ishte synuar në drejtimin që t'a ndryshonte rendin shoqëror në Europë. Ky synim, bëri ndryshime në kulturën themelore krishtere të Europës, dhe zëvendësimit të saj me një kulturë të bazuar në doktrina pagane, siç ishte Kabala.

Dhe, pas këtij transformimi kulturor, pasojnë edhe ndryshimet në politikë. P.sh. revolucionet në Francë dhe Itali...

Në kapitujt e ardhshëm do të hedhim një sy në disa nga pikat kthyese në historinë europiane. Në çdo periudhë, fakti që do të n'a kundërvehet është se atëherë ishte një forcë që dëshironte t'a distancojë Europën nga trashëgimia e saj krishtere, zëvendësimin e saj me një ideologji laike dhe me këtë program në mendje, të shkatërrojë institucionet fetare. Kjo forcë tentonte që t'a bëjë Europën që t'a pranojë doktrinën që kishte qenë transmetuar nga Egjipti i vjetër përmes Kabalës. Siç cekëm edhe më parë, bazë e kësaj doktrine ishin dy koncepte të rëndësishme: humanizmi dhe materializmi.

Së pari, të shqyrtojmë çështjen e humanizmit.

## III
## RISHQYRTIMI I HUMANIZMIT

"Humanizmi" konsiderohet si një ide pozitive nga shumica e njerëzve. Kjo të sjell ndërmend shprehjet si dashuria ndaj njerëzimit, paqja dhe vëllazërimi. Por, domethënia filozofike e humanizmit është shumë më kuptimplote: humanizmi është mënyrë e të menduarit që parashtron konceptin e humanitetit si fokus i tij dhe si qëllim të vetëm. Me fjalë tjera, ajo thërret njerëzit që t'i largohen Zotit, Krijuesit të tyre, dhe të interesohet me ekzistencën dhe identitetin e vet.

Fjalori i zakonshëm definon humanizmin si: "sistem i mendimit që bazohet në vlerat, karakteristikat dhe sjelljen që besohen të jenë më të mirat për njerëzit, sesa ndonjë autoritet mbinatyral." 33

Definimi më i qartë i humanizmit, sidoqoftë, është paraqitur nga ata që e kanë përkrahur. Njëri ndër zëdhënësit më prominent të humanizmit modern është Corliss Lamont. Në librin e tij "Filozofia e humanizmit", shkruan:

(Me pak fjalë) humanizmi beson në natyrë... përmban shumën totale të realitetit, që mardhënia materie-energji dhe jo-mendorja janë gjërat fundamentale e gjithësisë dhe entitetet mbinatyrale dmth., në nivelin human, njerëzit nuk posedojnë shpirt mbinatyral dhe të pavdekshëm; dhe në nivelin e gjithësisë si tërësi, kosmosi ynë nuk posedon Zot mbinatyror dhe të gjithëjetshëm. 34

Siç po shihet, humanizmi është gati identik me ateizmin, dhe ky fakt shumë lehtë është përqafuar nga humanistët. Dy manifeste të rëndësishme u botuan në shekullin e fundit. I pari u publikua më 1933 dhe ishte nënshkruar nga disa personalitete të rëndësishme të asaj kohe. Pas 40 vjetëve më 1973, manifesti i dytë u botua si konfirmim i të parës, por ishte me risi që kishin të bënin me zhvillimet që ndodhën ndërkohë. Me mijëra mendimtarë, shkencëtarë, shkrimtarë dhe pjestarë të mediave nënshkruan manifestin e dytë, që u përkrah nga Shoqata Amerikane e Humanistëve që edhe sot është mjaft aktive.

Kur t'i shqyrtojmë këto manifeste, gjejmë bazën e njejtë në secilin prej tyre: është një dogmë ateiste që thotë se gjithësia dhe njerëzit nuk janë krijuar por ekzistojnë në mënyrë të pavarur, që njerëzit nuk janë përgjegjës ndaj asnjë autoriteti përpos të atyre, dhe se besimi në Zot vetëmsa kishte ngadalsuar zhvillimin shoqëror dhe individual të njerëzëve. Psh. 6 pikat e para të Manifestit Humanist janë:

E para: Humanistët fetarë përshkruajnë gjithësinë si vetë-ekzistuese e jo të krijuar,

E dyta: Humanizmi beson se njeriu është pjesë e natyrës dhe se ai është shfaqur si rezultat i një procesi të vazhduar,

E treta: Duke mbajtur një pikëpamje organike mbi jetën, humanistët konstatojnë se duhet mohuar dualizmi tradicional i mendjes dhe trupit.

E katërta: Humanizmi pranon se kultura dhe civilizimi fetar i njeriut, siç është përshkruar qartë në antropologji dhe histori, janë produkte të zhvillimit gradual për shkak të bashkëveprimit me

ambientin e tij natyror dhe me trashëgiminë e tij shoqërore. Personi i lindur në një kulturë të caktuar është formuar kryesisht nga ajo kulturë.

E pesta: Humanizmi pohon se natyra e universit e shpjeguar nga shkenca bashkëkohore e bën të papranueshme çdo garancë mbinatyrore apo kosmike të vlerave njerëzore...

E gjashta: Jemi të bindur se ka kaluar koha e teizmit, deizmit, modernizmit dhe variateteve të ndryshme të "mendimit të ri". 35

Në pikat e mësipërme, vërejmë se shprehjet e filozofisë së përbashkët që manifestohen me emra si materializëm, darvinizëm, ateizëm dhe agnosticizëm. Në pikën e parë, dogma materialiste e ekzistencës së amshueshme të gjithsisë është paraqitur. Pika e dytë thotë, sikurse teoria e evolucionit, se njerëzit nuk janë krijuar. Pika e tretë mohon ekzistimin e shpirtit njeriut duke pohuar se qeniet njerëzore janë të përbëra nga materia. Pika e katërt propozon një "evolucion kulturor" dhe mohon ekzistencëne përshkruar hyjnore të natyrës njerëzore (një natyrë e veçantë njerëzore e dhënë në krijim). Pika e pestë e mohon sovranitetin e Zotit mbi gjithësinë dhe njerëzimin, dhe e gjashta thotë se është koha që të mohohet "teizmi", që është besimi në Zot.

Do të vërehet se këto pohime janë ide stereotipike, tipike për qarqet që janë në armiqësi me fenë e vërtetë. Arsyeja për këtë është se humanizmi është themeli kryesor i mendimit antifetar. Kjo është kështu pasi që humanizmi është shprehje e "mos dhënies së llogarisë së njeriut dhe do të lejohet që të kalojë pa u kontrolluar (pa përgjegjësi)" që ka qenë baza primare, përgjatë historisë, për mohimin e Zotit. Në një ajet të Kur'anit Zoti thotë:

A mos mëndon njeriu se do të lihet duke mos zënë asgjë (pa kurrfarë përgjegjësie). A nuk ka qenë ai në një pikë sperme që derdhet. E pastaj u bë gjak i trashë, e Ai e krijoi dhe e përsosi? Dhe prej tij Ai i bëri dy lloje: mashkullin dhe femrën. A nuk është Ai (Zot) i fuqishëm që i ngjall të vdekurit?

Kur'an (75: 36-40)

Zoti thotë se njerëzit nuk do të "lejohen pa dhënë përgjegjësi" dhe i përkujton ata menjëherë se janë krijesa të Tij. Kjo është kështu për arsye se, kur njeriu kupton se është krijesë e Zotit, dhe kupton se nuk mund të shkojë "pa hyrë në kontroll" por përkundrazi është përgjegjës para Zotit.

Për këtë arsye, pohimi se njerëzit nuk janë krijuar është bërë një doktrinë themelore e filozofisë humaniste. Dy pikat e para të Manifesitit Humanist shprehin këtë doktrinë. Çka më tepër, humanistët thonë se edhe shkenca i përkrahë këto pohime.

Sidoqoftë, ata e kanë gabim. Prej se është botuar Manifesti i parë, dy parakushtet që humanistët paraqitën si fakte shkencore- ide që tregojnë se gjithësia është e përhershme si dhe teoria e evolucionit- kanë dështuar:

Ideja që gjithësia është e përhershme ishte bërë e pavlefshme pas një sërë zbulimesh astronomike që ishin bërë që nga botimi i Manifestit të Parë Humanist. Zbulimet si zgjërimi i universit, nga rrezatimet e largëta thellë në kosmos si dhe raporti i hidrogjenit ndaj heliumit, treguan se gjithësia kishte një fillim, dhe është krijuar nga hiçgjëja para 15-17 miliardë vjetësh nga një eksplodim gjigant i quajtur "Big Beng". Edhepse ata që përkrahnin filozofinë humaniste dhe materialiste pa vullnet pranuan teorinë e Big Begut, më në fund iu mbush mendja dhe u bindën. Si rezultat i

faktit shkencor që u zbulua, shkenctarët më në fund pranuan teorinë e Big Bengut, dmth., se gjithësia kishte një fillim, kështuqë humanistët nuk kishin argument. Në këtë mënyrë mendimtari ateist Anthony Flew ishte i detyruar që t'a pranojë këtë fakt:

...Unë do të filloj me pranimin se ateizmi stratonikan duhet të jetë i shqetësuar nga konsensusi bashkëkohor kosmik. Për këtë gjë duket se kosmologët japin një fakt shkencor çfarë pohimi i Shën Tomasit nuk mund të dëshmohet në mënyrë filozofike, dmth., se gjithësia kishte një fillim... 36

Teoria e evolucionit, arsyetimi më i rëndësishëm shkencor pas Manifestit të Parë Humanist, filloi të humb rëndësinë pas disa dekadave. Është i njohur skenari i propozuar mbi origjinën e jetës nga evolucionistët ateistë (padyshim edhe humanistë), siç ishte A. I. Oparini dhe J.B.S. Haldane në vitet e 30-ta, nuk kishte më vlerë shkencore; pasiqë qeniet e gjalla nuk mund të prodhoheshin spontanisht nga materia jo e gjallë, si ishte propozuar në skenar të dhënat mbi fosilet tregojnë se qeniet e gjalla nuk zhvillohen përmes një procesi të ndryshimeve të vogla kumulative, por u shfaqën për një kohë të shkurtë me karakteristikat e tyre dalluese, dhe se ky fakt kishte qenë përkrahur nga vetë paleontologët evolucionistë që nga vitet e 1970-ta. Biologjia moderne ka shpjeguar se qeniet e gjalla nuk janë rezultat i rastit dhe ligjeve natyrore, por se çdo organizëm është sistem kompleks që shfaqet me një dizajn të intelegjencës që tregon se është dëshmi e krijimit. (Për më shumë detale shikoni librin e Harun Yahya-së "Përgënjeshtrimi i Darvinizmit: Si rrënohet teoria e evolucionit nën dritën e shkencës moderne").

Përveç kësaj, pohimi i gabuar se besimi fetar ishte faktori që pengoi njerëzimin nga përparimi dhe që e futi në konflikt ka qenë e përgënjeshtruar nga historia. Humanistët pohonin se distancimi

nga besimi fetar mund t'i bëj njerëzit më të lumtur dhe të ndihen më rehatshëm, por, e kundërta ka dëshmuar të jetë e vërtetë. Gjashtë vjet pas botimit të Manifestit të Parë Humanist, shpërtheu Lufta e Dytë Botërore, dhe nga ideologjia laike fashiste u bënë shkatërrime rekorde nëpër tërë botën.

Ideologjia humaniste e komunizmit u shkatërrua, së pari në Bashkimit Sovjetik, e pastaj në Kinë, Kamboxhë, Vietnam, Kore Veriore, Kubë dhe vende të ndryshme afrikane dhe amerikolatine, me një egërsi të paparë. 120 milion njerëz ishin vrarë nga regjimet dhe organizatat komuniste. Është evidente se edhe tipi perëndimor i humanizmit (në sistemet kapitaliste) nuk ka pasur sukses që të sjell paqë dhe lumturi në vetë shoqërinë e as në vendet tjera të botës.

Dështimi i argumentit humanist mbi fenë ka qenë i manifestuar edhe në fushën e filozofisë. Legjenda e Freudit (Frojdit), gurthemel i dogmës ateiste që nga vitet e para të viteve të 20-ta, ka qenë e zhvlerësuar nga të dhënat empirike. Patrick Glynn, nga Universiteti George Washington, e shpjegon këtë fakt në librin e tij "Zoti: Evidenca, pajtimi mes fesë dhe arsyes në botën post-sekulare".

Kuartali i fundit i shek. 20-të nuk ka qenë i butë ndaj vizioneve psikoanalitike. Më e rëndësishmja ka qenë ekspozimi i pikëpamjeve të Freudit ndaj fesë (pa e përmendur një sërë çështjesh tjera), si krejtësisht i pasaktë. Në mënyrë mjaft ironike, hulumtimet shkencore në 25 vjetët e fundit kanë treguar se larg nga të qenurit neuroz apo burimit neuroz siç pohonte Freudi dhe pasuesit e tij, besimi fetar gati më së shumti ka lidhshmëri me shëndetin e përgjithshëm mental dhe lumturinë. Studim pas studimi është kuptuar se ekziston një mardhënie e fuqishme mes besimit fetar dhe praktikës, në njërën anë, dhe sjelljet e shëndosha sa i përket problemeve siç janë vetëvrasja,

alkooli, përdorimi i drogës, shkurorzimi, depresioni, e ndoshta edhe çka është befasuese, edhe niveli i kënaqësisë seksuale, në anën tjetër. 37

Shkurtimisht, justifikimi i supozuar shkencor prapa humanizmit është dëshmuar si i pavlerë dhe premtimet e dhëna si të kota. Përpos kësaj, humanistët nuk e braktisën filozofinë e tyre, por në të vërtetë, u përpiqën që t'a përhapin atë përmes metodave të propagandës në popull. Posaçërisht, në vitet e pasluftës u intensifikua propaganda humaniste në fushat e shkencës, filozofisë, muzikës, letërsisë, artit dhe filmit. Porositë tërheqëse por të zbrazta të krijuara nga ideologjitë humansite kanë qenë të imponuara me këmbëngulje në popull. Kënga "Imagine" (Paramendo) nga John Lennon, solist i njërës ndër grupet më të popullarizuara të të gjitha kohërave "The Beatles", është një shembull i tillë:

Imagine there's no heaven

It's easy if you try

No hell below us

Above us only sky

Imagine all the people

Living for today...

Imagine there's no countries

It isn't hard to do

Nothing to kill or die for

And no religion too...

You may say I'm a dreamer

But I'm not the only one

I hope someday you'll join us

And the world will be as one

Paramendo se parajsa nuk ekziston

Është lehtë nëse pak përpiqesh

As ferri nën tokë

E lartë vetëm qielli qëndron

Paramendo të gjithë njerëzit

Të jetojnë vetëm për të sotmen...

Paramendo se as shtetet nuk ekzistojnë

As kjo nuk është shumë vështirë

As ndonjë gjë për të cilën mund të vdesësh apo të vrasësh

Gjithashtu edhe pa religjion...

Mund të thuash se jam vetëm ëndrrimtar

Por nuk jam i vetmi

Shpresoj se një ditë do të n’a bashkangjitësh

Dhe bota do të jetë e tëra njësoj.

Kjo këngë është e zgjedhur si “kënga e shekullit” në anketat e ndryshme që janë mbajtur në vitin 1999. Ky është një tregues i qartë i sentimentit në të cilin humanizmi, në mungesë të çfarëdo baze shkencore apo racionale, i është imponuar masës. Humanizmi nuk mund të bëj vërejtje të arsyeshme fesë apo të vërtetës që ajo mëson, përveç tentimeve që të praktikojë metoda të pahijshme sikur këto.

Kur premtimet e vitit 1933 nga Manifesti i Parë Humanist u treguan të kota, pas 40 vitesh ata prezentuan draftin e dytë. Në fillim teksti ishte një tentim që të shpjegonte pse premtimet e para nuk sollen rezultat. Përkundër faktit se ky shpjegim ishte skajmërish i dobët, ajo demostronte dashurinë e vazhdueshme të humanistëve ndaj filozofisë së tyre ateiste.

Karakteristikat më të dalluara të Manifestit ishte ruajtja e vijës antifetare të Manifestit të vitit 1933:

Sikurse në vitin 1933, humanistët ende besonin se ateizmi tradicional, posaçërisht besimi në lutje-dëgjimin e Zotit, besimi që të jetohet dhe të kujdeset për njerëzit, të dëgjohen dhe kuptohen lutjet e tyre, si dhe aftësia për të bërë diçka për t’a, është një besim i padëshmuar dhe jashtë trendit... Ne besojmë... se fetë tradicionale dogmatike apo autoritare që vendosin Shpalljen, Zotin, ritualin

apo kredon mbi nevojat e njeriut dhe përvoja, e dëmtojnë njeriun... Si ateistë, ne fillojmë me njerëzit e jo me Zotin, me natyrën e jo adhurimin. 38

Ky është vetëm një shpjegim shumë sipërfaqsor. Në mënyrë që të kuptohet feja, njeriut së pari i nevojitet intelegjenca dhe gjykimi që të jetë i aftë të kuptojë idetë e thella. Si parakusht duhet të jetë sinqeriteti dhe distancimi nga paragjykimet. Në vend të kësaj, humanizmi nuk është më shumë se përpjekje e disa njerëzve ateistë dhe antifetarë të pasionuar që nga fillimi, që t'a prezentojnë këtë paragjykim si të arsyeshëm.

Sidoqoftë, përpjekjet e humanistëve që të shpjegojnë besimin në Zot dhe fetë monoteiste si të pabaza dhe besim demodé, në të vërtetë nuk është ndonjë gjë e re, por është një garë e çështjes që është filluar para mijëra vjetësh nga ata që e mohuan Zotin. Në Kur'an, Zoti spjegon këtë argument të vjetër të inicuar nga jobesimtarët:

Zoti juaj (që meriton adhurim) është një Zot, E ata që nuk e besojnë botën tjetër, zemrat e tyre janë mohuese (të njësisë së Zotit) dhe ata janë kryelartë.

Është e vërtetë se All-llahu e di atë që e fshehin dhe atë që e shfaqin haptazi dhe se Ai nuk i do arrogantët.

Kur atyre u thuhet (mohuesëve): Ç'është ajo që shpalli Zoti juaj?", ata thonë: "Mite të popujve të hershëm!"

Kur'an (16: 22-24)

Ky ajet zbulon se arsyeja e vërtetë e mohimit të fesë nga jobesimtarët është arroganca e fshehur në zemrat e tyre. Filozofia e quajtur humanizëm është vetëm një veprim i sipërfaqshëm që mohon Zotin. Me fjalë tjera, humanizmi nuk është mënyrë e re e të menduarit, sikurse pohojnë pasuesit e tij, por është një pikëpamje e vjetër dhe e lashtë e atyre që mohuan Zotin nga arroganca.

Kur të shikojmë në përparimin e humanizmit përgjatë historisë europiane, gjejmë shumë dëshmi të forta për këtë pohim.

## RRËNJËT E HUMANIZMIT NË KABALA

Kemi parë se Kabala është doktrinë që daton që nga koha e Egjiptit të vjetër, dhe ka hyrë në fé duke e ndotur atë që Zoti ua pat shpallur izraelitëve. Gjithashtu kemi parë se në bazën e saj qëndron në mënyrën e gabuar e kuptimit ku konsiderohet qenia njerëzore si qenie jo e krijuar edhepse konsiderohen si krijesa hyjnore që kanë ekzistuar përjetësisht humanizmi në Europë ka hyrë ga ky burim. Besimi i krishterë ishte i bazuar në ekzistimin e Zotit, dhe besimin se njerëzit ishin shërbëtorë të varur nga Ai dhe të krijuar nga Ai. Por me përhapjen e traditës së Tamplierëve përgjatë Europës, Kabala filloi që të tërheq një numër të filozofëve. Kështu, në shek. e 15-të, rryma e humanizmit filloi që të lë shenjë të pashlyer në botën ideore europiane.

Kjo lidhshmëri mes humanizmit dher Kabalës ka qenë e theksuar në disa burime. Njëra ndër burimet është libri i autorit të famshëm Malachi Martin, "Çelësat e këtij gjaku" (The Keys of This

Blood). Martini është profesor i historisë ë Institutin e Biblës Papnore të Vatikanit. Ai thotë se ndikimi i Kabalas mund të vërehet shumë qartë në mesin e humanistëve.

Në këtë ambient të pazakonshëm të paqartësisë dhe sfidës që erdhi për të shënjuar Italinë në Renesansën e hershme, aty u lind një rrjet e shoqatave të humanistëve me aspirata që t'i shmangeshin kontrollit të përgjithshëm nga ky rend i themeluar. Aspiratat e transmetuara në këtë mënyrë, këto shoqata ekzistonin që të mbrojnë fshehtësitë, së paku në fillim. Por pavarsisht nga natyra e fshehtë e tyre, këto grupe humanistësh dalloheshin nga dy karakteristika tjera kryesore.

Në fillim ata ndjenin neveri ndaj interpretimit tradicional të Biblës siç pohonin autoritetet civile dhe klerike, dhe kundër mendimeve filozofike dhe teologjike nga Kisha për jetën politike dhe qytetare.

Nuk është për t'u befasuar se pas kësaj armiqësie, këto shoqata kishin konceptin e tyre të porosisë origjinale në Bibël dhe në shpalljen e Zotit. Ata kapeshin pas asaj që ata e konsideronin të jetë një trup ultra sekret i njohurisë, një "gnos", që ata e bazuan një pjesë nga linjat filozofike dhe okultiste me prej ardhje nga Afrika Veriore- e veçanarisht nga Egjipti- dhe një pjesë nga Kabala e çifutëve...

Humanistët italianë ndryshuan idenë e Kabalas gati sa nuk përngjante fare në të. Ata rindërtuan konceptin e "gnosë" dhe e transferuan krejtësisht në nivelin e kësaj fjale. "Gnosi" i veçantë që ata kërkonin ishin njohuri e fshehtë se si të zotërohen forcat e errëta të natyrës për qëllime socio-politike. 39

Shkurtimisht, shoqatat humaniste të formuara atë kohë dëshironin që të zëvendësonin kulturën katolike europiane me një kulturë që i kishte rrënjët në Kabala. Ata synonin që të bënin ndryshime socio-politike. Është interesante se përveç Kabalas, në burim të kësaj kulture të re ishin doktrinat nga Egjipti i vjetër. Profesori Martin shkruan:

Nismëtarët e këtyre shoqatave të hershme humaniste ishin të devotshmit e Forcës së Madhe-Arkitektit të Madh të Gjithësisë- që u përfaqësonin nën formën e Tetragramatonit të Shenjtë YHWH... (humanistët) huazuan simbolet tjera-Piramidën dhe Syrin Gjithëpamës- kryesisht nga Egjipti. 40

Është mjaft interesant se humanistët përdorin konceptin e "Arkitektit të Madh të gjithësisë", si shprehje që edhe sot përdoret tek masonët. Kjo tregon se duhet të ketë lidhshmëri mes humanistëve dhe masonëve. Profesori Martin shkruan:

Në klimat tjera veriore, në ndërkohë, një shoqatë shumë më e rëndësishme zën vend, me humanistët. Një shoqatë që askush nuk e ka pritur.

Në vitet 1300, gjatë kohës kur shoqatat kabaliste-humaniste ishin në fillimin e tyre që të gjejnë orientimin e tyre, ata ekzistonin edhe më herët-në Angli, Skoci dhe Francë- shoqëri esnafe mesjetare...

Askush në vitet 1300 nuk kishte parashikuar një shkrirje të tillë mendimesh mes esnafeve të masonëve dhe humanistëve italianë...

Masoneria e re ndryshon nga aleanca me klerin e krishterë romak. Dhe prapë, sikurse për humanistët okultë italian, sekreti i garantuar nga tradita e llozhës ishte qenësor në këto rrethana.

Këto dy grupacione kishin më tepër të përbashkët sesa sekreti, megjithatë nga shkrimet dhe të dhënat e Masonerisë teorike është qartë se dogma qendrore fetare shëndrrohet në një besim në Arkitektin e Madh të Gjithësisë- një figurë e njohur nga ndikimi i humanistëve italianë... Arkitekti i Madh ishte i brendshëm dhe esencial i një pjesë të kosmosit material, një produkt i mendjes së "ndritur".

Nuk kishte bazë konceptuale me të cilin një besim mund të pajtohej me krishterizmin. Për prehjen e rrugës së ideve siç janë: mëkati, ferri për dënim dhe parajsa për shpërblim dhe Vetëmohimi i përhershëm i meshës, shenjëtorët dhe engjujt, prifti dhe papa. 41

Shkurt, në Europë, në shek. e 14-të, një organizatë humaniste dhe masonike u lind gjersa rrënjët i kishte në Kabala. Kjo organizatë nuk përfillte Zotin, ashtu siç bënin çifutët, të krishterët dhe muslimanët; si Krijues dhe Sundues i tërë gjithësisë dhe i vetmi Zot i njerëzimit. Përkundër kësaj, ata përdornin konceptet si "Arkitekti i Madh i Gjithësisë", që ata pranuan dhe të qenurit "pjesë e gjithësisë materialiste".

Me fjalë të tjera, kjo organizatë sekrete që u paraqit në Europën e shek. të 14-të, mohoi Zotin, por nën konceptin e "Arkitektit të Madh të Gjithësisë" pranoi universin si një gjë hyjnore.

Për definim më të qartë të këtij besimi të gabuar, mund të shkojmë në shek. e 20-të dhe të vështrojmë pak literaturën masonike. P.sh. njëri ndër masonët më të vjetër turk, Selami Isindag, ka botuar librin "Inspirimet nga masonët" (Masonluktan Esinmeleler). Qëllimi i këtij libri është që t'i trajnoj masonët e rinj. Sa i përket besimit masonist në "Arkitektin e Madh të Gjithësisë", ai thotë:

Masoneria nuk është ateiste. Por koncepti i Zotit që ata kanë adoptuar ndryshon nga ajo fetare. Zoti i Masonerisë është një princip i lavdëruar. Është në kulm të evolucionit. Me kritikën ndaj qenies sonë të brendshme, duke njohur vetveten dhe duke ecur me maturi në rrugën e shkencës, intelegjencës dhe virtytit, mund të zvoglohet këndvështrimi mes tij dhe nesh. Nuk është i personifikuar. Nuk është menduar udhërrëfyes i natyrës apo njerëzimit. Është arkitekt i madh që punoi gjithësinë, njësinë si dhe harmoninë e saj. Kjo është totali i të gjitha krijesave, fuqi totale që përfshinë çdo gjë, bile edhe energjinë. Pavarsisht nga e tëra kjo, nuk mund të pranohet se është fillimi... ky është një mister i madh. 42

Në librin e njejtë, është e qartë se kur masonët flasin për "Arkitektin e Madh" ata mendojnë në natyrën, apo, ata e adhurojnë natyrën:

Ndryshe nga natyra nuk mund të jetë ndonjë fuqi që është përgjegjëse për mendimet tona dhe veprat tona... Principet dhe doktrinat e Masonerisë janë fakte shkencore të bazuara në shkencë dhe intelegjencë. Zoti është evolucioni. Element i Tij është fuqia e natyrës. Në këtë mënyrë realiteti absolut është vet evolucioni dhe energjia përreth saj. 43

Revista "Mimar Sinan", organizatë botuese ekskluzivisht për frankmasonët turq, gjithashtu shprehet për filozofinë e njejtë masonike:

"Arkitekti i Madh i Gjithësisë" është me afinitet në drejtim të amshimit. Është një derë për në përjetësi. Për ne, ky është shtegu. Ky kërkon një hulumtim të vazhdueshëm për synimin e përsosmërisë në përjetësi. Ai krijon largësinë mes çastit të tanishëm dhe mendimit masonist, apo vetëdijës. 44

Ky është besimi i masonëve kur thonë: “Ne besojmë në Zot, ne absolutisht nuk pranojmë ateistë në radhët tona”. Nuk është Zoti ai që masonët adhurojnë, por konceptet natyraliste dhe humaniste si natyra, evolucioni dhe humanizmi i hyjnizuar me filozofinë e tyre.

Nëse hedhim një shikim të shkurtë në literaturën masonike, mund të shohim se kjo organizatë nuk është më tepër se humanizëm i organizuar, si dhe të identifikojmë se qëllimi i saj është krijimi i një rendi ateist dhe humanist në tërë botën. Këto ide kishin lindur në mesin e humanistëve europian të shek. të 14-të; e që edhe sot masonët ende i propozojnë dhe i mbrojnë.

## HUMANIZMI MASONIK: ADHURIMI I HUMANIZMIT

Publikimet interne të masonëve tregojnë në detale filozofinë humaniste të organizatës dhe armiqësinë e tyre ndaj monoteizmit. Aty ofrohen shpjegime të panumërta, interpretime, citime dhe alegori që kanë të bëjnë me këtë çështje në botimet masonike.

Siç thamë në fillim, humanizmi i’a ka kthyer shpinën Krijuesit të njerëzimit dhe i ka pranuar njerëzit si “forma më e lartë e qenieve në gjithësi”. Në të vërtetë, kjo nënkupton adhurimin e njerëzve. Ky besim iracional, që fillon me humanistët kabalistë në shekujt 14-të dhe 15-të, vazhdon të jetojë edhe sot në masonerinë moderne.

Njëri ndër humanistët më të mëdhenj të shek. të 14-të ishte Pico Della Mirandola. Vepra e tij “Konkluzionet filozofike, kabaliste dhe teologjike” (Conclusiones philosophicae,

cabalisticae, et theologicae) ishte dënuar nga Papa i 8-të i Pafajshmi më 1489, pasiqë kjo vepër përmban ide heretike. Mirandola shkroi se nuk ka asgjë më të lartë në botë se madhështia e humanitetit. Këtë Kisha e ka parë si ide heretike që nuk ishte asgjë më pak se adhurimi i njeriut. Në të vërtetë, kjo ishte ide heretike, pasi asnjë qenie nuk duhet të madhërohet përveç Zotit. Humaniteti apo njeriu është vetëm një krijim i Tij.

Sot, masonët e shfaqin idenë heretike të Miradolas shumë hapur. P.sh. një broshurë lokale masonike shkruan:

Shoqëritë primitive ishin të dobta, dhe për shkak të kësaj dobësie, ata i bënë gjëra hyjnore fuqitë dhe fenomenet përreth tyre. Por Masoneria e bën hyjnore vetëm humanitetin. 45

Në librin "Çelësat e humbur të Frankmasonerisë" (The Lost Keys of Freemasonry). Manly P. Hall shpjegon se kjo doktrinë masonike humaniste kthehet prapa në Egjiptin e vjetër:

Njeriu është zot në krijim, dhe sikurse mitet egjiptiane, në rrotën e poçarit, ai ishte mykur. Kur drita e ndriçon ashtuqë t'i ngrisë dhe t'i ruajë të gjitha gjërat, ai merr kurorën e trefishtë të hyjnisë, dhe i bashkohet turmës së masonëve kryesorë apo Master Masonëve, të cilët me veshjen e tyre ceremoniale ngjyrë të kaltër dhe në të artë, kërkojnë që të largojnë errësirën e natës me dritën e trefishtë të Lozhës Masonike. 46

Me fjalë tjera, sipas besimit të gabur të Masonerisë, njerëzit janë zotëra, por vetëm një grandmaster (kryetar i urdhërit) e arrinë plotësisht këtë hyjni. Mënyra se si arrihet titulli grandmaster, është që plotësisht të mohohet besimi në Zot dhe faktin se njerëzit janë shërbëtorë

të Tij. Ky fakt preket pak edhe nga një shkrimtar tjetër, J.D. Buck në librin e tij "Masoneria mistike" (Mystic Masonry):

I vetmi zot që Frankmasoneria e pranon është humaniteti në toto... Pra humaniteti është i vetmi zot personal. 47

Në mënyrë evidente, Masoneria pra është një lloj religjioni. Por, nuk është fé monoteiste; është një religjion humanist dhe, në këtë mënyrë është një fé false. Asaj i pëlqen të adhurojë humanitetin, e jo Zotin. Shkrimet masonike insistojnë në këtë çështje. Në një artikull të revistës turke "Masoni turk" (Türk Mason), shkruan: "Ne gjithmonë pranojmë se ideali i lartë i Masonerisë qëndron në doktrinën e humanizmit." 48

Një publikim tjetër turk spjegon se humanizmi është religjion.

Është larg nga predikimet e thata si në dogmat fetare, dhe është religjion i vërtetë. Humanizmi ynë në të cilin kuptimi i jetës i ka rrënjët do t'i plotësojë dëshirat për të cilat rinia as që është e vetëdijshme për këtë gjë. 49

Si masonët e servojnë këtë religjion të rremë në të cilin ata besojnë? Për t'a kuptuar këtë, duhet që të shikohet më afër në porositë që ata i distributojnë në shoqëri.

## TEORIA E MORALIT HUMANIST

Sot, masonët në shumë vende janë shumë të angazhuar që t'a prezentojnë veten pjesës tjetër të shoqërisë. Duke shfrytëzuar konferenca shtypi, faqe në internet, shpallje dhe deklarata në shtyp, ata e prezentojnë veten si organizatë që është e dedikuar vetëm për të mirëqenien e shoqërisë. Në disa vende zatën ka edhe organizata bëmirëse që përkrahen nga masonët.

E njejta gjë është thënë edhe nga organizatat e Rotary and Lion's Club, që janë verzione më të "lehta" të Masonerisë. Të gjitha këto organizata insistojnë në atë se ata janë duke punuar për të mirën e shoqërisë.

Padyshim, për të punuar për të mirën e shoqërisë nuk është një ndërmarrje për dekurajim, dhe nuk ka vërejtje në këtë. Por, pas deklaratave të tyre gjendet një porosi mashtruese. Masonët pohojnë se mund të ketë moral pa religjion, dhe ky moral mund të vendoset në botë pa religjion. Dhe, qëllimi në sfond të punës së tyre bëmirëse është që të shpërndahet kjo porosi në shoqëri.

Do të shohim pse ky pohim është aq mashtrues. Por, para saj, do të ishte mirë mirë që të kemi parasysh pikëpamjet e masonëve në lidhje me këto çështje. Në faqen e internetit të masonëve, mundësia e "moralit pa religjion" është shpjeguar kështu:

Çka është njeriu? Nga ka ardhur dhe ku është duke shkuar?... Si jeton një njeri? Si duhet ai të jetojë? Fetë përpiqen që t'i përgjigjen këtyre pyetjeve me ndihmën e parimeve morale për ata që e kanë përgaditur. Pa marrë parasysh se si e bëjnë lidhmërinë e parimeve të tyre në konceptet metafizike si Zoti, parajsa, ferri, adhurimi. Dhe njerëzit duhet që të gjejnë principet e tyre për jetë pa u përzier në çështjet metafizike, që ata duhet të besojnë në të, pa e kuptuar. Frankmasoneria ka

deklaruar këto parime me shekuj siç janë liria, barazia, vëllazërimi, dashuria ndaj punës dhe paqja, demokracia etj. Kjo e liron njeriun krejtësisht nga besimi në fé por ende paraqet parimet e jetës. Ata kërkojnë bazën e tyre jo në konceptin metafizik por brenda njeriut që jeton në këtë botë. 50

Masonët që mendojnë në këtë mënyrë janë krejtësisht në papërputhshmëri me besimtarin që duke besuar në Zotin dhe duke demostruar aktet e bëmirësisë ashtuqë të fitojë pëlqimin e Tij. Për ta, çdo gjë duhet të bëhet vetëm për hir të humanitetit. Ne mund t'a shohim qartë këtë mënyrë të të menduarit në librin e botuar nga llozhat turke.

Morali masonik është bazuar në dashurinë ndaj humanizmit. Dhe plotësisht përjashton mundësinë që duke qenë i mirë me shpresë për në të ardhmen, një përfitim, shpërblim dhe parajsë, jo nga frika nga tjetërkush, institut religjioz apo politik, fuqitë e panjohura mbinatyrale... Ajo vetëm shoqërohet dhe lavdëron mundësinë për të qenë i mirë në lidhje me dashurinë ndaj familjes, vendit, njerëzëve dhe humanizmit. Kjo është njëri ndër qëllimet më të rëndësishme të zhvillimit masonik. Të duash njerëzit dhe të jesh i mirë pa pritur diçka si shpërblim dhe të arrihet ky nivel është zhvillimi më i madh. 51

Pohimet në citatin e mësipërm janë shumë çorientuese. Pa disciplinë morale të religjionit nuk mund të ketë kuptim vetëflijimi për pjesën tjetër të shoqërisë. Dhe, kur kjo mund të shfaqet pa qenë e përkryer, mardhëniet janë vetëm sipërfaqësore.

Ata që nuk kanë sens të moralit fetar nuk i frigohen Zotit apo nuk e respektojnë Atë, dhe në ato vende ku nuk ka frikë ndaj Zotit, njerëzit brengosen vetëm për përfitim personal. Kur njerëzit mendojnë se interesi personal është në rrezik, ata nuk mund të shfaqin dashurinë e vërtetë, besnikërinë apo miqësinë. Ata shfaqin dashuri dhe respekt vetëm ndaj atyre që mund të kenë

përfitime nga ata. Kjo është kështu për shkak se, sipas kësaj ideje të tyre të gabuar, ata jetojnë vetëm njëherë dhe, në këtë mënyrë, ata do të marrin nga ajo është e mundur. Pavarsisht nga kjo, sipas këtij besimi të rremë, nuk ka ndëshkim për çdo jondershmëri apo të ligë që ata shkaktojnë.

Literatura masonike është e mbushur plot me predikime morale me të cilat përpiqen që të anashkalojnë këtë fakt. Por, në të vërtetë, ky moral pa religjion nuk është asgjë përpos një retorikë e maskuar. Historia është përplot me shembuj që tregojnë se pa vetë-disciplinë që feja predikon mbi shpirtin e njeriut, dhe se pa ligj hyjnor, morali i vërtetë në asnjë mënyrë nuk mund të vendoset.

Një shembull i habitshëm i kësaj është Revolucioni i Madh Francez më 1789. Masonët, që nxitën revolucionin, dolën përpara duke bërtitur parulla me ideale morale të "lirisë, barazisë dhe vëllazërisë". Sidoqoftë, me dhjetëra mijëra njerëz të pafajshëm janë ekzekutuar nën gilotinë, kështuqë ky vend ishte i vërshuar me gjak. Bile edhe vetë udhëheqësit e revolucionit nuk arritën t'i iknin kësaj egërsie, kështuqë edhe ata u ekzekutuan nën gilotinë, njëri pas tjetrit.

Në shek. e 19-të, lindi socializmi nga ideja e mundësisë së moralit pa religjion, dhe me rezultate edhe më katastrofike. Socializmi supozohej se kërkonte drejtësi, shoqëri të barabartë në të ciln nuk do të ketë eksploatim dhe në fund, propozuan shfuqizimin e fesë. Sidoqoftë, në shek. e 20-të, në vendet e Bashkimit Sovjetik, Blloku Lindor, Kina, Indokina, si dhe në disa vende në Afrikë dhe Amerikën Qëndrore, ai i ekspozoi njerëzit në një mjerim të tmerrshëm. Regjimet komuniste vranë një numër të pabesueshëm të njerëzëve; me gjithësejt rreth 120 milionë. 52 Përveç kësaj, ndryshe nga ajo që pohonin, si drejtësi dhe barazi, këto gjëra kurrë nuk u jetësuan në asnjërin regjim komunist; udhëheqësit komunistë ishin përgjegjës në shtetin e tyre që përbëhej nga klasa

elite (Në librin e tij klasik “Klasa e re” (The New Class), të mendimtarit jugosllav, Milovan Djilas, shpjegohet se liderët komunistë, të njohur si “nomenklaturë”, formuan një “klasë të privilegjuar” që ishte në kundërshtim me pohimet e socializmit.).

Edhe sot, gjithashtu, kur e shohim vetë Masonizmin, që pandërprerë proklamojnë idetë e tyre “të shërbimit ndaj shoqërisë” dhe “sakrificës për humanitet”, nuk do të gjejmë të dhëna të qarta. Në shumë vende, Masoneria ka qenë fokus i mardhënieve për përfitime materiale. Skandali në llozhën masonike italiane P2 më 1980, është zbuluar se masonët mbanin lidhje të ngushta me mafian, dhe se drejtorët e llozhave ishin angazhuar sulme kundër rivalëve të vet dhe kundër atyre që i kishin tradhëtuar. Në “Skandalin e madh të llozhës lindore” në Francë më 1992 dhe në operacionin “Duart e pastra” në Angli, të botuar në shtyp më 1995, aktivitetet e llozhave masonike në interesimin për përfitim ilegal u bë e qartë. Ideja masonike e “moralit njerëzor” është vetëm një mashtrim.

Që gjëja e tillë të ngjante, ishte gjë e paevitueshme, pasiqë, siç thamë në fillim, morali është vendosur në shoqëri nga disciplina morale e fesë. Në themelin e moralit qëndron mungesa e arrogancës dhe e egoizmit, dhe vetëm ata që mund të arrijnë këtë nivel janë ata që e kuptojnë përgjegjësinë e vet para Zotit. Në Kur’an, pasi Zoti n’a tregon për vetëflijimin e besimtarëve, Ai urdhëron: “...Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar. Kur’an (59: 9) . Ky është themeli i vërtetë i moralit.

Në suren Furkan në Kur’an, natyra e moralit të besimtarëve të vërtetë përshkruhet kështu:

E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë:

"Paqë!"

Dhe që për hir të Zotit të tyre natën e kalojnë duke i bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë (falen).

Edhe ata që thonë: "Zoti ynë, largoje prej nesh vuajtjen e Xhehennemit, e s'ka dyshim se vuajtja në të është gjëja më e rëndë".

Ai, vërtet është vendqëndrim dhe vendbanim i keq.

Edhe ata që kur shpenzojnë nuk e teprojnë e as nuk janë dorështrënguar, por mbajnë mesataren e janë të matur.

Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin.

Atij i dyfishohet dënimi ditën e kijametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë.

Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve All-llahu të këqiat ua shëndrron në të mira. All-llahu është mëshirues, ndaj Ai falë shumë.

Ai që është penduar dhe ka bërë mirë, në të vërtetë, ai është kthyer te All-llahu dhe është i pranishëm.

(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet.

Edhe ata që kur këshillohen me ajetet e Kur'anit të Zotit të tyre, nuk u kthejnë shpinën si të shurdhët e të verbër.

Kur’an (25: 63-73)

Kjo është edhe detyra themelore e besimtarëve që të iu binden Zotit deri në përulje, “mos ia u kthe shpinën atyre, sikur të ishin të shurdhër dhe të verbër kur ata përkujtojnë shenjat e Tij”.

Për shkak të kësaj detyre, njeriu ruhet nga egoizmi, kënaqësitë e kësaj bote, ambicjet dhe shqetësimet që të pëlqehet nga të tjerët. Lloji i moralit të përmendur në ajetet e mësipërme arrihet vetëm në këtë mënyrë. Për këtë shkak, në një shoqëri ku mungon dashuria dhe frika ndaj Zotit dhe besimi në Të, aty nuk ka moral. Pasiqë asgjë nuk mund absolutisht të përcaktohet, secili llogaritë se çfarë është e drejtë e çka jo, sipas vullnetit të vet.

Në të vërtetë, qëllimi primar i filozofisë sekular-humaniste morale e masonëve është, jo që të themelojë një botë të moralshme, por të vendosë një botë jofetare. Me fjalë tjera, masonët nuk e përqafojnë filozofinë humaniste për shkak se ata i japin rëndësi të madhe moralit, por vetëm që të bëjnë transmetimin e idesë në shoqëri se religjioni nuk është i domosdoshëm.

## QËLLIMI I MASONËVE: THEMELIMI I NJË BOTE HUMANISTE

Filozofia humaniste që masonët e konsiderojnë aq shumë, bazohet në mohimin e besimit në Zot dhe adhurimin e njerëzve, apo respektimin e "humanizmit" në vendin e Tij. Por kjo shtron një pyetje të rëndësishme: a e rezervojnë këtë besim masonët vetëm për vete, apo dëshirojnë që ky besim të përqafohet edhe nga të tjerët, gjithashtu?

Kur hedhim një shikim shkrimeve masonike, mund të shofim qartë përgjegjen në këtë pyetje: qëllimi i kësaj organizate është që të përhapet filozofia humaniste në tërë botën dhe të çrrënjosë fetë monoteiste (islamizmin, krishterizmin dhe judaizmin).

Për shembull, në një artikull të botuar në revistën e masonëve Mimar Sinan, thuhet: "Masonët nuk gjurmojnë origjinën e ideve të së keqes, drejtësisë dhe ndershmërisë përtej botës fizike, por ata besojnë se këto gjëra lindin nga kushtet shoqërore të njeriut, mardhëniet shoqërore dhe për çfarë ai përpiqet gjatë jetës së vet", dhe shtohet, se "Masoneria përpiqet që t'i plasojë këto ide anë e mbanë rruzullit tokësor". 53

Selami Isindag, një mason i vjetër turk, shkruan:

Sipas Masonerisë, në mënyrë që të shpëtohet njerëzimi nga një moral i mbinatyrshëm i bazuar në burime fetare, është e domosdoshme që të vendoset një moral që bazohet në dashuri ndaj humanizmit që nuk është relativ. Në parimet e veta morale tradicionale, Masoneria ka marrë në konsideratë prirjen e organizimit të njeriut, nevojat e tij dhe kënaqësitë, rregullat e jetës shoqërore

dhe organizatat e tyre, vetëdijen, lirinë e të të menduarit dhe të fjalës, dhe, në fund, të gjitha gjërat që shkojnë në formulimin e jetës natyrale. Për këtë shkak, qëllimi i tij është që të vendoset dhe të nxis moralin njerëzor në të gjitha shoqëritë. 54

Se çfarë mendon master-masoni turk, Isindag, më tutje, thuhet: "Shpëtimin e mijëra njerëzëve nga një moral i bazuar në burime fetare" është largimi i njerëzëve nga feja. Në të njejtin libër, Isindag shpjegon qëllimin e tij dhe të librit sipas "parimit për vendosjen e një qytetërimi të avansuar".

Parimet pozitive të Masonerisë janë të domosdoshme dhe të mjaftueshme për vendosjen e një qytetërimi të avansuar. Ato parime janë:

- Pranimi se zoti i papërcaktuar (Arkitekti i Madh i Gjithësisë) është vetë evolucioni;

- Mohimi i besimit në shpalljet, misticizmi dhe besimet e kota;

- Superioriteti i humanizmit racional dhe puna.

Tri pikat e para kërkojnë mohimin e ekzistencës së Zotit. (Masonët nuk besojnë në Zot, por në Arkitektin e Madh të Gjithësisë, dhe citati më lart tregon se me këtë term, ata mendojnë në evolucionin.) Pika e dytë mohon shpalljet nga Zoti dhe njohurive fetare të bazuar në të. (Isindag këtë vetë e definon si "besime të kota".) Dhe pika e tretë ngre lart humanizmin dhe konceptin humanist të "punës" (sikur në komunizëm).

Nëse e marrim parasysh se si rrënjosen këto ide në botë sot, mundemi bile edhe t'a çmojmë ndikimin masonik në të.

Aty është edhe një gjë tjetër e rëndësishme që duhet komentuar: Si Masoneria vuri në lëvizje misionin e vet kundër religjionit? Kur t'a hudhim një sy shkrimeve masonike, shofim se ata dëshirojnë që t'a shkatërrojnë religjionin, posaçërisht në nivelin shoqëror, me mjetet e "propagandës" në masë. Mastermasoni Isindag hedh mjaft dritë mbi këtë çështje:

...Bile edhe regjimet tepër represive nuk kanë qenë tepër të suksesshme në përpjekjet e tyre që t'i shkatërrojnë institucionet fetare. Në të vërtetë, tejkalimet në vrazhdësinë e metodave politike, në përpjekjet e tyre që t'a nxjerrin shoqërinë nga padituria me shpëtimin e njerëzëve nga besimi në fetë e kota dhe dogmat kanë prodhuar një reaksion të kundërt: vendet e adhurimit që ata dëshironin që t'i mbyllnin sot janë më të mbushura se kurrë më parë, dhe besimi dhe dogmat që ata i shpallën joligjore u bënë bile edhe me më shumë pasues. Në një vend tjetër ne theksuam se në çështjet që prekin zemrën dhe ndjenjat, ndalesa dhe forca nuk ka efekt. E vetmja mënyrë që të nxirren njerëzit nga errësira në dritë është shkenca e vërtetë, si dhe parimet e logjikës dhe të arsyes. Nëse njerëzit edukohen sipas këtij parimi, ata do të respektojnë humanizmin dhe anët pozitive të fesë por edhe do të shpëtojnë veten nga besimet e kota dhe dogmat. 55

Ashtuqë të kuptojnë atë çfarë është përmendur këtu, ata duhet që të analizojnë me kujdes. Isindag thotë se represioni i regjimit do të bëjë që fetarët të motivohen edhe më shumë dhe kjo veçsa e forcon fenë. Prandaj, ashtuqë të parandalohet forcimi i fesë, Isindag mendon se masonët duhet shkatërruar fenë në nivelin intelektual. Çfarë ai mendon me "shkencën e vërtetë, parimet e logjikës dhe arsyes", nuk është në të vërtetë shkenca, logjika dhe arsyeja. Çka mendon ai është vetëm një filozofi humaniste dhe materialiste që përdor thëniet si kamulflim, sikur në rastin e darvinizmit. Isindag vlerëson se kur këto shpërndahen në shoqëri "vetëm elementet humaniste në religjion do të fitojnë respekt", çka është, se çfarë do të mbesë nga religjioni do të jenë ato

elemente të miratuara nga filozofia humaniste. Me fjalë të tjera, ata dëshirojnë që të refuzojnë të vërtetën themelore që qëndron në bazën e fesë monoteiste (Isindag i quan besime të kota dhe dogma). Këto të vërteta janë realitet themelor se njeriu është krijuar nga Zoti dhe se është përgjegjës ndaj Tij.

Shkurtimisht, qëllimi i masonëve në shkatërrimin e elementeve të besimit që përbëjnë esencën e fesë. Ata dëshirojnë që të zvoglojnë rolin e fesë në një element kulturor që shpreh idetë e tyre në një numër të çështjeve të përgjithshme morale. Mënyra se si realizohet kjo, sipas masonëve, është imponimi i ateizmit në shoqëri nën maskën e shkencës dhe arsyes. Fundi i fundit, qëllimi i tyre është që të distancojnë fenë nga pozita e vet bile në një shkallë si element kulturor, ashtuqë të themelojnë një botë krejtësisht atesite.

Në një artikull të Isindagut, në revistën "Mason", me titull "Shkenca e vërtetë- pengesat e mendjes dhe Masoneria", ai thotë:

Si rezultat i tërë kësaj, dëshiroj të them se detyra më e rëndësishme humaniste dhe masonike e të gjithë neve nuk është largimi nga shkenca dhe logjika, që të pranohet se kjo është mënyra më e mirë sipas evolucionit, të përhapet ky besim i yni në mesin e njerëzve dhe t'i edukojë njerëzit në shkencën e vërtetë. Fjalët e Ernest Kenanit janë shumë të rëndësishme: "Nëse njerëzit janë edukuar dhe shkolluar në shkencën e vërtetë dhe logjikën, besimet e kota të fesë dhe do të shkatërrohen vetvetiu." Fjalët e Lessingut e mbështesin këtë pikëpamje: "Nëse njerëzit janë të edukuar dhe shkolluar me shkencën dhe logjikën, një ditë feja nuk do të jetë më e nevojshme." 56

Ky është caku përfundimtar i Masonerisë. Ata dëshirojnë që shkatërrojnë tërësisht fenë dhe të vendosin një botë humaniste të bazuar në "shenjtërinë" e humanitetit. Ata dëshirojnë që të

vendosin një rend të ri të injorancës, ku njerëzit do të refuzonin Zotin i cili i krijoi, dhe të konsiderojnë vetveten si një gjë hyjnore... Ky cak është edhe qëllimi i ekzistimit të Masonerisë. Në revistën masonike të quajtur “Ayna” (Pasqyra), kjo quhet “tempulli i ideve”.

Masonët modern kanë ndryshuar qëllimin e masonëve të vjetër që të ndërtojnë një tempull fizik në ndërtimin e idesë së “Tempullit të idesë”. Ndërtimi i Tempullit të Ideve do të jetë i mundur kur vendosen parimet dhe vyrtytet masonike dhe njerëzit e tillë të mençur do të shtohen në tokë. 57

Për të dërguar më tutje këtë synim, masonët punojnë palodhshëm në shumë vende të botës. Organizata masonike ka ndikim në universitete dhe në institucione tjera edukative, në media, në botën e arteve dhe ideve. Kurrë nuk pushon përpjekja që të parapengojnë filozofinë e tyre humaniste në shoqëri dhe që të diskreditojnë të vërtetat e besimit që ka bazë religjionin. Do të shohim më vonë se teoria e evolucionit është njëra është njëra ndër ndër mjetet themelore të masonëve për propagandë. Çka më tepër, qëllimi i tyre është që të ndërtojnë një shoqëri që nuk e përmend bile as emrin e Zotit apo religjionit, por kujdeset vetëm për të plotësuar kënaqësitë dhe dëshirat e njerëzëve dhe ambicjet e tyre në këtë botë. Kjo do të jetë një shoqëri e formuar nga njerëz që kanë bërë (Zotin) në diçka të lënë prapa shpine në mënyrë të mospërfillshme. Ai tha: "O populli im, a është më i çmuar te ju farefisi im se All-llahu, që e keni hedhur Atë pas shpine? Nuk ka dyshim, Zoti im i di të gjitha ato që veproni". Kur’an (11: 92) , ngjajshëm me popullin e Madjanit të përmendur në Kur’an. Në këtë kulturë të injorancës nuk kishte vend për frikë apo dallimi ndaj Zotit, dhe të fitojnë kënaqësinë e Tij, t’a adhurojnë apo të mendojnë për botën e mëpastajme. Në fakt, për këto ide është menduar të jenë jashtë trendi dhe karakteristikë për njerëzit e paedukuar. Kjo porosi vazhdimisht përsëritet nëpër filma, stipa dhe libra.

Në këtë ndërmarrje të madhe të mashtrimit të njerëzve, masonët vazhdimisht luajnë rol udhëheqës. Por, gjithashtu edhe shumë grupacione tjera dhe individë janë të angazhuar në punën e njejtë. Masonët i pranojnë ata si "masonë nderi" dhe llogariten si aleatë të tyre pasi të gjithë përkrahin filozofinë e njejtë. Selami Isindag shkruan:

Masoneria gjithastu pranon këtë fakt: në botën e jashtme ka njerëz të mençur që edhepse nuk janë masonë, përkrahin ideologjinë masonike. Kjo është kështu pasiqë kjo ideologji është krejtësisht një ideologji e njerëzve dhe humanitetit. 58

Lufta këmbëngulëse kundër religjionit qëndron në dy argumente apo justifikime themelore: filozofia materialiste dhe teoria darviniste e evolucionit.

Në dy kapitujt e ardhshme do të shqyrtojmë këto dy justifikime, origjinën e tyre dhe raportet e tyre me Masonerinë. Në këtë mënyrë, do të kemi mundësi që të kuptojmë më qartëse ngjarjet prapa skenës së këtyre ideve që kanë ndikuar në rrjedhat historike në botë që nga shek. i 19-të.

# IV
# RISHIKIMI I MATERIALIZMIT

Në kapitullin e parë të këtij libri, pamë regjimin e faraonit në Egjiptin e vjetër dhe arritëm deri tek disa përfundime të rëndësishme për pikëmbështetjen e filozofisë së tij. Vetia më interesante e mendimit në Egjiptin i vjetër, siç thamë, ka qenë mendim materialist, që është shprehur me mendimin se materia është e përjetshme dhe e pakrijuar. Në librin e tyre "Çelësi i Hiramit" (The Hiram Key), nga Christopher Knight dhe Robert Lomas hasen gjëra të rëndësishme që ka në lidhje me këtë çështje që vlen të përmendet përsëri:

Egjiptasit besonin se materia ekzistonte gjithmonë dhe për ta ishte jashtë logjikës që të marrin me mend se Zoti mund të bëjë diçka nga hiçgjëja absolute. Pikëpamja e tyre ishte se bota fillon kur fillon rregulli të ndahet nga kaosi, dhe që nga atëherë ekziston beteja në mes të forcave të rregullit dhe kaosit...... Kjo gjendje kaotike quhej Nun, dhe sikur në përshkrimet sumeriane..., çdo gjë ishte e errët, humnerë e mugët e lëngshme me një forcë krijuese brenda saj që urdhëroi rregulli të fillojë. Kjo fuqi latente (e fshehtë) që ishte brenda substancës së kaosit që nuk dinte se ekzistonte; ishte një probabilitet (gjasë), një potencial që ishte ndërthurur brenda rastit të çrregullsisë. 59

Është ngjajshmëri e habitshme mes miteve të Egjiptit të vjetër dhe mendimit modern materialist. Arsye e fshehtë për këtë fakt interesant është se, ekziston një organizatë bashkëkohore që ka

adoptuar këto besime të Egjiptit të vjetër dhe qëllimin që t'i vendosë nëpër tërë botën. E kjo organizatë është Masoneria.

## MASONËT DHE EGJIPTI I VJETËR

Filozofia materialiste e Egjiptit të vjetër vazhdoi së ekzistuari edhe pas zhdukjes së këtij civilizimi. Ishte adoptuar nga disa çifutë dhe e mbajtën të gjallë brenda në doktrinën kabaliste. Nga ana tjetër, një numër i mendimtarëve grekë kishin adoptuar filozofinë e njejtë dhe e ri-interpretuan dhe e përjetësuan në formë të shkollës së mendimit të njohur si "Hermeticizëm".

Fjala hermeticizëm rrjedh nga emri i Hermesit, zotit grek që ishte homolog i zotit të Egjiptit të vjetër me emrin "Thot". Me fjalë tjera, hermeticizmi është një verzion i filozofisë së Egjiptit të vjetër në Greqinë antike.

Isindag spjegon origjinën e kësaj filozofie dhe vendin e saj në masonerinë moderne:

Në Egjiptin e vjetër ekzistonte një shoqëri fetare që la si trashëgim një sistem të besimit dhe të menduarit në hermeticizëm. Edhe Masoneria kishte diçka të ngjajshme. P.sh., ata që kishin arritur deri në një nivel të caktuar përcillnin ceremonitë e shoqërisë, zbuluan mendimet dhe ndjenjat e tyre shpirtërore dhe i pasonin tek ata që ishin në nivele më të ulta. Pitagora ishte njëri ndër hermeticistët që shkollohej. Prapë, organizata dhe sistemet filozofike të shkollës së Aleksandrisë

dhe Neoplatonizmit i kishin rrënjët e tyre në Egjiptin e vjetër dhe atje gjendeshin disa ngjajshmëri mes tyre dhe ritualeve masonike. 60

Isindag është shumë i qartë në lidhje me ndikimin e Egjiptit të vjetër në origjinën e Masonerisë kur deklaron: "Frankmasoneria është organizatë shoqërore dhe rituale që i ka fillet në Egjiptin e vjetër." 61

Shumë autoritete tjera masonike thonë se origjina e Masonerisë është në shoqëritë sekrete të kulturave të lashta pagane, siç janë ato nga Egjipti i vjetër dhe Greqia antike. Një mason i vjetër turk, Celil Layiketez, një një artikull në revistën "Mimar Sinan", në artikullin me titull "Fshehtësia masonike: Çfarë është sekrete e çfarë jo?" shkruan:

Në civilizimet e vjetra greke, egjiptase dhe romake ekzistonin shkolla mistike që ndeshen në kontekst të një shkence të caktuar apo njohuri sekrete. Antarët e kësaj shkolle mistike ishin pranuar vetëm pas një periudhe të gjatë të studimeve dhe të riteve të pranimit. Në mesin e këtyre shkollave, i pari që mendohet të jetë ishte Shkolla e "Ozirisit" bazuar në ngjarjet e lindjes së këtij zoti, rinisë, luftës kundër errësirës, vdekjes dhe ringjalljes. Këto çështje ishin dramatizuar ritualisht në ceremonitë e performuara nga kleri dhe në këtë mënyrë ritet dhe simbolet që prezentoheshin ishin më shumë efektive për shkak të pjesëmarrjes aktuale...

Vite më vonë, këto rite themelojnë qarkun e parë të rendit të vëllazërisë që vazhdon me emrin e Masonerisë. Vëllazëritë e tilla çdoherë vendosin ideale të njejta dhe kur janë në presion janë në gjendje që të jetojnë në mënyrë sekrete. Ata ishin në gjendje që të mbijetojnë deri më sot pasi ata vazhdimisht ndërronin emrat dhe format e tyre. Por ata mbetën besnik simbolizmit të lashtë dhe karakterit të tyre të veçantë dhe kalon dorë me dorë si trashëgimi. Ashtuqë të zbusin mundësinë

që idetë e tyra t'a kërcnojnë establishmentin, ata vendosën ligje të fshehta në mesin e tyre. Në atë mënyrë që t'a mbrojnë vetveten nga tërbimi i injorantëve, kërkuan strehim në Masonerinë Operative që përmbante rregulla diskrete të tregëtisë së tyre. Ata i mbjellnin këtë nëpërmes ideve të tyre që më vonë ndikuan në formimin e Masonerisë Moderne Teorike, që edhe sot njihet. 62

Në citatin e mësipërm, Layiktez lavdëron shoqëritë që ishin origjinë e Masonerisë dhe pohon se ata mbahen fshehtë që të mbrohen nga "injorantët". Nëse e lemi anash këtë pohim për një çast do të kuptojmë nga citati i mësipërm se Masoneria është përfaqësim i sotëm i shoqërive që janë themeluar nga qytetërimet e lashta pagane të Egjiptit të vjetër, Greqisë antike dhe Romës. Nga këto tri civilizime, më e vjetra është ajo e Egjiptit të vjetër. (Pamë më lart lidhjen kryesore mes traditave pagane dhe masonëve modern janë Tamplierët.)

Është e domosdoshme që të përkujtojmë që të përkujtojmë se Egjipti i vjetër ishte njëri ndër shembujt më të shpeshtë që janë marrësi sistem ateist sikurse tregohet nga Zoti në Kur'an. Është shembull i vërtetë i një sistemi fatkeq, shumë ajete tregojnë për faraonët që kanë qeverisur në Egjipt dhe për shoqërinë e tyre të ngushtë, egërsinë, padrejtësinë, ligësinë dhe ekstremizmin e tyre. Bile bile, egjiptasit ishin të mbrapshtë dhe të çoroditur e perverzë, që në heshtje e pranonin sistemin e faraonve të tyre, dhe besonin në zotëra të shpikur.

Përveç kësaj, masonët thonë se origjina e tyre rrjedh nga Egjipti i vjetër, dhe e lartësojnë këtë civilizim. Në një artikull të botuar në Mimar Sinan, lavdërohen tempujt e Egjiptit të vjetër si "burim i mjeshtërisë masonike":

... Egjiptasit themeluan HELIOPOLISIN (qytetin e diellit) dhe Memfisin dhe sipas mitit masonik, këto dy qytete ishin burime të diturisë dhe shkencës, apo siç theksojnë masonët "Drita e

shkëlqyer". Pitagora, që vizitonte Heliopolisin, kishte çfarë të thoshte për tempullin. Tempulli i Memfisit ku ai ishte ushtruar ka rëndësi historike. Edhe në qytetin e Tebës kishte shkolla të avansuara. Pitagora, Platoni dhe Ciceroni ishin pranuar si masonë në këto qytete. 63

Shkrimet masonike nuk e lëvdërojnë Egjiptin e vjetër vetëm në pikëpamjet e përgjithshme; ata shprehin lavdatë dhe simpati për faraonët që sundonin atë sistem mizor. Në një artikull tjetër në revistën Mimar Sinan thuhet:

Detyra themelore e faraonit ishte gjetja e Dritës. Ndërrimi i Dritës së Fshehur në mënyrën më aktive dhe më të fuqishme... Pasiqë ne masonët përpiqemi që të ndërtojmë Tempullin e Solomonit, në të njejtën mënyrë edhe egjiptasit e vjetër përpiqeshin që të ndërtojnë Ehramin, apo Shtëpinë e Dritës. Ritet e performuara në tempujt e Egjiptit të vjetër ishin ndarë në disa shkallë. Këto shkallë ishin dy, e vogla dhe e madhja. Shkalla e vogël ishte e ndarë në një, dy dhe tre; e pas kësaj fillojnë shkallët e mëdha. 64

Mund të shihet nga kjo se "drita" të cilën faraonët e Egjiptit të vjetër dhe masonët e kërkojnë është e njejta. Kjo gjithashtu mund të interpretohet si aluzion që Masoneria është përfaqësuese moderne e filozofisë së faraonëve të Egjiptit të vjetër. Natyra e kësaj filozofie demaskohet nga Zoti në Kur'an, ku faraoni dhe njerëzit e tij vlerësohen si: "...njerëz devijues" Kur'an (27: 12) Në disa ajete tjera kuranore sistemi ateist i Egjiptit të vjetër përshkruhet në këtë mënyrë:

Ndërsa, faraoni thirri popullin e vet e tha: "O popull imi, a nuk është imi pushteti i Egjiptit (i Misirit) dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin nën pallatin tim, a nuk po shihni?" Pra, unë jam më i mirë se ky qyqar që mëzi flet! Përse nuk i janë vënë atij bylyzykë nga ari, ose të kenë ardhur

bashkë me të engjëjt shoqërues? Dhe ashtu ai e frikësoi popullin e vet, e ata e respektuan, por ata ishin vërtet popull i shkatërruar.

Kur'an (43: 51-54)

## SIMBOLET E EGJIPTIT TË VJETËR NË LLOZHAT MASONIKE

Njëra ndër çështjet më të rëndësishme që vërtetojnë lidhjen mes Egjiptit të vjetër dhe masonëve është simbolet e tyre.

Simbolet janë shumë të rëndësishme në Masoneri. Masonët zbulojnë kuptimin e vërtetë të filozofisë së tyre antarëve të vet me alegori. Një mason, që avansohet etapë pas etape përgjatë 33 shkallëve të kierarkisë masonike, mëson kuptimet e reja për çdo simbol në çdo etapë. Në këtë mënyrë, antarët zhyten gradualisht në thellësitë e filozofisë masonike.

Në një artikull në Mimar Sinan përshkruhen funksionet e simboleve të tyre:

Të gjithë e dimë se Masoneria shpreh idetë dhe idealet e veta përmes simboleve dhe rrëfimeve të tyre, gjegj., alegorive. Këto rrëfime kthehen në fillimet e para të historisë. Bile mund të themi se ato shtrihen deri tek legjendat parahistorike.

Në këtë mënyrë, Masoneria ka treguar lashtësinë e idealeve të veta dhe ka fituar burim të pasur të simboleve. 65

Konceptet e egjiptasëve të vjetër janë më të dalluarat në këto simbole, dhe legjendat, që shtrihen deri tek historia e hershme. Çdo vend në llozhat masonike dhe mjaft shpesh në publikimet e tyre mund të gjenden, vizatime të piramidave, sfingave dhe hieroglife. Në një artikull në revistën Mimar Sinan, për burimet e lashta të Masonerisë thuhet:

Nëse zgjedhim Egjiptin e vjetër si " më të vjetrin" nuk besoj se gabohet. Përveç kësaj, fakti se ceremonitë, shkallët dhe filozofia e gjetur në Egjiptin e Vjetër janë shumë ngjajshëm me vizatimet masonerike, është gjë që n'a tërhjekë më së pari vëmendjen. 66

Prapë, në një artikull tjetër në Mimar Sinan, i titulluar "Origjinat shoqërore dhe qëllimet e Frankmasonerisë" thuhet:

Në kohërat e lashta në Egjip, ceremonitë e pranimit në Tempullin e Memfisit zgjaste shumë, performuar me vëmendjen dhe madhështinë më të madhe, gjë që tregon shumë ngjajshmëri me ceremonitë masonike. 67

Tani të shqyrtojmë disa shembuj të lidhmrisë mes Egjiptit të vjetër dhe Masonerisë.

## PIRAMIDA NËN SYRIN

Simboli më i njohur masonik gjendet edhe në vulën e SHBA-ve, si dhe në banknotën një dollarëshe. Në këtë vulë gjendet një gjysëm-piramidë mbi të cilën qëndron një sy brenda në një trekëndësh. Ky sy brenda trekëndëshit është simbol që çdoherë gjendej në llozhat masonike dhe në të gjitha publikimet masonike. Një numër i madh i shkrimeve që shqyrtojnë këtë çështje masonike e theksojnë këtë fakt.

Piramida nën syrin mbrenda në trekëndësh tërheq relativisht pak vëmendjen. Sidoqoftë, kjo piramidë është skajshmërisht domethënëse dhe sqaruese ashtuqë të kuptohet filozofia masonike. Autori amerikan, Robert Hieronimus, ka përgaditur tezën e doktoraturës mbi vulën e SHBA-ve në të cilën ai solli disa informata shumë të rëndësishme. Titulli i tezës ishte "Analiza historike e anës së prapme të banknotës të vulës së madhe amerikane dhe lidhshmëria me ideologjinë e psikologjisë humaniste". Teza e tij tregon se themeluesit e Amerikës, që fillimisht adoptuan vulën, ishin masonët, dhe në këtë mënyrë ata përqafuan filozofinë humaniste. Lidhshmëria e kësaj me Egjiptin e vjetër simbolizohet me piramidën e vendosur në qendër të vulës. Kjo piramidë është një prezentim i piramidës së Keopsit, varrezës më të madhe të faraonëve.

## KUPTIMI MASONIK I YLLIT GJASHTËCEPËSH

Simbol tjetër shumë i njohur është ylli gjashtëcepësh, i formuar nga bashkimi i dy trekëndshave. Ky është gjithashtu edhe simbol tradicional i çifutëve, që edhe sot gjendet në flamurin e Izraelit. Është e njohur se profeti Solomon e ka përdorur këtë simbol si vulë për herë të parë. Në këtë mënyrë ylli gjashtëcepësh është vulë e profetit, pra një simbol hyjnor.

Por masonët për këtë kanë koncept tjetër. Ata nuk e pranojnë yllin gjashtëcepësh si simbol i profetit Solomon, por si një simbol paganizmi të Egjiptit të vjetër. Artikulli me titull "Alegoria dhe simbolet në ritualet tona", botuar në Mimar Sinan, tregon për një varg faktesh interesante në lidhje me këtë çështje:

Një trekëndësh barabrinjës me tre cepa i baraslarguar nga një tjetër tregon se këto vlera janë të barasvlershme. Ky simboli adoptuar nga masonët është i njohur si Ylli i Davudit; është një gjashtëkëndësh i formuar nga bashkimi i dy trekëndshave. Sot është i njohur si simbol i çifutëve dhe gjendet në flamurin e Izraelit. Por në të vërtetë, origjina e këtij simboli është në Egjiptin e vjetër... Kjo amblemë së pari është përdorur nga Kalorësit Tamplierë që filluan t'a përdorin si simbolizim mbi muret nëpër kishat e tyre, për shkak se ata ishin të parët që zbuluan në Jerusalem disa fakte të rëndësishme të krishterimit. Pasi Tamplierët heqin dorë nga kjo amblemë, filloi të përdorej në sinagoga. Por në Masoneri, padyshim këtë simbol e përdorin në pikëpamje universale që kishte në Egjiptin e vjetër. Në këtë aspekt, ne kemi kombinuar dy forca të rëndësishme. Nëse fshihen bazat e poshtme dhe të epërme të dy trekëndshave barabrinjës, do të zbuloni këtë simbol të rrallë që njihet shumë mirë. 69

Në të vërtetë, në këtë mënyrë duhet i interpretuar të gjitha simbolet masonike në lidhje me Tempullin e Solomonit. Siç sqarohet në Kur'an, Solomoni ishte një profet të cilin dikush dëshironte t'a përgojonte dhe përpiqej që t'a paraqiste si të pafé. Në një ajet kuranor, Zoti thotë: "E ndoqën atë që i thonin djajt në kohën e sundimit të Sulejmanit (Solomonit). Por Sulejmani nuk ishte, por djajtë ishin të pafé,... (Kur'an 2:102)

Masonët kanë adoptuar këtë ide të gabuar që gabimisht i mveshet profetit Solomon, duke e cilësuar atë si njeri me besim pagan të Egjiptit të vjetër. Për këtë shkak, ata i japin atij një vend të rëndësishëm në doktrinën e tyre. Në librine tij "Komplotin okult", nga historiani amerikan Michael Howard, thotë se, që nga mesjeta, Solomoni (larg qoftë) është konsideruar si magjistar dhese ai ka paraqitur disa ide pagane judaizmit. 70

Howard shpjegon se masonët e konsiderojnë tempullin e Solomonit si "tempull pagan", dhe për këtë shkak është i një rëndësie të veçantë. 71

Ky pasqyrim i rremë i trilluar kundër profetit Solomon, që ishte një shërbëtor i devotshëm dhe i bindur i Zotit, tregon origjinën e vërtetë të Masonerisë.

## SHTYLLA E DYFISHTË

Pjesë e domosdoshme e dekorit të llozhës masonike është edhe Shtylla e dyfishtë. Termet "Jachin" dhe "Boaz" janë shkruar në ta, imitim i dy shtyllave në hyrjen e tempullit të Solomonit.

Por në të vërtetë masonët nuk e kanë bërë këtë gjë si përkujtim ndaj Solomonit, por janë një shprehje e atyre botëkuptime të gabuara kundër Solomonit. Origjina e këtyre shtyllave n'a dërgojnë prapa në Egjiptin e vjetër. Në artikullin me titull "Alegoria dhe simbolet në ritualet tona" në Mimar Sinan, qëndron kështu:

P.sh., në Egjipt, Horusi dhe Seti ishin dy arkitektë dhe shtylla të qiellit. Bile edhe Bakusi në Tebë gjithashtu. Dy shtyllat në llozhat tona kanë origjinën prej Egjiptit të vjetër. Njëra nga shtyllat ishte në jug të Egjiptit, në Tebë; ndërsa tjetra ishte në veri, në Heliopolis. Në hyrjen e tempullit Amenta dedikuar Ptahut, zotit kryeson në Egjip, ishin dy shtylla sikurse në tempullin e Solomonit. Miti më i vjetër që ka të bëjë me diellin, përmenden dy shtyllat, të quajtur intelegjenca dhe fuqia, të ngritura përballë portës hyrëse për në amshueshmëri. 72

## TERMINOLOGJIA EGJIPTIANE E LLOZHAVE

Në librin e tyre "Çelësi i Hiramit", autorët britanikë, Christopher Knight dhe Robert Lomas, tërhjekin vëmendjen sa i përket rrënjëve të Masonerisë në Egjiptin e vjetër. Një çështje interesante që ata zbuluan ishte se fjalët që përdoreshin në ceremonitë kur masoni kalon në shkallën e master masonit:

Ma'at-neb-men-aa, Ma'at-ba-aa. 73

Knight dhe Lomas shpjegojnë se këto fjalë përdoren në shumicën e kohës pa ndonjë kuptim, por janë fjalë nga Egjipti i vjetër që dmth:

"I madh është Master Masoni, i madh është shpirti i Frankmasonerisë." 74

Autorët theksojnë se fjala "ma'at" dmth. Mjeshtria në ndërtimin e murit, dhe përkthimi më i afërt është "Masoneria" (Muratori).

Kjo dmth, se masonët modernë, mijëra vjet më vonë, ende ruajnë gjuhën e Egjiptit të vjetër në llozhat e tyre.

## "FYELLI MAGJIK" NGA MOCARTIT

Njëri ndër produktet më interesante të Masonerisë është "Fyelli magjik", operë e mirënjohur e kompozitorit, W.A.Mocart. Mocarti ishte mason, dhe është fakt i njohur se shumë pjesë të operës përmbajnë porosi masonike. Çështje interesante është se në këto porosi është prezentohet për së afërmi paganizmi i Egjiptit të vjetër. Mimar Sinan e shpjegon këtë çështje kështu:

Është e ditur se ka lidhshmëri të qartë në mes të Egjiptit të vjetër dhe ritualeve masonike. Pa marrë parasysh përpjekjen e atyre që tentuan që të interpretojnë "Fyellin magjik" si një rrëfim për Lindjen e largët, në themelet e saj gjenden ritualet egjiptiane. Janë zotërat e tempujve egjiptianë që kanë pasur influencënë krijimin e karaktereve të "Fyellit magjik". 75

## OBELISKËT

Diçka që dikur ishte një element i rëndësishëm në arkitekturën e Egjiptit të vjetër e që tani është simbol i rëndësishëm i Masonerisë janë - obeliskët. Obelisku është një shtyllë e gjatë, vertikale me majë në formëtë piramidës: në obelisk ishin gdhendur hieroglife të Egjiptit të vjetër dhe ishin nën tokë me shekuj derisa nuk u zbuluan në shek. e 19-të dhe u çvendosën në qytete perëndimore si New York, Londër dhe Paris. Obelisku më i madh u dërgua në SHBA. Eksporti i organizuar nga masonët, për shkak se obeliskët si dhe figurat e gdhendura në ta, siç pohonin masonët, ishin simbolet e tyre. Mimar Sinan thekson këtë gjë për obeliskun 21-metërsh në New York:

Shembulli më habitës i përdorimit simbolik të arkitekturës është monumenti i quajtur "Gjilpëra e Kleopatrës", dhuruar SHBA-ve më 1878 nga guvernatori egjiptas Ismail. Tani ky monument gjendet në Central Park. Sipërfaqja e tij është e mbuluar me simbole masonike. Ky monument së pari është ngritur në shek. e 16-të p.e.s., në hyrje të tempullit të zotit Diell, në qendrën e pranimit në Heliopolis. 76

## LEGJENDA E IZISIT- VEJUSHËS

Ide simbolike të rëndësishme në Masoneri është ideja e vejushës. Masonët e quajnë veten fëmijët e vejushës dhe vizatimet e vejushës duken shpesh nëpër publikimet tyre. Ku është origjina e kësaj ideje? Kush ëshë vejusha?

Kurt'i shqyrtojmë burimet masonike, shohim se simboli i vejushës rrjedh nga një legjendë egjiptase. Kjo është njëra ndër legjendat më të rëndësishme të Egjiptit të vjetër- rrëfimi i Ozirisit dhe Izisit. Ozirisi ishte zot i plleshmërisë dhe Izisi ishte gruaja e tij. Sipas legjendës, Ozirisi ishte viktimë e një krimi ku Izisi mbetet e vejë. Në këtë mënyrë, vejusha masonike identifikohet me Izisin. Në një artikull në Mimar Sinan shpjegohet në këtë mënyrë:

Legjenda e Ozirisit- Izisit është temë e shumë artikujve dhe predikimeve dhe është legjenda më e afërt në Masoneri nga Egjipti i vjetër. Testi për t'u bërë prift në tempullin e Izisit është pranimi në Masoneri. Do të ishte e mërzitshme të përsëritej. Aty, drita ishte njëra nga elementet më të rëndësishme; ashtuqë të varrosej në errësirën e Lindjes, dielli i mëngjesit fillon të bie poshtë pas mesditës dhe merr detyrën nga Ozirisi çdo ditë, sikurse Horisi që e zen vendin e babait të tij të vrarë. Prandaj, "vejusha" fëmijët e së cilës jemi ne nuk është askush tjetër përpos gruas së Ozirisit, vejushës Izis. 77

Shohim se Masoneria, që e përshkruan veten se është themeluar mbi bazat e arsyes dhe shkencës, në të vërtetë është një doktrinë mitologjike përplot me bestytni.

## KOMPASI DHE TREKËNDËSHI

Nga simbolet më të njohura të Masonerisë është kompasi i vendosur mbi trekëndësh. Nëse pyetën masonët, ata thonë se ky simbol paraqet konceptin e shkencës, rregullin gjeometrik dhe mendimin racional. Sidoqoftë, kompasi dhe trekëndëshi në të vërtetë ka krejtësisht kuptim tjetër.

Mund të mësojmë për këtë gjë nga libri i shkruar i njërit ndër masonët më të mëdhenj të të gjitha kohërave, Albert Pike. Në librin e tij “Moralet dhe dogma”, Albert Pike shpjegon për kompasin dhe trekëndëshin, me sa vijon:

Trekëndëshi... është simbol natyral dhe me vend i tokës... Figura hermafrodite është simbol i natyrës së lashtë të dyfishta që u janë dhënë hyjnive, si gjenerator dhe prodhues, si Brahma dhe Maja në mesin e arianëve, Ozirisin dhe Izisinnë mesine e egjiptasëve. Pasi Dielli ishte mashkull, Hëna ishte femër. 78

Kjo dmth. se kompasi dhe trekëndëshi, si simbole më të njohura të Masonerisë, janë simbole të paganizmit arian dhe daton që nga Egjipti i vjetër apo para paraqitjes së krishterizmit. Hëna dhe dielli, në pasusin e cituar nga Pike, janë simbole të rëndësishme në llozhat masonike, dhe nuk është asgjë tjetër përpos reflektim i besimeve të kota të shoqërive të lashta pagane që adhuronin hënën dhe diellin.

## FILOZOFIA PAGANE E MASONERISË

Deri më tani, kemi mësuar se origjina e Masonerisë qëndron në doktrinën pagane që shtrihet që nga Egjipti i vjetër, dhe se kuptimi i vërtetë i koncepteve dhe simboleve të saja janë të fshehura. Për këtë qëllim, Masoneria gjendet në konflikt me fetë monoteiste. Ajo është humaniste, materialiste dhe evolucioniste. Historiani amerikan, Michael Howard shpjegon këtë fshehtësi që u është zbuluar tërësisht vetëm masonëve të shkallës më të lartë:

Pse të krishterët janë aq kritikë ndaj Frankmasonerisë?... Përgjegja e kësaj pyetje qëndron në "fshehtësitë" e Frankmasonerisë. Nëse publiku do të kishte çasje në këto fshehtësi atëherë do të vihej e tëra në dyshim, pasiqë do të kuptohej nga ata që nuk kanë njohuri në doktrinat e okultizmit dhe religjionit të lashtë. Në fakt dyshohet se shumë nga antarët e zakonshëm të llozhave kuptojnë se çfarë do të thonë sektretet e tyre. Në qarqet e brendshme të Masonerisë, në mesin e atyre që kanë arritur në shkallët e larta, janë masonë që kuptojnë se janë trashëgimtarë të një tradite të lashtë para-kristiane të transmetuar që nga kohërat e paganizmit. 79

Nëse shikojmë në shkrimet masonike turke, vërejmë se masonët e shkallës më të lartë kanë dijeni që e mbajnë fshehur nga vëllezërit tjerë. Master masoni Nexhdet Egeran shpjegon se çfarë mendojnë për këtë çështje masonët e shkallës më të lartë:

Bile, disa masonë e kuptojnë Masonerinë vetëm si një lloj gjysëm religjioni dhe gjysëm institucioni vëllazëror i mirëbërjes ku ata mund të vendosin relacione të mira shoqërore dhe trajtim të drejtë. Të tjerët mendojnë se qëllimi i Masonerisë është vetëm bëmirësia ndaj njerëzëve. Ndrsa tjerët mendojnë se Masoneria është vend ku ndërtohet karakteri. Shkurtimisht, ata nuk dijnë të lexojnë apo të shkruajnë gjuhën e shenjtë të Masonerisë, të kuptojnë domethënien e simboleve dhe alegorive në këtë apo në ndonjë mënyrë tjetër të ngjajshme. Por për pak masonë që kanë mundur që të futen thellë në të, Masoneria dhe qëllimet e saja janë mjaft të ndryshme. Masoneria, do të thotë, një dituri e zbuluar, një nismë dhe një fillim. Dmth., lënien anash të mënyrës së vjetër të jetës dhe hyrjen në një jetë të re dhe të qetë fisnike... Përtej simbolizmit elementar dhe bazik të Masonerisë ekziston një sërë shpalljesh që n'a ndihmojnë që të hyjmë në një jetë të brendshme më të ngritur dhe të mësohen fshehtësitë e ekzistencës sonë. Kështuqë, në këtë jetë të brendshme

dhe hyrja në të është e mundur arritja e Iluminizmit (Ndriqimit të mendjes) të Masonerisë. Vetëm atëherë bëhet e mundur që të mësohet natyra dhe kushtet e përparimit dhe evolucionit. 80

Ky paragraf thekson, se edhepse disa masonë të shkallëve më të ulta mendojnë se Masoneria është organizat sociale dhe bëmirse, në të vërtetë ka të bëjë me fshehtësitë e ekzistencës së njeriut. Pra, kjo është pamja e jashtme e Masonerisë si organizatë sociale dhe bëmirëse, që të vërtetë fsheh filozofinë e organizatës. Në realitet, Masoneria është organizatë që synon të imponojë sistematikisht një filozofi specifike antarëve të vet si dhe pjesës tjetër të shoqërisë.

Siç thamë në fillim, element bazë i kësaj filozofie, në të cilën është bazuar Masoneria nga kulturat pagane, posaçërisht nga Egjipti i vjetër, është materializmi.

## MATERIALIZMI NË BURIMET MASONIKE
## BESIMI NË MATERIEN ABSOLUTE

Masonët e sotëm, sikurse edhe faraonët, priftërinjtë dhe klasat tjera të Egjiptit të vjetër, besonin në amshueshmërinë dhe në jo-krijueshmërinë e materies, dhe nga kjo materie të pajetë u krijuan qeniet e gjalla vetvetiu. Në shkrimet masonike mund të lexojmë të dhënat detale të këtyre elementeve bazë të filozofisë materialiste.

Në librin e tij "Frymëzimet nga Frankmasoneria", master masoni Selami Isindag, shkruan për filozofinë e pastër materialiste të Masonerisë:

Gjithësia, atmosfera, yjet, natyra, të gjitha qeniet e gjalla dhe jo të gjalla përbëhen nga atomet. Njerëzit nuk janë asgjë tjetër përpos një koleksion i atomeve që ndeshen spontanisht. Ekuilibri në përqimin e elektricitetit në mes të atomeve e siguron ekzistencën e qenieve të gjalla. Kur ekuilibri shkatërrohet (nuk ekziston më elektricitet mes atomeve), ne vdesim, i kthehemi tokës dhe transformohemi në atome. Dmth., kemi ardhur nga materia dhe energjia dhe prapë do të kthehemi në materie dhe energji. Bimët përdorin atomet tona, dhe të gjitha qeniet e gjalla duke përfshirë edhe neve, përdorim bimët. Çdo gjë është bërë nga substanca e njejtë. Për shkak se truri ynë është zhvilluar më së shumti nga të gjitha kafsht, lajmërohet vetëdija. Nëse shikojmë në rezultatet e psikologjisë eksperimentale, shohim se përjetimet tona psikike të trefishta të emocioneve-mendjes-vullnetit është rezultat i funksionit të ekulibruar të qelizave në hormone dhe korën e trurit...

Shkenca ekzakte pranon se asgjë nuk mund të krijohet nga hiçgjëja, kështuqë asgjë nuk mund të shkatërrohet. Si rezultat, mund të vihet në përfundim se njerëzit nuk duhet të jenë falenderues apo të obliguar ndaj asnjë fuqie. Gjithësia është një tërësi e energjisë pa fillim dhe pa mbarim. Çdo gjë lind nga kjo tërësi e energjisë, që evulon dhe vdes, por nuk zhduket kurrë. Gjërat ndërrohen dhe transformohen. Nuk ka gjëra si vdekje apo humbje; ekziston vetëm ndryshim, transformim dhe formim i vazhdueshëm. Por nuk është e mundur këtë çështje të madhe dhe fshehtësitë e gjithësisë të shpjegohen me anën e ligjeve shkencore. Por shpjegimet jashtë shkencore janë shpjegime imagjinare, dogma dhe besime të kota. Sipas shkencës ekzakte dhe arsyes, shpirti nuk ekziston pavarësisht trupit. 81

Do të gjesh pikëpamje identike si këto në librat e mendimtarëve materialisë si K. Marx, F. Engels, V.I. Lenin, G. Politzer, C. Sagan dhe J. Monod. Të gjithë këta kanë pranuar mitin themelor

materialist se gjithësia ka ekzistuar gjithmonë, se materia është gjëja e vetme absolute që ekziston, njerëzit janë të përbërë nga materia dhe nuk kanë shpirt, materia evuluon jashtë dhe brenda vetvetes dhe se jeta ka lindur nga rastësia. Është e drejtë të përdoret shprehja mit sepse, përkundër pohimit të Isindagut se "këto procese janë si rezultat i shkencës ekzakte dhe arsyes", dhe të gjitha këto pikëpamje janë hedhur poshtë nga zbulimet shkencore në pjesën e dytë të shek. të 20-të. P.sh. teoria e Big Bengut, e pranuar në qarqet shkencore si e vërtetuar, tregon në mënyrë shkencorese gjithësia ishte krijuar nga hiçgjëja para miliona vjetësh. Ligjet e Termodinamikës tregojnë se materia nuk ka aftësi të vetorganizohet dhe se ekuilibri dhe rregulli në univers është si rezultat i një krijimi të vetdijshëm. Me paraqitjen e modelimit të jashtëzakonshëm në qeniet e gjalla, biologjia vërteton se Krijuesi është Ai i Cili ka krijuar gjithçka. (Për informata më të hollësishme, shih librat nga Harun Yahya *"Krijimi i universit", "Gjunjëzimi i evolucionit", dhe "Përgënjeshtrimi i evolucionit"*)

Në artikullin e tij Isindag vazhdon të shpjegojë se masonët janë në të vërtetë materialistë dhe në këtë mënyrë edhe ateistë dhe se përdorin konceptin "Arkitekti i Madh i Universit" sa i përket evolucionit të materies:

Dëshiroj shkurtimisht t'i prek disa parime, mendime të adoptuara nga masonët: Sipas Masonerisë, jeta fillon nga një qelizë e vetme, që ndryshohet, transformohet dhe evolvohet në një qenie njerëzore. Natyra, shkaku apo qëllimi apo kushtet e këtij fillimi nuk janë të njohura. Jeta lind nga kombinimi i materies dhe i energjisë dhe kthehet në të. Nëse pranojmë "Arkitektin e Madh të Universit" si parim sublim, një horizont të pakufishëm të mirësisë dhe bukurisë, kulmi i evolucionit, etapa më e lartë dhe ideali për të cilën njeriu përpiqet, nëse nuk i personalizojnë, ndoshta mund të ikim nga dogmatizmi. 82

Siç po e shohim, njëri ndër principet themelore të filozofisë masonike është se gjërat lindin nga materia dhe kthehen në materie. Një aspekt interesant i kësaj pikëpamje është se masonët nuk e përfillin këtë filozofi vetëm për vetvete; por ata dëshirojnë që t'i përhapin këto ide në tërë shoqërinë. Ndërsa Isindag vazhdon:

Masoni i përgaditur me këto parime dhe doktrina pranon detyrën për t'i arsimuar njerëzit... dhe t'i mësojnë ata me parimet e arsyes dhe shkencës ekzakte. Në këtë mënyrë, Masoneria iu drejtohet njerëzve. Ajo punon në emër të njerëzve megjithë njerëzit. 83

Këto fjalë shprehin dy aspekte të rolit dallues të Masonerisë në shoqëri:

Nën vellon e shkencës ekzakte dhe arsyes, Masoneria tenton të imponojë në pjesën tjetër të shoqërisë filozofinë materialiste në të cilën filozofia materialiste beson (dmth. mitin nga Egjipti i vjetër)

Ata tentojnë t' bëjnë këtë pavarsisht nga njerëzit. Dmth.,edhe nëse shoqëria beson në Zot dhe nuk dëshiron t'a pranojë filozofinë materialiste, Masoneria do tp jetp e paepur në përpjekjet e saj që t'i ndryshojë pikëpamjet e njerëzve për këtë botë pa pëlqimin e tyre.

Aty është një çështje e rëndësishme që duhet vërejtur këtu: terminologjinë që masonët përdorin është mashtruese. Në shkrimet e tyre, posaçërisht në ato që iu drejtohen pjesës tjetër të shoqërisë, ata përdorin një gjuhë të dizajnuar ashtuqë të prezentojnë filozofinë e tyre si të padëmshme, intelegjente dhe tolerante. Si shembull mund të shihet në citimin e lartë në nocionin "duke udhëzuar njerëzit dhe duke ia u mësuar njerëzve parimet e arsyes dhe shkencës ekzakte". Në të vërtetë filozofia masonike nuk ka të bëjë fare me "shkencën dhe arsyen", ajo ka të bëjë me një

mit të dalur mode që qëndron jashtë aspektit shkencor. Nuk është qëllimi i Masonerisë që të udhëzojë njerëzit; ata me qëllim tentojnë të imponojnë njerëzve filozofinë e tyre. Kur ata mbahen se janë të përcaktuar që të bëjnë këtë pavarsisht nga njerëzit, shohim se ata nuk janë tolerantë, por përpiqen që të kenë pikëpamje totalitare.

## MOHIMI I EKZISTIMIT TË SHPIRTIT DHE BOTËS SË ARDHSHME

Si pjesë e besimit materialsit, masonët nuk pranojnë ekzistimin e shpirtit të njeriut dhe tërësisht mohojnë idenë e botës së mëpastajshme. Pavarsisht nga kjo, në shkrimet masonike ndonjëherë thuhet se për të vdekurit se kanë "kaluar në amshim" apo shprehje tjera të ngjajshme shpirtërore. Kjo mund të duket kontradiktore, por nuk është, pasi në të vërtetë të gjitha referimet masonike ndaj pavdekshmërisë së shpirtit janë simbolike. Mimar Sinan shtjellon këtë çështje në artikullin me titull, "Pas vdekjes në Frankmasoneri":

Në mitin e Master Hiramit, masonët pranojnë ringjalljen pas vdekjes në mënyrë simbolike. Kjo ringjallje tregon se e vërteta gjithmonë triumfon ndaj vdekjes dhe errësirës. Masoneria nuk i jep ndonjë rëndësi ekzistimit të shpirtit pavarsisht nga trupi. Në Masoneri, ringjallja pas vdekjes është lënia e disa aktiviteteve shpirtërore apo materiale si një traditë ndaj njerëzve. Kjo e bën njeriun e pavdekshëm. Ata që kanë qenë të aftë që t'a bëjnë emrin e tyre të pavdekshëm në këtë jetë të shkurtër mashtruese të njeriut janë njerëzit e suksesshëm. Mendojmë se ata që i kanë emrat e tyre

të pavdekshëm si persona që kanë mbaruar të gjitha orvatjes, nga bashkëkohësit apo për ato gjenerata që i kanë pasuar, të bëjnë njerëzit e lumtur dhe të sigurojnë për ta një botë më humane. Synimi i tyre është që t'a lavdërojnë vrullin njerëzor që ndikon në jetërat e njerëzve... Njerëzit që kanë parë pavdekshmërinë gjatë shekujve mund të arrihet përmes punës së tyre, shërbimet që ata kryejnë dhe idetë që ata japin, dhe kjo i jep një domethënie jetës së tyre. Siç shpjegonte Tolstoi, "Parajsa do të vendosej në tokë dhe njerëzit do të marrin të mirat më të mundshme". 84

Për temën e njejtë, Isindag shkruan:

SUBSTANCA E ÇDO GJËJE: Masoneria e kupton këtë si energji dhe materie. Ata thonë se çdo gjë ndryshon etapë pas etape dhe do të kthehet prapë në materie. Shkencërisht, kjo definohet si vdekje. Misticizmi në këtë çështje, besimi që nga këto dy forca njeriu përbëhet- shpirti dhe trupi- trupi do të vdes ndërsa shpirti jo; se shpirtërat do të kalojë në botën e shpirtërave, vazhdojnë të ekzistojnë atje dhe kthehen në një trup tjetër kur Zoti urdhëron, nuk i përshtatet ideve të ndryshimit- transformimit të pranuara në Masoneri. Idetë e Masonerisë me këtë çështje mund të shprehen në këtë mënyrë: "Pas vdekjes sate, e vetmja gjë që mbesin dhe nuk vdesin, janë kujtimet e moshës së pjekurisë dhe asaj se çfarë ke bërë." Ky mendim është një lloj mënyre filozofike e të menduarit bazuar në principet e shkencës ekzakte dhe arsyes. Besimi fetar në pavdekshmërinë e shpirtit dhe ringjalljes pas vdekjes nuk është në pajtueshmëri me principet pozitiviste. Masoneria ka marrë principet e të menduarit nga sistemet pozitiviste dhe racionale. Kështuqë, për këtë çëshjte filozofike, ajo lidhet në të menduarit dhe të shpjeguarit ndryshe nga feja. 85

Refuzimi i idesë së ringjalljes pas vdekjes dhe kërkimi për pavdekshmërin në trashëgiminë kulturore botërore... Zatën edhe masonët e prezentojnë këtë ide duke qenë në pajtim me

shkencën moderne, është, në të vërtetë, një mit që i kanë besuar njerëzit që nuk kanë besuar në zot që nga etapat e para të njerëzimit. Në Kur'an thuhet se njerëzit që nuk kanë besuar në Zot "kanë ndërtuar ndërtesa të shkëlqyeshme duke shpresuar se do të jetojnë përgjithmonë." Hudi (paqja qoftë mbi të), njëri ndër profetët, i ka paralajmruar popullin e Adit kundër kësaj mënyre të injorancës, siç shkruan më poshtë:

Kur vëllai i tyre, Hudi u tha: "A nuk frikësoheni?"

Unë për ju jam i dërguar besnik.

Andaj, keni frikë (dënimit të) All-llahut dhe më dëgjoni mua.

Unë nuk kërkoj për këtë ndonjë shpërblim prej jush, shpërblimi është vetëm prej Zotit të botëve.

A në çdo bregore ngritni ndonjë shtëpi (ndërtesë) sa për lojë?

Dhe a i ndërtoni pallatet e fortifikura që të jeni përgjithmonë?

E kur rrëmbeni, rrëmbeni mizorisht.

Pra, kinie frikë All-llahun dhe më dëgjoni mua!

(Kur'an 26:124-131)

Gabimin që këta njerëz të pafé e kanë bërë nuk është ndërtimi i godinave të bukura. Gjithashtu edhe muslimanët i japin rëndësi artit; duke i ndërtuar ato, ata mundohen që t'a zbukurojnë botën. Ndryshimi qëndron në qëllim. Muslimani është i interesuar në art deri në atë shkallë ashtuqë të

shpreh bukurinë dhe nocionet estetike që Zoti iu ka dhënë qenieve njerëzore. Njerëzit e pafé bëjnë gabim duke e shfrytëzuar artin si shprehje e pavdekshmërisë.

## MOSPAJTIMI SHKENCOR I MOHIMIT TË EKZISTIMIT TË SHPIRTIT

Mohimi masonik i ekzistencës së shpirtit, dhe pohimi i tyre se vetëdija e njeriut përbëhet nga materia, nuk është në pajtueshmëri me shkencën. Në të kundërtën, zbulimet e shkencës bashkëkohore demostrojnë se vetëdija njerëzore nuk mund të reduktohet në materie, dhe se vetëdija nuk mund të shpjegohet në kushtet e funksionimit të trurit.

Një shikim në literaturën relevante tregon se shkenctarët nuk kanë ndonjë përfundim pas përpjekjeve të tyre, bazuar në besimin materialist, që të reduktojnë vetëdijën deri në nivelin e trurit, dhe shumë prej tyre kanë hequr dorë përfundimisht. Sot, shumë hulumtues kanë opinionin se vetëdija njerëzore vjen nga një burim i panjohur përtej neuroneve në tru dhe molekulave që i formojnë ato.

Pas shumë vitesh të studimit, njëri nga këta hulumtues, Wilder Penfield, arriti në përfundim se ekzistimi i shpirtit është një fakt i pamohueshëm:

Pas shumë vitesh të përpjekjeve për shpjegimin e mendjes në vetëm në bazë të funksionimit të trurit, kam ardhur në përfundim që është shumë më e thjeshtë (bile shumë mirë me thënë logjike)

nëse dikush adopton hipotezën se qenia jonë përbëhet nga dy elemente bazë [truri dhe mendja (apo shpirti)] ...Pasiqë duket se është e sigurtë se do të jetë e pamundur që të shpjegohet vetëdija në bazë të funksionimit të neutroneve brenda në tru... jam i detyruar që të zgjedh sygjerimin se qenia jonë shpjegohet në bazë të dy elementeve bazike. “(truri dhe mendja, apo trupi dhe shpirti) 86

Çfarë i drejton shkenctarët në këtë përfundim është fakti se vetëdija kurrë nuk mund të përshkruhet vetëm në bazë të faktorëve material. Truri i njeriut është sikurse një kompjutor i jashtëzakonshëm, në të cilin informatat nga pesë shqisat tona përmbledhen dhe procesohen. Por, ky kompjutor nuk ka ndjesi të “vetvetes”; nuk mund të mendojë, ndjej apo të konceptojë ndjenjat që i pranon. Fizikanti prominent anglez, Roger Penrose, në librin e tij “Mendja e re e perandorit”, shkruan:

Çfarë i jep identitet personal personit të caktuar? Kjo është, në një mënyrë, atomet që përbëjnë trupin e tij? A varet identiteti i tij nga zgjedhja e caktuar e atomeve, protoneve dhe grimacave tjera nga të cilat përbëhen atomet? Ekzistojnë dy arsye pse kjo nuk është e vërtetë. Së pari, aty ekziston një qarkullim i vazhdueshëm i materies në trupin e çdo qenie të gjallë. Kjo posaçërisht zbatohet në qelizat e trurit të njeriut, pavarsisht nga fakti se qelizat e reja të trurit prodhohen edhe pas lindjes së njeriut. Shumica e atomeve në çdo qelizë të gjallë (përshirë çdo qelizë të trurit)- dhe në të vërtetë, pothuajse e gjithë materia e trupit tonë- është ndërruar disa herë gjatë jetës. Arsyeja e dytë vjen nga fizika kuantike ...Nëse një elektron në trurin e një personi do të ndërrohet me një elektron tjetër, atëherë edhe gjendja e sistemit do të ishte në gjendje krejtësisht të njejtë siç ishte më parë, pothuajse e pandryshueme! E njejta vlen edhe protonet dhe grimcat tjera, si dhe për atomet, molekulat etj. Nëse materia e tërësishme e një personi do të ndërrohej me grimcat

përkatëse në ndërtimin e shtëpisë së tij atëherë, në një kuptim të plotë, nuk do të ndodhë kurrëfarë ndryshimi. 87

Penrose qartë thotë se thotë se, edhepse atomet e njeriut do të shëndrroheshin në atome të tullave, cilësitë që e karakterizojnë qenien njerëzore do të mbetet krejtësisht e njejtë. apo mund të mendojmë të kundërtën. Nëse shëndërrohen grimcat e atomit të trurit në atome të tullave, tullat nuk do të mundeshin të jenë të vetëdijshme.

Shkurtimisht, çfarë qenien njerzore e bën njeri nuk ka karakteristika materiale; por është karakteristikë shpirtërore, dhe është e qartë se burimi i vet është një entitet i pavarur nga materia. Në konkluzionin e librit të tij, Penrose vazhdon:

Vetëdija më duket se është një fenomen i rëndësishëm që thjesht nuk mund t'a besoj se është diçka që ngjallet vetëm "rastësisht" nga një llogaritje e komplikuar. Është një fenomen me të cilin bëhet e njohur edhe ekzistenca e universit. 88

Cila është pikëpamja e materialistëve, atëherë, nën dritën e këtyre zbulimeve? Si mund të pohojnë materialistët se qenia njerëzore përbëhet vetëm nga materia, dhe se qenia njerëzore me intelegjencë, ndjenja, mendime, memorje dhe shqisa, mund të bëhej rastësisht nga atomet e pajetë dhe të pavetëdijshme? Si mund të mendojnë që një proces i tillë është i mundshëm?

Këto pyetje janë brengë e të gjithë materialistëve. Por, në lidhje me këto tema, shkrimet masonike pëmbajnë ide edhe më kurioze sesa që mund të gjenden në shkrimet e materialistëve. Kur hedhim sy në këto shkrime, qartë mund të shihet se pas filozofisë materialiste qëndron "adhurimi i materies".

# MATERIALIZMI MASONIK:
# HYJNIZIMI I MATERIES

Është e domosdoshme që të kuptohet qartë se çfarë është filozofia materialiste: Ata që e përqafojnë këtë filozofi besojnë se rregulli madhështor dhe baraspesha e universit, dhe i miliona llojeve të qenieve të gjalla në botë, përfshirë këtu edhe qeniet njerëzore, u lajmëruan vetëm nga aktiviteti i atomeve që e përbëjnë materien. Me fjalë tjera, ata besojnë se atomet e pajetë dhe të pavetëdijshme janë krijuese.

Pa marrë parasysh se sa moderne mund të duket kjo ide, në të vërtetë është një rishfaqje e një besimi që ka ekzistuar që nga etapat e parë të historisë: idhujtarisë. Ata që kanë adhuruar idhujt besojnë se statujat apo totemët që ata adhuronin kishin shpirt dhe fuqi. Me fjalë tjera, ata ia atribojnë vetëdijën dhe fuqinë e madhe materies së pajetë dhe të pavetëdijshme. natyrisht, kjo është me të vërtetë e pakuptimtë. Në Kur'an, Zoti i referohet iracionalizmit të paganizmit. Në tregimet për profetët, natyra false e besimeve pagane theksohet në veçanti. Për shembull, Ibrahimi pyet babain e tij, "O babai im, pse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh, e as nuk ke kurrfarë dobie prej tij?" (Kur'an, 19:42). Është e qartë se, t'i atribohet materies së pajetë, e cila as nuk mund të shoh e as nuk mund të dëgjoj, "e që janë kretësisht të papërdorshëm", dhe që nuk ka kurrëfarë fuqie, është çmenduri.

Materialistët janë shembuj modern të idhujtarisë. Ata nuk adhurojnë statujat apo totemët të punuar nga guri apo druri, por besojnë në idenë se materia është pjesë përbërëse e të gjitha trupave, dhe mendojnë se kjo materie ka fuqi, intelegjencë dhe njohuri të paskajshme. Shkrimet

masonike kanë disa gjëra interesante që të tregojnë në lidhje me këtë, pasi masonët sheshazi pranojnë këtë besim pagan, çka është edhe esenca e materializmit. Në revistën Mimar Sinan në një artikull shkruan:

Ashtuqë për një objekt material të bëhet, atomet bashkohen në një rend të caktuar. Forca që shkakton këtë organizmi është shpirti që përmban çdo atom. Pasi çdo shpirt ka vetëdije, çdo send i krijuar është vetëdije intelegjente. Dhe çdo gjësend i krijuar është intelegjente në shkallë të njejtë. Një njeri, një kafshë, një bakterie dhe një molekulë janë në të njejtën shkallë të intelegjencës. 89

Nga këtu vërejmë se nga pohimet këtu se çdo atom ka intelegjencë dhe vetëdije. Shkrimtari masonik bën që ky pohim propozon që çdo gjë ka vetëdije pasiqë atë e posedojnë atomet dhe për shkak se ai mohon ekzistimin e shpirtit të njeriut, ai e konsideron njeriun si një masë atomesh, njësoj si një kafshë apo një molekulë të pajetë.

Sidoqoftë, fakti është kështu: materia e pajetë (atomet) nuk kanë shpirt, vetëdije apo intelegjencë. Ky fakt është dëshmuar si me vrojtim ashtu edhe me eksperiment. Vetëm qeniet e gjalla kanë vetëdije, që është si rezultat i "shpirtit" që Zoti iu ka dhuruar. Prej të gjitha qenieve të gjalla, njerëzve u është dhuruar shkalla më e lartë e vetëdijës pasi ata posedojnë një shpirt të posaçëm që Zoti u ka dhuruar.

Me fjalët e tjera, vetëdija nuk është zbuluar në materien e pajetë, ashtu siç besojnë masonët, por në qeniet që kanë shpirt. Por, ashtuqë mos t'a pranojnë ekzistimin e Zotit, Masonët u mbështetën në besimin qesharak ashtuqë i'a mveshën si veti atomeve, "shpirtin".

Besimi materialist i përqafuar nga masonët është një shprehje e re e besimit pagan e quajtuar "animizëm" që supozon se çdo gjë materiale në natyrë (shkëmbjtë, malet, era, uji, etj.) ka shpirtin dhe vetëdijën e vet. Filozofi grek Aristoteli këtë besim e ka kombinuar me materializëm (besimin se materia është absolute dhe nuk është e krijuar) e bile edhe sot, atrubuimi i vetëdijës gjërave të pajetë-duke qenë thelbi i materializmit- është bërë në një lloj paganizmi bashkëkohor.

Shkrimet masonike janë plot me tregime interesante në lidhje me këtë besim. Në një artikull në *Mimar Sinan* të titulluar "Rruga e së vërtetës" përmban këtë:

**Nëse pranojmë kierarkinë animiste dmth se shpirti ekziston në atome,** se molekula dirigjon shpirtin në një atom, se qeliza dirigjon shpirtin në një molekulë, se organi dirigjon shpirtin në një qelizë, a nuk është shpirti kryesor që drejton tërë trupin zot i të gjithë këtyre shprtërave të vegjel? 90

Kjo doktrinë primitive dhe falso bën që masonët të besojnë se baraspesha dhe rregulli në univers shkaktohet nga materja e pajetë. Prapë, në *Mimar Sinan*, një artikull ishte botuar në lidhje me zhvillimet globale gjeologjike. Aty shkruan:

Dëmtimi sipërfaqësor ndodh në mënyrë aq delikate saqë mund të themi se **gjendja e tanishme ka qenë e formuar si rezultar i kësaj intelegjence të fshehur në magmë.** Nëse nuk do të ishte kështu, uji nuk do të mblidhej nëpër zbraztira dhe toka do të ishte e mbuluar krejtësisht nga uji. 91

Një artikull tjetër në revistën *Mimar Sinan* thuhet se qelizat e para të gjalla dhe ato që më vonë janë shumuar nga ato, kanë bërë një plan dhe e kanë implementuar:

Fillimi i jetës në tokë ka ndodhur kur është lindur qeliza e parë. Kjo qelizë menjëherë ka filluar që të lëvizë, dhe me një shtytje të gjallërishme dhe vërtetë këmbëngulëse, ndahet në dysh dhe vazhdon përgjatë rrugës së ndarjes së vazhdueshme. Por këto qeliza të ndara nuk kanë ndonjë qëllim të caktua të kësaj bredhje dhe, sikurse të frikoheshin nga kjo bredhje dhe nga një instinkt i fuqishëm për vetë-ruajtje , këto qeliza të ndara filluan që të bashkëpunojnë në mes veti, bashkohen dhe funksionojnë në një harmoni dhe vetë-flijim të plotë në krijimin e atyre organeve vendimtare për jetë. 92

Por, përkundrazi prej asaj që thuhet në këtë citim, nuk ka vetëdije në qelizën e gjallë. Për të besuar këtë është vetëm një bestytni. Prapë, siç shihet në citimin e mëlartë, ashtuqë të mohohet ekzistenca dhe vepra krijuese e Zotit, ata i atribuojnë veti absurde atomeve, molekulave dhe qelizave, siç janë intelegjenca, aftësia për planifikim, vetë-flijimin e bile edhe "harmoninë demokratike". Kjo është sikur të thuheshin gjepura për krijimin e një pikture në vaj se" ngjyrat u organizuan vetvetiu mes veti sipas një plani, dhe vazhduan së funksionuari në mënyrë demokratike dhe në harmoni," prandaj pohimi i masonëve mbi origjinën e jetës është një gjë e pakuptimtë.

Një shprehje tjetër e zakonshme të parimeve betyte të Masonerisë është termi" **Nëna natyrë".** Në e hasim këtë shprehje në filma dokumentarë, libra e bile edhe në reklama; që shërben që të shprehet besimi se materia e pajetë që e përbën natyrën (azoti, oksigjeni, hidrogjeni, karboni, et.,) ka një fuqi të vetëdijshme, e ajo ka krijuar njerëzit dhe të gjitha qeniet e gjalla. Kjo legjendë nuk është e bazuar në eksperimente apo arsye logjike, por ka për qëllim që të përfitojë njerëzit përmes të një

indoktrinimi në popull. Qëllimi që të harrohet Zoti, Krijuesi i vërtetë, duke i kthyer në paganizëm, në të cilin "natyra" konsiderohet si krijuese.

Masoneria përpiqet që t'i jap formë kësaj kredoje, t'a forcojnë dhe t'a përhapin, dhe i përkrahin të gjitha forcat shoqërore që bëhen aleatë të tyre. Në një artikull në *Mimar Sinan* të titulluar "Idetë për konceptin dhe evolucionin e solidaritetit nga pikëpamja shkencore", flet për "harmoninë misterioze që nëna natyrë ka rregulluar" dhe thekson se kjo është baza e filozofisë humaniste të Masonerisë. Aty më tutje thuhet se masoneria do t'i përkrah ato lëvizje që e përqafojnë këtë filozofi:

Kur ajo merret në konsiderim nga pikëpamja materiale të dhënies dhe marrjes në botën e qenieve të gjalla, se mikrobet benificuese që jetojnë në tokë dhe brenda neve, të gjitha bimët, kafshët dhe qeniet njerëzore ekzistojnë në një harmoni misterioze të rregulluara nga nëna natyrë, dhe se ato janë të angazhuara në një solidaritet organik. Dëshiroj që të konfirmoj edhe njëherë se Masoneria do të përkrah çdo lloj lëvizje psiko-sociale dedikuar mirëqenies, paqës, sigurisë dhe lumturisë, shkurtimisht, çdo lëvizje që është në rrugën e humanizmit dhe bashkimit universal të humanitetit, si mjete dhe vepra që avansojnë deri tek idealet e veta. 93

"Mjetet dhe veprat" më të rëndësishme "që avansojnë idealet e Masonerisë" janë të bazuar në teorinë e evolucionit, përkrahje moderne e materializmit dhe humanizmit.

Kapitulli i ardhshëm do të shikojë më për së afërmi në teorinë e evolucionit që nga koha e Darwinit e deri tek propaganda moderne evolucioniste, dhe do të zbulojmë mardhënjet e fshehta të Masonerisë me këtë gabim më të madh shkencor të të gjitha kohërave.

# V
# RISHQYRTIMI I TEORISË SË EVOLUCIONIT.

Është viti 1832.

Anija "Beagle" lundronte përgjatë Atlantikut të pafund. Anija dukej si çdo anije e zakonshme e udhëtarëve apo anije bartëse, por udhëtimi kishte qëllim zbulimi, dhe që do të zgjaste me vite. Duke u nisur nga Anglia, ajo do të kalojë tërë oqeanin dhe do të arrijë në brigjet e Amerikës Jugore.

"Beagle", një anije që deri atëherë kishte një rëndësi të vogël, u nis për në udhëtim pesëvjeçar.

Atë që do t'a bëjë këtë anije të njohur është udhëtari në të, Charles Robert Darwin, një natyralist 22-vjeçar. Ai në të vërtetë nuk studionte biologjinë por kishte qenë student i teologjisë në Universitetin e Cambridge-it.

Edhepse arsimimi i këtij të riu në teologji ishte gjithëpërfshirës, në kohërat kur ai jetonte ishin thellë të ndikuar nga mendimet materialiste. Në të vërtetë, një vit para se të nisej në rrugëtimin e tij me Beagle, ai kishte hequr dorë nga një numër i rregullave themelore të krishterizmit.

Darwini i ri interpretoi të gjitha zbulimet e bëra në këtë udhëtim në termet e mendimit materialist, dhe kërkonte të sqaronte qeniet e gjalla që ai hulumtonte pa referime nga krijimi hyjnor. Ai i

zhviloi këto ide gjatë viteve pasuese, duke i përpunuar, dhe përfundimisht duke e botuar teorinë e tij. Teoria e tij u propozua më 1859, në librin e tij "Origjina e llojeve" që nuk u prit mirë nga bota intelektuale e shek. të 19-të, edhepse do të sigurojë të ashtuquajturën bazën shkencore që ateizmi kishte kërkuar të gjente me shekuj.

A ishte teoria e evolucionit zbulim origjinal i Darwinit? A e zhvilloi ai pa i ndihmuar askush teorinë e cila i hapi udhë njërës ndër mashtrimeve më të mëdha në historinë e njerëzimit?

Në të vërtetë, Darwini, nuk bëri asgjë tjetër përpos që e korigjoi një ide bazat e së cilës ishin ngritur më herët.

## MITI I EVOLUCIONIT, NGA GREQIA ANTIKE DERI NË EUROPËN MODERNE

Thelbi i teorisë së evolucionit nga Darwini është vlerësimi, se nën kushtet krejtësisht natyrore, materia e jogjallë spontanisht lindi qeniet e para të gjalla, dhe ajo formë pastaj, prapë nën kushtet e njeta, lindi të gjitha llojet tjera dhe u zhvilluan thjesht nga rasti. Me fjalë tjera, teoria e evolucionit propozoi ekzistimin e një sistemi të vetëqëndrueshëm, i cili ka organizuar vetveten pa krijues, dhe spontanisht duke i formuar qeniet e gjalla. Kjo ide, që natyra organizon veteveten pa krijues, u quajt "natyralizëm".

Teoria e natyralizmit është absurd aq sa ideja se një biblotekë mund të formohet vetvetiu pa shkrimtarë. Pothuajse, që nga etapat e para të historisë, kjo ide ka qenë e mbrojtur nga mendimtarët e shumtë e bazuar vetëm nga mendimi i tyre filozofik dhe ideologjik, dhe kishte qenë e adoptuar nga një numër qytetrimesh.

Natyralizmi ishte lindur dhe lulëzuar në shoqëritë pagane si në Egjiptin e vjetër dhe Greqinë e lashtë. Por, me përhapjen e krishterizmit, kjo filozofi pagane u braktis me të madhe, dhe dominonte ideja se Zoti krojoi tërë natyrën dhe universin. Në mënyrë të ngjajshme, prejse Islami u përhap përgjatë Lindjes, idetë e natyralizmit dhe besimet pagane, si zoroastrianizmi dhe shamanizmi, u zhdukën, dhe se fakti i krijimit u pranua.

Megjithatë, filozofia natyraliste vazhdoi të ekzistojë në ilegalitet. Ajo ishte ruajtur nga shoqëritë sekrete dhe u shfaq përsëri, nën rrethana më të përshtatshme. Në botën e krishterë, siç përmendëm edhe në fillim të këtij libri, natyralizmi ishte ruajtur nga masonët, si dhe nga shoqatat tjera sekrete që pasuan shembullin e tyre. Revista turke, me emrin Mason, e botuar për antarët e rendit, siguron këtë informatë të rëndësishme:

Ata që arritën tek zbulimet e reja në botën e fenomeneve dhe ndodhitë natyrore pa e marrë në konsideratë edhe ekzistencën e Zotit ishin të detyruar që t'i mbajnë zbulimet vetëm për vete. Hulumtimet bëheshin fshehurazi kështuqë edhe ata që ishin të angazhuar në hulumtime të ngjajshme mbanin mardhëniet e tyre fshehur. Kjo fshehtësi kërkonte të mbahej me aplikimin e disa shenjave dhe simboleve gjatë ndërmarrjeve të këtyre projekteve. 94

Se çfarë është menduar këtu me "zbulimet e reja" është një kuptim i shkencës nga aspekti i natyralizmit, i një teorie që nuk e pranon ekzistimin e Zotit. Çasje e shtrembëruar ndaj studimeve

shkencore zhvillohej fshehurazi në shoqëritë e fshehta që përdornin shenja dhe simbole për këtë qëllim, dhe në këtë mënyrë u themeluan rrënjët e Masonerisë.

Njëra ndër këto të ashtuquajtura shoqata sekrete, përgjegjëse për mbjelljen e farës së Masonerisë, ishte rendi Rose-Cross (Rosikrus), një lloj pikë-bashkimi mes Tamplierëve dhe masonëve. Ky rend, i dëgjuar për herë të parë në shek. e 15-të, krijoi interesim të madh për alkiminë, e posaçërisht në Europë, për çka antarët e tij thonin se posedonin njohurinë sekrete. Por trashëgimia më e rëndësishme e sotshme rendit Rose Cross është filozofia natyraliste, dhe idea e evolucionit, që është pjesë e saj. Revista Mason thotë se rrënjët e Masonerisë shtrihen tek Tamplierët dhe rosikrusianët, duke e theksuar filozofinë e mëvonshme evolucioniste:

Masoneria teorike apo organizata bashkëkohore e Masonerisë është themeluar në esnafe me ndërtim mesjetar që i referojmë si Masoneria Vepruese. Por, ata që sollën elementet teorike themelore të këtij krijimi ishin antarët e organizatave të caktuara që studiuan sistemet e fshehta parahistorike dhe njohurinë që ato përmbanin. Më e rëndësishmja nga këto organizata ishin Tamplierët dhe rosikrusanët...

Nuk dihet ku dhe kur është themeluar rendi i rosikrusantëve. Gjurmët e para shihen në shek. e 15-të, por është e qartë se rendi është shumë më i vjetër. Dallimi nga tamplierët ishte se interesi themelor i rosekrusantëve ishte shkenca. Antarët e tij me të madhe angazhoheshin në alkimi... Karakteristika më e rëndësishme e antarëve të vet ishte fakti se ata besonin se çdo etapë e zhvillimit ishte etapë në procesin e evolucionit. Për këtë shkak, ata vendosën natyralizmin si themel i filozofive të tyre dhe u bënë të njohur si "natyralistët". 95

Tjetër organizatë masonike që zhvilloi idenë e evolucionit nuk ishte në Perëndim por ishte një rend tjetër masonik e themeluar në Lindje. Grand masteri Selami Isindag, siguron informatën në vijim, në një artikull me titull "Masoneria dhe ne, prej themelimit të saj e deri sot":

Në botën islame, Masoneria kishte homolog të vetin i quajtur Ikhwan as-Safa' (Vëllezërit e dëlirësisë). Kjo shoqatë u formua në Basra në kohën e Abasidsit dhe botoi një enciklopedi me 54 vëllime të mëdha. 17 prej tyre kanë të bëjnë me shkencën natyrore dhe përmbajnë shpjegime shkencore që shumë gjasojnë në ato të Darwinit. Ata gjetën veten të plasohen deri në Spanjë dhe kishin ndikim në mendimin Perëndimor. 96

Edhepse ajo u zhvillua në botën islamike, kjo shoqëri u distancua nga parimet themelore islamike. Ishte e ndikuar nga filozofia e Greqisë antike, që shprehej me format e një simbolizmi sekret. Isindag vazhdon:

Kjo shoqëri me origjinë nga sekti i Ismailit dhe qëllimi themelor i së cilës ishte që të krijoj dogam fetare të kuptueshme përmes shpjegimeve simbolike dhe alegorike. Filozofia e saj ishte ndikuar nga Pitagora te Platoni. Për të hyrë në këtë shoqëri të fshehtë, personi së pari duhej që të tërheqej nga udhëzimet mistike e më vonë spastrimin nga besimet dhe dogmat e kota fetare. Më vonë ai ishte njohur më për së afërmi me metodat filozofike dhe simbolike. Një pranim i tillë që kalonte përmes "stazhit" fillestar ndonjëherë duhej që të kalonte ushtrimet e ideve neo-platonike, e pastaj ai mund të fillonte me kimi, astrologji dhe numerologji, shkencë për kuptimin e numrave. Por e gjithë kjo njohuri mbahej sekret dhe u jipte vetëm atyre që mendohej që e meritonin. Kështu, zanafilla e Masonerisë bazohet në këto themele. Disa nga kuptimet simbolike të këtyre

elementeve nuk ishin në kundërshtim me shkencën dhe logjikën prandaj edhe ka mbijetuar në vende të ndryshme në ritualet tona të sotme. 97

Fjalët e cituara më lartë, “spastrimin nga besimet dhe dogmat e kota” është një eufemizëm i veçantë i filozofisë masonike. Duhet që të pranohet se Masoneria, apo ndonjë grup tjetër materialist, shpreh ide aq antifetare pa ndonjë arsyetim logjik; ata mbështeten vetëm në propagandë dhe sugjestion. Meqenëse ata nuk mund të dënojnë religjionin në mënyrë racionale, ata gjejnë ngushllim në metodat e sugjestionit dhe fjalët e përzgjedhura ashtuqë të krijojnë një efekt të veçantë psiqik.

Nga citimi më lartë, mësojmë se Ikhwan as-Safa', shoqëri paralele me Frankmasonerinë në botën islame, performon aktivitete shumë të ngjajshme si Masoneria moderne. Metoda e tyre ishte që të përqafohej filozofia pagane që është e kundërt me fenë e vërtetë, që të shprehin atë filozofi me anënën e simboleve, dhe të prezentojnë këtë filozofi të fshehtë gradualisht antarëve të vet.

Në historinë islamike kanë kaluar mendimtarë të ndryshëm që në këtë mënyrë larguan veten nga Islami, dhe ishin nën ndikimin e materialistëve të Greqisë antike dhe miteve evolucioniste. Fakti se kjo shkollë e mendimit, të cilën dijetari i madh islamik Gazali në veprat e tij aq shumë i përgënjeshtroi dhe i vinte neveri, kishte karakter masonik në të sigurisht hedh pak dritë mbi këtë çështje. Në veprën e tij Al-Munqidh min al-Dalal (Shpëtimi nga lajthitja), Gazali drejpërdrejt kritikoi shoqatën Ikhwan as-Safa', duke shpjeguar se ajo kishte përqafuar një filozofi të degjeneruar të ndikuar nga Greqia antike. Dhe vepra e tij e titulluar Fedaih-ul-Batinniyye, ai demostroi zvetëninë e mësimeve të sektit Ismaili, që i takonte edhe Ikhwan as-Safa'.

## ILUMINIZMI DHE SHFAQJA E MITIT TË TEORISË SË EVOLUCIONIT

Idetë materialiste dhe evolucioniste të adoptuara nga organizatat Masonike siç ishin Rosikrusanët apo Ikhwan as-Safa', shpreheshin fshehurazi, por shumë shpesh edhe simbolikisht, u bënë çdo herë e më të hapur prej se fuqia shoqërore e Kishës fillonte të dobësohej. Si rezultat, këto njohuri pagane, që kishin kaluar në ilegalitet para rreth 1.000 vjet për shkak të dominimit politik dhe intelektual të krishterizmit, u modernizua prapë në mesin e mendimtarëve europianë të shekujve 17-të dhe 18-të.

Periudha në të cilën idetë materialiste dhe evolucioniste fituan përkrahje të gjërë në shoqërinë europiane, dhe kishte ndikuar në distancimin e vet nga religjioni, është e njohur si Iluminizëm. Sigurisht, ata që e zgjodhën këtë term (dmth. Ata që karakterizojnë këtë ndryshim të ideve pozitivisht si një lëvizje kah drita, gjegj. Njohuria) ishin liderët e këtij devijimi. Ata sqaruan etapën e mëhershme si "Epoka e errët" dhe fajsonte fenë për këtë, duke pohuar se Europa u ndriqua kur ajo iu kthye laicizmit dhe iu largua religjionit. Kjo anësi dhe perspektivë e rremë ende edhe sot është njëra ndër mekanizmat themelor propaganduese të atyre që e kundërshtojnë religjionin.

Është e vërtetë që krishterizmi mesjetar ishte pjesërisht "i errët" me bestytni dhe fanatizëm dhe shumica e këtyre janë spastruar në epokën pas-mesjetare. Në fakt, Iluminizmi nuk solli edhe aq shumë rezultate pozitive Perëndimit. Rezultati më i rëndësishëm i Iluminizmit, që u përhap në Francë, ishte Revolucioni Francez, që i solli vendit një gjakderdhje të madhe. Sot literatura e ndikuar e Iluminizmit lavdëron Revolucionin Francez; sidoqoftë Revolucioni i ka kushtuar shumë

Francës dhe ka shkaktuar konflike shoqërore që kanë zgjatur deri në shek. e 20-të. Analizat e Revolucionit Francez dhe Iluminizmit e mendimtarit të famshëm britanik, Edmund Burke, është mjaft domethënës. Në librin e tij Komentet e Revolucionit në Francë të botuar më 1790, ai kritikoi edhe idenë e Iluminizmit dhe prodhimi i tij, Revolucioni Francez; sipas mendimit të tij, kjo lëvizje shkatërroi vlerat themelore që mbante shoqërinë të bashkuar, siç ishte religjioni, morali dhe struktura e familjes, dhe i hapi rrugën terrorit dhe anarkisë. Përfundimisht, ai konsideronte Iluminizmin, si një shpjegues që e quajti, si" lëvizje shkatërruese e mendjes njerëzore". 98

Udhëheqësit e kësaj lëvizje shkatërruese ishin masonët. Volteri (Voltaire), Didëro (Diderot), Monteskje (Monesquie), dhe mendimtarët tjerë antifetarë që përgaditën rrugën e revolucionit, ishin masonë. Masonët ishin miqë të ngushtë me jakobinët që ishin udhëheqës të Revolucionit. Kjo kishte shpier disa historianë në mendimin se është vështirë të dallohen Jakobinizmi dhe Masoneria në Francë në këtë periudhë. (Shiko librin Rendi i ri masonik, nga Harun Yahya)

Gjatë Revolucionit Francez, ishte shfaqur armiqësi e madhe ndaj religjionit. Shumë klerikë ishin dërguar nën gilotinë, kishat ishin shkatërruar dhe përveç kësaj, ata ishin që dëshironin që t'a çrrënjosnin krejtësisht krishterizmin dhe t'a zëvendësonin me një religjion deviant, pagan dhe simbolik i quajtur "Religjioni i arsyes". Udhëheqësit e Revolucionit gjithashtu u bënë viktimë e kësaj çmendurie, çdonjërit iu hoq koka nën gilotinë, që më parë dënonin shumë njerëz. Bile edhe sot, shumë francezë vazhdojnë të pyesin se a ka qenë Revolucioni gjë e mirë apo jo. Sentimenti antifetar i Revolucionit Francez u përhap nëpër Europë dhe si rezultat, shek, i 19-të u bë njëri ndër periudhat më të guximshmet dhe më agresivet të propagandës antifetare. Në këtë mënyrë, ky proces lejoi mundësinë e ideve materialiste dhe evolucioniste, që ishin aktive në ilegalitet me shekuj përmes përdorimit të simboleve, të shfaqet prap në popull.

Materialistët, si Didëro dhe Baron d'Holbach, ngriti flamurin antifetar, dhe miti i evolucionit nga Greqia antike ishte prezentuar botës shkencore.

## ERASMUS DARWINI

Ata që përgjithësisht mendohet të jenë themeluesit e teorisë së evolucionit janë biologu francez Jean Lamarck dhe biologu anglez, Charles Darwin. Sipas këtij tregimi klasik, së pari Lamarcku propozoi teorinë e evolucionit, por ai bëri gabim pasi e themeloi mbi "trashëgiminë e veçorive të fituara". Më vonë, Darwini propozoi teorinë tjetër e bazuar mbi seleksionimin natyror.

Siodqoftë, këtu duhet që të përmendim emrin e një teoricienti tjetër i cili luajti një rol të rëndësishëm në origjinën e teorisë së evolucionit: ai ishte Erasmus Darwini, gjyshi i Charles Darwinit.

Erasmus Darwini ishte bashkëkohanik i Lamarckut në shek. e 17-të. Një fizicient, psikolog dhe poet, ai njihej edhe si autoritet. Biografi i tij, Desmond King- Hele atë e quajti edhe si anglezi më i madh i shek. të 18-të. 99 Por, Erasmus Darwini kishte një jetë shumë të errët private. 100 Erasmusi kryesisht ishte i shquar se njëri ndër natyralistët më prominent. Siç thamë në fillim, natyralizmi është një pikëpamje që nuk e praon se Zoti i ka krijuar qeniet e gjalla. Në të vërtetë, kjo pikëpamje, që është e afërt me materializmin, ishte pika nisëse e teorisë së evolucionit të Erasmus Darwinit. Në vitet 1780-ta dhe 1790-ta, Erasmus Darwini zhvilloi thekset themelore të teorisë së evolucionit, sipas së cilës të gjitha qeniet e gjalla vijnë nga paraardhësi i vetëm i

përbashkët nga rastësia dhe sipas ligjeve të natyrës. Ai hulumtimin e vet e bëri në një kopsht botanik me një sipërfaqe prej 8 akrësh (3.23 hektarësh) që e kishte përgaditur, dhe vërejti dëshmitë që do të siguronte idenë e tij. Ai teorinë e tij e shpjegoi në dy libra, me titujt "Tempulli i natyrës" dhe "Zoonomia". Përveç kësaj, më 1784 ai themeloi një shoqatë ashtuqë të bëj përhapjen e idesë së tij, e njohur si Shoqata Filozofike.

Më vonë, Charles Darwini do të trashëgoj idetë e gjyshit të tij dhe planin bazë për teorinë e tij të evolucionit. Teoria e Charles Darwinit e përpunuar nga struktura e themeluar nga gjyshi i tij, ndërsa Shoqëria Filozofike u bë njëra ndër përkrahësit më të zjarrtë të teorisë së tij. 101.

Shkurtimisht, Erasmus Darwini ishte pionieri i vërtetë i teorisë që ne e njohim si teoria e evolucionit që është propaganduar përreth botës për më se 150 vjet.

Ku e mori Erasmus Darwini idenë e evolucionit? Nga i erdhi interesimi në këtë çështje?

Pas një kërkimi gjithëpërfshirës për të gjetur përgjegjen në këtë pyetje, zbuluam një fakt interesant se Erasmus Darwini ishte një mason. Edhepse Erasmus Darwini nuk ishte një mason i rregullt, ai ishte njëri ndër masonët me shkallën më të lartë në organizatë.

Ai ishte kryesuesi Llozhës së famshme në Edinburgh, Skoci. 102 Përveç kësaj ai kishte lidhje të ngushta me masonët jakobinë të cilët ishin organizatorët e Revolucionit Francez atëherë, dhe së bashku me ilumninistët, të cilët qëllim kryesor kishin përkujdesjen për armiqësi ndaj religjionit. 103 Dmth., Erasmus Darwini ishte një emër i rëndësishëm në organizatat europiane masonike antifetare.

Erasmusi eduloi djalin e tij Robertin (babain e Charlesit), i cili gjithashtu ishte antar i një llozhe masonike. 104 Për këtë shkak, Charles Daqwini ka marrë mësim nga trashëgimia e mësimeve masonike si nga babai ashtu edhe nga gjyshi i tij.

Erasmus Darwini shpresonte se i biri i tij Roberti do të zhvillonte dhe publikonte teorinë e tij, por do të jetë nipi i tij, Charlesi ai i cili do të merrte ndërmarrjen e tij. Edhe pse me vonesë, Tempulli i natyrës përfundimisht u ripunua nga Charles Darwini. Pikëpamjet e Darwinit nuk kishin rëndësi si ide shkencore; ishte vetëm se një shprehje e një doktrine natyraliste që merr natyrën si një fuqi krijuese.

## MASONËT DHE FILOZOFIA NATYRALISTE

Për teorinë e seleksionimit natyral që ne pandehnim të ishte kontributi i veçantë i Darwninit, ajo gjithashtu ishte edhe një teori e parashtruar edhe nga një numër shkenctarësh. Por, shkenctarët para kohës së Darwinit nuk e përdorën teorinë e seleksionimit natyral si një argument kundër krijimit; në të kundërtën, ata atë e panë si një mekanizëm i dizajnuar nga Krijuesi që t'i mbrojë nga përkeqsimet trashëguese. Sikurse Karl Marxi që mori konceptin idealist të Hegelit për "dialektikën", dhe e shëndërroi në filozofi të vetën; në atë mënyrë Darwini mori teorinë e seleksionimitnatyror nga shkenctarët kreacionistë dhe e përdori ashtuqë t'i përshtatej idesë së natyralizmit.

Prandaj, kontributi personal i Darwinit në formulimin e darwinizmit nuk duhet që të stërmadhohet. Konceptet filozofike që ai përdori ishin zbuluar m herët nga filozofët e mëhershëm të natyralizmit. Nëse Darwini nuk do t'a kishte propozuar teorinë e evolucionit, atëherë dikush tjetër do t'a propozonte. Në të vërtetë, një teori e ingjajshme me të ishte propozuar në periudhën e njejtë nga një shkenctar tjetër natyralist anglez i quajtur Alfred Russell Wallace; që ishte arsyeja që Darwini ngutej që t'a botonte Origjinën e llojeve.

Përfundimisht, Darwini u shfaq në skenë kur luftë e gjatë kishte filluar në Europë për të shkatërruar besimin në Zot dhe fenë, për t'a ndërruar me një filozofi natyraliste dhe një model humanist për jetën e njeriut. Forca më e rëndësishme pas kësaj lufte nuk ishte ai apo ndonjë mendimtar tjetër, por ishte organizata e Masonerisë, në të cilën ihin shumë mendimtarë, ideologë dhe udhëheqës politikë.

Ky fakt është pranuar dhe shprehur nga disa të krishterë të asaj kohe. Papa Leo i 13-të, udhëheqësi i katolikëve në botë, më 1884 nxorri botimin me titull Humanum Genus në të cilën ai dha disa deklarata të rëndësishme për Masonerinë dhe aktivitetet e saj. Ai shkruante:

Në këtë kohë, sidoqoftë, përkrahësit e së keqes duket se janë bashkuar, dhe janë duke luftuar me vrull të bashkuar, duke udhëhequr apo ndihmuar nga ajo shoqatë e organizuar mirë dhe e shtrirë plotësisht e quajtur Frankmasoneria. Duke mos i fshehur më qëllimet e tyre, ata tani me të madhe janë duke u ngritur kundër Vetë Zotit.

... siç po shihet shumë qartë nga lartë, ajo që forcat e tyre të qëllimshme përfundimtare i bën të dukshme- dmth., që t'i përmys plotësisht të gjithë atë që rregullimi politik dhe fetar i botës kishte bërë nga mësimet e krishterë, si dhe zëvendësimin me një strukturë të re të gjërave që ishin në

pajtim me idetë e tyre, të "një strukturë të re të gjërave që ishin në pajtim me idetë e tyre ku themelet dhe ligjet të nxirreshin vetëm e vetëm nga natyralizmi."105

Fakt të rëndësishëm që Leo i 13-të përmend në citatin e mëlartë është tentimi që të shkatërrojë krejtësisht vlerat morale që jep religjioni. Çfarë Masoneria përpiqej që të arrijë me darvinizëm ishte që prodhojë një shoqëri të degjeneruar moralisht që nuk do të njihej kurrëfarë ligji hyjnor, mos t'i frikësohen Zotit, dhe të ishte e prirur për të bërë çdo lloj krimi. Se çfarë mendohej me këtë "gjendje të re të gjërave në pajtim me idetë e tyre ku bazat dhe ligjet do të bëheshin vetëm nga materializmi" është ky lloj modeli shoqëror.

Masonët, duke menduar se darvinizmi do të shërbejë për arritjen e synimeve të tyre, luajtën rol të madh në propagandimin në masë. Menjëherë pas botimit të teorisë së Darwinit, një grup vullnetarësh propagandistë u formua rreth saj, ku më i njohuri ishte Thomas Huxley që quhej ndryshe edhe "bulldogu" i Darwinit. Huxley "përkrahja e flaktë e të cilit ndaj darvinizmit ishte faktor i vetëm dhe më përgjegjëse për pranimin e saj të shpejtë" 106 i tërhoqi vëmendjen botës për teorinë e evolucionit në debatin të mbajtur në muzeun e Universitetit të Oxfordit në të cilin ai hyri më 30 qershor 1860 së bashku me peshkopin e Oxfordit, Samuel Wilberforce.

Përkushtim i madh i Huxley-it për përhapjen e idesë së evolucionit, së bashku me lidhjet me institucionet, u arrit sipas këtij fakti: Huxley ishte anëtar i Shoqërisë Mbretërore, njërës prej institucioneve më prestigjioze shkencore dhe sikurse gati të gjithë antarët e këtij instituti, ishte mason senior. 107 Antarët tjerë të Shoqërisë Mbretërore i bënë përkrahje të rëndësishme Darwinit, para dhe pas botimit të librit. 108 Kjo shoqatë masonike pranoi Darwinin dhe

darvinizmin deri në atë nivel, saqë përpos shpërblimit me çmimin Nobel, medalja e Darwinit mendoj ishte shpallur edhe si çmim nderi.

Shkurtimisht, Darwini nuk vepronte i vetmuar; që nga kur teoria e tij u propozua, ai u përkrah nga klasat shoqërore dhe grupet, në bërthamën e të cilave ishin masonët. Në librin e tij, Marksizmi dhe darvinizmi, mendimtari marksist Anton Pannekoeks shkruan për këtë fakt të rëndësishëm dhe përshkruan përkrahjen e Darwinit nga ana e "borgjezisë", dmth., klasës së pasur kapitaliste europiane:

Se Marksizmi i ka borgj për rëndësinë dhe pozitën e vet vetëm rolit të tij që ka në luftën klasore të proletariatit, është e njohur për të gjithë... Por nuk është vështirë që të shihet se në realitet darvinizmi është dashur që të kalojë në të njejtat përjetime sikurse marksizmi. Darvinizmi nuk është vetëm një teori e thjeshtë abstrakte që ishte adoptuar nga bota shkencore pas diskutimit dhe duke e testuar atë vetëm në çështje objetkive. Menjëherë pasi u shfaq darvinizmi, ai kishte mbrojtësit e vet entuziastë dhe kundërshtarët e zjarrtë... Darvinizmi gjithashtu, luajti rol në luftën klasore, dhe se i ka borgj këtë rol që i përhap aq shpejt dhe kishte mbrojtës entuziastë dhe kundërshtarë të vrerosur.

Darvinizmi shërbeu si mjet borgjezisë në luftën e tyre kundër klasës feudale, kundër fisnikërisë, të drejtave të klerit dhe feudalëve... Çfarë donte borgjezia ishte që të heqte qafe të fuqive të vjetra sunduese që u gjindeshin përpara... Me ndihmën e religjionit priftërinjët kanë mbajtur një meshë të madhe dhe të gatshëm që t'i kundërvehet kërkesave të borgjezisë...

Shkenca natyrore u bë një armë kundërshtare e besimit dhe traditës; shkenca dhe ligjet e reja të zbuluara shkencore ishin avancuar; këto ishin armët që luftonte borgjezia...

Darvinizmi u shfaq në kohën e duhur; teoria e Darwinit që thotë se njeriu është pasardhës i një kafshe më të ultë shkatërroi krejtësisht themelet e dogmës së krishterë. Kjo është për shkak se prej se u shfaq darvinizmi, borgjezia filloi të punojë zellshëm.

... Në këto rrethana, edhe debatet shkencore bëheshin me zell dhe pasion të luftës klasore. Shkrimet që u shfaqën për dhe kundër Darwinit kishin në këtë mënyrë karakter të polemikave shoqërore, edhepse aty qëndronin emrat e autorëve të shkencës... 109

Edhepse Anton Pannekoek, pasi mendonte nën kushtet e analizave klasore marksiste, definonte forcën që përhapte darvinizmi dhe i vuri në funksion një luftë të organizuar kundër religjionit si "borgjezi", kur të shqyrtojmë çështjen nën dritën e më dhumë dëshmiive historike, shohim se ekzistonte një organizatë brenda borgjezisë që përdori darvinizmin që të ushtronte luftën e tyre kundër religjionit. Kjo organizatë ishte Masoneria.

Ky fakt është i qartë si nga faktet historike edhe si nga burimet masonike. Njëra ndër burimet e tilla është një artikull nga master masoni Selami Isindaf, titulluar "Pengesat në zhvillimin e diturisë dhe Masoneria", që u botua më 1962 në Buletinin vjetor të llozhës së madhe turke për masonët e lirë dhe të pranuar. Në fillim të këtij artikulli, Isindag përsërit pohimet klasike të masonëve se feja është një legjendë e shpikur nga njerëzit, dhe se monoteizmi është në kundërshtim me arsyen dhe shkencën. Më vonë, ai përshkruan nxitësin e vërtetë të luftës kundër fesë që bëhej në maskën e "shkencës":

Do të vërehet se në këtë luftë për përhapjen e diturisë, është e njohur se masonët kanë qenë pjesëmarrës në çdo nivel. Arsyeja për këtë është se Masoneria, në çdo periudhë, ka qenë çdoherë i

udhëhequr nga arsyeja, njohuria dhe pjekuria, dmth., me mençuri. Prej se është themeluar, ajo ka luftuar kundër bestytnive dhe mitit. 110

Por, në të vërtetë, feja nuk është "bestytni dhe mit", siç pohojnë masonët; apo më mirë me thënë, baza e besimit materialist, natyralist dhe evolucionist që ata përkrahnin. Dëshmia më e qartë e këtij fakti janë idetë e tyre të vjetruara, përsëritjet e tyre të besimeve të kota të qytetrimeve të vjtra pagane të Egjiptit dhe Greqisë, që janë bërë të pavlefshme nga zbulimet e shkencës bashkëkohore.

Një krahasim i fakteve shkencore relevante me origjinën e jetës dhe besimeve masonike do të jetë e mjaftueshme që të formulojmë një konkluzë për sa i përket këtij fakti.

## TEORIA MASONIKE E ORIGJINËS SË JETËS

Siç deklaruam në fillim, teoria e evolucionit qëndron në pohimin se qeniet e gjalla nuk kanë të krijuara, por lindën dhe u zhvilluan rastësisht dhe sipas ligjeve natyrore. Ashtu që të testohet kjo teori shkencërisht, është e domosdoshme që të shikohet në secilën etapë të këtij procesi të supozuar, dhe që të shqyrtohet se nëse procesi ka ndodhur në të kaluarën dhe a ka mundur që ky proces të jetë i mundur.

Hapi i parë i këtij procesi janë kushtet e supozuara brenda së cilës materia jo e gjallë ka mundur që të shëndërrohet në organizëm të gjallë.

Para se të shqyrtojmë këto kushte, duhet që të përmendim ligjin që në biologji njihet si ligjii Pasteurit: "Jeta rrjedh nga jeta." Kjo dmth., një organizëm i gjallë mund të lind vetëm nga organizmi tjetër i gjallë. Për shembull, sisorët lindin nga nënat e tyre. Shumë lloje tjera lindin na veza që së pari ka qenë nën nënën. Bimët rriten nga fara. Organizmat një qelizorë si bakteria për shembull, ndahet dhe shumohet.

Askush asnjëherë nuk ka parë diçka tjetër të kundërt. Gjatë historisë kurkush nuk ka qenë dëshmitar i lindjes së një qenies së gjallë nga një qenie jo e gjallë. Natyrisht, kishte njerëz në Egjiptin e vjetër, Greqinë antike dhe në mesjetë njerëz që kanë menduar se kanë vëzhguar një gjë të tillë; p.sh. egjiptasit besonin se bretkosat lindnin nga balta e Nilit, besim që u përcoll nga filozofët e Greqisë Antike, siç ishte Aristoteli. Në mesjetë besohej se minjtë vinin nga hambarët e grurit. Sidoqoftë, të gjitha këto besime u dëshmuan si pjellë e injorancës, dhe përfundimisht, në eksperimentin e tij të famshëm në vitet e 1860-ta, Pasteuri dëshmoi se bile bile edhe bakteria, si forma më e thjeshtë e jetës, nuk ka ardhur në jetë pa paraardhës, që dëshmon se është e pamundur që gjërat e pajetë të prodhojnë jetë.

Por, teoria e evolucionit varet nga kjo pamundësi pasiqë pohon se qeniet e gjalla ishin lindur dhe zhvilluar pa ndërmjetsimin e ndonjë krijuesi, dhe kjo kërkon që, në etapën e parë të këtij skenari të propozuar, qeniet e gjalla të krijohen nga rasti.

Darwini përpiqej që të përshkruante origjinën e jetës, për të cilën ai dinte pak, shkurtimisht, ku ai thonte se jeta do të duhej të jetë paraqitur së pari "në një pellg të vogël dhe të ngrohtë", 111 por evolucionistët që pasuan atë u brengosën rreth elaborimit të çështjes më tutje. Sidoqoftë, përpjekjet e bëra gjatë shek. të 20-të që të arrijnë një shpjegim evolucionist të origjinës së jetës

rezultuan vetëm me thellimin e tyre në qorrsokak. Pavarësisht nga fakti që evolucionistët nuk ishin në gjendje që të japin dëshmi të vockël shkencore për gjenerimin e jetës nga materia e jogjallë, ata nuk mundeshin që të japin bile së paku edhe shpjegim teorik, pasiqë edhe struktura e organizmit më të thjeshtë të gjallë është shumë komplekse. Kjo është e pamundur edhe matematikisht që edhe përbërësit themelorë të qelizës- si proteinet, ADN-ja apo ARN-ja, të formohen rastësisht, e le më qeliza.

Fakti se mundësia e gjenerimit të jetës nga rasti vetevetiu dëshmon ekzistencën e një dizajni, dhe kjo, përndryshe, dëshmon faktin e krijimit. Në lidhje me këtë çështje, astronomi dhe matematikani i famshëm anglez, Fred Hoyle, bën këtë koment:

Në të vërtetë, një teori e tillë (se jeta ishte krijuar nga një intelegjencë) është aq e qartë saqë dikush mund të pyetet pse nuk është pranuar në suaza edhe më të gjëra duke qenë aq e vetëkuptueshme. Arsyet janë më tepër psikologjike sesa shkencore.112

Kjo "arsye psikologjike" që përmend Hoyle është gadishmëria e evolucionistëve me të cilën ata insistojnë në refuzim, që më parë, çdo rezultat që i dërgon ata në pranimin e ekzistencës së Zotit dhe kushtëzimin e tyre për këtë.

Në veprat tona duke u përqëndruar në pavlefshmërinë e teorisë së evolucionit, kemi cituar shumë pohime të këtij fakti nga evolucionistët dhe shqyrtuam hipotezat iracionale që evolucionistët verbërisht kanë propozuar vetëm që të mos e pranojnë ekzistencën e Zotit. Në këtë vend, ne do të përqëndrojmë vëmendjen tonë në llozhat masonike që të shohim pikëpamjet e tyre për këtë çështje. Derisa është shumë evidente se "jeta ka lindur nga një Krijues i mençur", çfarë mendojnë masonët lidhur me këtë çështje?

Master masoni, Selami Isindag, në librin e tij dedikuar publikut masonik, të titulluar "Rruga e evolucionit" (Evrim Yolu), shpjegon materien në këtë mënyrë:

Karakteristika më e rëndësishme e shkollës sonë të parimeve morale është se ne nuk largohemi nga parimet e logjikës dhe ne nuk hyjmë në të panjohurat e teizmit, domethënieve sekrete dhe dogmave. Në këtë bazë ne vlerësojmë se paraqitja e parë e jetës fillon në kristale në kushtet që sot nuk mund t'i dijmë dhe t'i zbulojmë. Qeniet e gjalla kishin lindur sipas ligjit të evolucionit dhe ngadalë është përhapur në tërë botën. Si rezultat i evolucionit, qeniet e sotme njerëzore u krijuan dhe zhvilluan më shumë se kafshët tjera si nga vetëdija ashtu edhe për nga intelegjenca. 113

Vlen të theksohet se lidhshmëria ndërmjet shkakut dhe efektit të sugjeruar në citatin e mësipërm: Isindag thekson se karakteristika më e rëndësishme e Masonerisë është se ata refuzojnë teizmin, dmth., besimin në Zot. E menjëherë mandej, ai pohon se "në këtë bazë" ku jeta ka lindur në mënyrë spontane nga materia e jogjallë, dhe më vonë ka ngjarë evolucioni që ka rezultuar me paraqitjen e qenieve njerëzore.

Do të vërehet se Isindag nuk sjell prova shkencore që vërtetojnë teorinë e evolucionit. (Fakti që nuk ka prova shkencore është parasupozuar me fjalët pa peshë se këto fakte "sot nuk mund t'i dijmë dhe t'i zbulojmë "). E vetmja mbështetje që ka Isindag për teorinë e evolucionit është mospranimi i teizmit nga masonët.

Me fjalë të tjera, masonët janë evolucionistë pasi ata nuk e pranojnë ekzistimin e Zotit. Kjo është arsyeja e vetme që ata të jenë evolucionistë.

Në themelimin e "Këshillit të madh turk" organizuar nga masonët turq të shkallës së 33-të, skenari i evolucionit është deklaruar prapë, dhe se refuzimi nga masonët të kreacionizmit shpjegohet me këto fjalë:

Në periudhën shumë të hershme dhe sipas një procesi inorganik, lindi jeta organike. Ashtuqë të prodhohen organizmat qelizorë qelizat u bashkuan në grupe. Më vonë, intelegjenca buroi dhe u lindën njerëzit. Por prej nga? Ne vazhdimisht pyesim veten. A ishte nga fryma e Zotit sipër baltës së paformë? Ne mohojmë shpjegimin për një krijim jonormal; një lloj krijimi që përjashton njeriun. Pasiqë ekziston jeta dhe prejardhja e saj, duhet pasuar vijën filogjenetike dhe të ndiejmë, kuptojmë dhe mësojmë se rrota ekzist që e shpjegon këtë vepër të madhe, dmth është një akt "kërcimi". Duhet besuar se ishte një fazë e zhvillimit në të cilën kishte një aktivitet i madh që bëri që jeta të kalojë në një çast të veçantë prej një faze në tjetrën. 114

Këtu është lehtë që të dallohet fanaticizmi masonik. Kur shkrimtari thotë se ata " mohojnë atë lloj krijimi që përjashton njeriun", ai përsërit dogmën themelore të humanizmit, që "njeriu është krijesa më e lartë që ekziston," duke treguar se masonët mohojnë çdo mënyrë tjetër shpjegimi. Kur ai thootë, "një krijim jonormal", ai mendon në intervenimin e Zotit në krijimin e qenieve të gjalla, duke mohuar apriori këtë mundësi. (Sidoqoftë, çfarë me të vërtetë është abnormale është ajo se masonët pranojnë, pa kurrëfarë eksperimenti apo vrojtimi, besimin jologjik që materia e jogjallë të lind nga rasti dhe krijoi jetën në tokë, duke përfshirë edhe njerëzit.) mund të vërehet se sipas shpjegimeve masonike nuk ka sygjerim apo dëshmi shkencore. Masonët nuk thonë "Ja ku është dëshmia për evolucion dhe në këtë mënyrë ne mohojmë krijimin." Ata vetëm jan verbëruar nga një fanatizëm filozofik.

Publikimet masonike insistojnë në këtë parim. Master masoni Selami Isindag pohon se "pavarësisht nga natyra nuk ka forcë tjetër që n'a udhëheqë, dhe është përgjegjëse për mendimet dhe veprat tona." Ai menjëherë shton, "jeta filloi nga një qelizë dhe arriti nivelin e tanishëm si rezultat i ndryshimeve dhe evolucioneve të ndryshme." 115 Më vonë ai përmbledh se çfarë do të thotë teoria e evolucionit për masonët:

Nga pikëpamja e evolucionit, njerëzit nuk dallojnë nga kafshët. Për formimin e njeriut dhe evolucionit të tij nuk ka forca të ndryshme nga ato të vcilave u janë nënshtruar kafshët. 116

Ky vlerësim tregon qartë pse masonët i japin kaq rëndësi të madhe teorisë së evolucionit. Qëllimi i tyre është të mbrohet ideja se njerëzit nuk janë krijuar dhe e paraqesin filozofinë e tyre humaniste si filozofi me themel. Dhe, metoda e vetme që mund të përdoret për të mohuar idenë se njerëzit ishin krijuae sipas teorisë së evolucionit. Pra, kjo është arsyeja që masonët, në çfarëdo mase, besojnë në teorinë eë evolucionit dhe përpiqen që t'a përhapin në shoqëri.

Kjo tregon se masonët, që vazhdimisht akuzojnë besimtarët që besojnë në Zot se janë dogmatikë, janë vetë dogmatikë.

## DOGMATIZMI DHE TRADICIONALIZMI MASONIK

Dogmatizëm do të thotë që të përkrahet verbërisht dhe me këmbëngulje, për vlefshmërinë e të cilës nuk ka dëshmi, për shkak të një parakushti të veçantë psikologjik. Një dogmatist nuk

hulumton apo rikonsideron atë në të cilën beson pa marrë parasysh se a ka apo jo dëshmi. Ai e pranon atë tërësisht dhe i përmbahet asaj me çdo kusht.

Masonët dhe grupet tjera antifetare vazhdimisht përdorin termin "dogmatik" duke iu referuar atyre që besojnë në Zot. Shumë shpesh sot hasim në kësi lloj akuzimi. Për shembull, në një diskutim mbi teorinë e evolucionit, ana evolucioniste me siguri se do t'i akuzojë ata që nuk e pranojnë këtë teori si dogmatikë, ndërsa veten e shpall shkencor duke thënë se shkenca nuk ka interesim në "dogma".

Sidoqoftë, kjo akuzë është flaso. Besimi në ekzistimin e Zotit, dhe në atë se Ai krijoi të gjitha qenit, është besim që përkrahet me shumë dëshmi racionale dhe shkencore. Ekziston baraspesha, rregulli dhe dizajni në natyrë, dhe është e qartë se kjo është sjellur në këtë gjendje në mënyrë intelegjente dhe me një qëllim të paramenduar.

Kjo është për shkak se Kur'ani thërret njerëzit që të zbulojnë shenjat e Zotit, dhe i fton ata që të vrasin mendjen për këtë baraspeshë, rregull dhe dizajn, dhe në shumë ajete i urdhëron ata që të mendojnë për dëshmitë në qiell dhe në tokë për ekzistimin e Zotit. Këto dëshmi të përmendura në Kur'an janë fenomene, jo vetëm që balansojnë dhe rregullojnë gjithësinë, por edhe sigurojnë botën për jetën e njeriut, dizajnin e bimëve dhe shtazëve, dizajni në trupin e njeriut, si dhe cilësitë shpirtërore të njerëzve, që të gjitha kanë qenë të vërtetuara edhe nga shkenca moderne. (Për më shumë detale, mund të gjesh në librat e Harun Yahyas, "Allahu njihet përmes arsyes", "Krijimi i universit", "Përgënjeshtrimi i Darvinizmit", "Për ata që kuptojnë", "Dizajni në natyrë").

Më tepër, dogmatizmi është një cilësi e atyre që refuzojnë të vrasin mendjen për këto gjëra, dhe mohojnë Zotin dhe mbrojnë pikëpamjen se universi ekziston vetvetiu sipas vullnetit të vet dhe se

qeniet e gjalla u paraqitën rastësisht. Masonët janë shembull konkret. Përkundër faktit se dëshmitë për ekzistimin e Zotit janë evidente, ata parapëlqejnë që t'i injorojnë dhe refuzojnë në favor të filozofisë humaniste dhe materialiste.

Në Kur'an, Zoti tregon për ata që kanë mendësi të tillë:

A nuk e dini ju se All-llahu nënshtroi për të mirën tuaj çka në qiej e çka në tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta, e megjithatë prej njerëzve ka që polemizojnë çështjen e All-llahut duke mos pasur as dituri, duke mos qenë i udhëzuar dhe duke mos pasur libër të ndritshëm.

Dhe kur atyre u thuhet: "Pasoni atë që e shpall All-llahu" ata thonë: "Jo, ne ndjekim atë që gjetëm te prindërit tanë!" E edhe sikur djalli t'i kishte thirrur ata në dënimin e zjarrtë!

(Kur'an, 31:20-21)

Këto ajete tregojnë se të pafetë, edhepse i shohin dëshmitë e Zotit, "prapë diskutojnë për Zotin", që dmth., ata angazhohen në luftë kundër fesë së Tij. Arsyeja për këtë është se këta njerëz të pafé pasojnë atë që iu kanë lënë baballarët e tyre, që dmth., janë të të zhytur në një tradicionalizëm të verbër.

Dukshëm, tradicionalizmi definon shumë mirë historinë dhe filozofinë e Masonerisë siç kemi parë në fillim të këtij libri.

Në të vërtetë, tradicionalizmi është fjalë që përshkruan shumë bukur Masonerinë, pasi Masoneria nuk është asgjë tjetër përpos një "organizatë traditash", që i ka rrënjët thellë në kohën para mijëra

vjetësh në shoqëritë pagane. Ajo verbërisht pason traditat nga Egjipti i vjetër, të faraonëve dhe magjistarëve të tyre, filozofëve të Greqisë antike, hermeticistëve, kabalistëve, templierëve, rosikrusantët dhe masonëve para tyre. Është me rëndësi që të njihet për së afërmi ky tradicionalizëm. Në llozhat moderne masonike, legjendat, simbolet dhe fjalët janë të vjetra me mijëra vjet, që ende janë në përdorim. Përkundër faktit se gati të gjithë masonët kanë nivel të lartë edukimi dhe janë në pozitat më të larta në shoqëri, ata organizojnë ceremoniale në të cilat marrin shpatat e përaruara dhe kafka në duar, murmurojnë fjalë nga Egjipti i vjetër qëndrojnë pranë shtyllave të modelit të tempujve të Egjiptit të vjetër në paraskena të argjendta, me dorëza të bardha dhe bile edhe me disa kostume të çuditshme si dhe bëjnë betime të forta. Nëse ndonjë person që nuk ka fare njohur për Masonerinë gjendet në llozhat e tyre, ata do të mund të mendonin se janë duke e xhiruar ndonjë sekuencë të ndonjë filmi komik, dhe me siguri nuk do të mund të përmbahej e të mos të qeshte kur do t'i shihte masonët gjatë kohës së ceremonialit të pranimit, ku ata që pranohen sytë i kanë të mbyllur me shami, litarin rreth fytit dhe ecin andej këndej me një këmbë zbathur. Por masonët duke jetuar në një botë sekrete, e marrin këtë ceremonial shumë normal, dhe gjejnë kënaqësi psiqike në atmosferën mistike të llozhave të tyre. Pas këtyre ceremonialeve, ata ulen dhe bisedojnë me njëri tjetrin mbi besimin e tyre se "atomet kanë shpirt dhe bashkohen që të formojnë organizmat e gjalla", dhe se "bota mban drejtpeshimin e vet nga intelegjenca e fshehur në magmë", apo se "nëna natyrë n'a ka krijuar neve shumë mirë" si dhe mite tjera. Kjo maskaradë prezentohet vetëm që të ruhet tradita, dhe është aq qartë i paarsyeshëm se është shumë habitëse se sistemi i tillë i ideve mund të jetë ende gjallë dhe të mbrohet.

Dashuria e verbër e masonëve ndaj traditës së tyre qartë tregon rëndësinë e madhe që ata i japin idesë së "pikës referuese". Pika referuese është një vend apo objekt që simbolizon diçka që ka rëndësi apo domethënie historike. Në gjuhën masonike, pikat referuese janë rregullat që janë transmetuar pa ndryshime që nga themelimi i organizatës. Pse ata nuk u ndryshuan? Masonët ofrojnë një përgjegje interesante lidhur me këtë pyetje. Një artikull botur në Mimar Sinan më 1992, thotë:

Pikat referuese të Masonerisë janë ligje të vjetra që janë transmetuar nga gjenerata në gjeneratë. Askush nuk e di kur janë paraqitur për herë të parë dhe askush nuk ka të drejtë që t'i ndryshojë apo t'i anulojë. Ato janë janë ligje të shkruara dhe të pashkruara të shoqërisë. Ligjet e pashkruara mund të mësohen vetëm nga ritualet dhe ritet në llozha. Ekzistojnë gjashtë ligje të shkruara që mund të gjenden me titull "Obligimet e frankmasonit" të botuara për herë të parë në Kushtetutën e Anglisë më 1723. 117

Le t'i studiojmë këto fjalë nga afër: organizata e quajtur Masoneri ekziston. Antarët e kësa organizate për shekuj me radhë kanë aplikuar një numër ligjesh që nuk dihet prej nga e kanë prejardhjen. Përveç kësaj, ata janë mjaft të bindur se askush nuk i ka ndryshuar këto ligje. Askush nuk është i gatshëm që të pyes pse ata i aplikojnë këto ligje!... Dhe, për hir të aplikimit të këtyre ligjeve, ata janë të gatshëm që t'i injorojnë zbulimet shkencore dhe përfundimet e tyre logjike. A mund të jetë kjo ajo shoqëri që i ndjek rrugën e "arsyes" dhe "shkencës"?

Pjesa tjetër e artikullit të cituar më lartë, konstaton germë për germë se një mason duhet që t'iu bindet ligjit pa pyetur për to:

Sipas mendimit tim, pika referuese është një pjesë e vjetër e masonerisë që kurrë nuk kam qenë kurreshtar në lidhje me origjinën e tyre as në llozhë e as në aktivitetin tim si frankmason. Nuk më ndihmon as analiza pse duhet të ndihem kësisoji por mendoj se nëse struktura e Frankmasonerisë nuk është ndryshuar nuk do të zgjaste... jetoj me të pa bërë ndonjë përpjekje të veçantë. 118

Si mundet një organizatë e përbërë nga pasuesit e vet që besojnë dhe i binden ligjeve për origjinën e të cilave ata nuk shfaqin fare kurreshtje konsiderohet si e arsyeshme?...

Sigurisht, pohimi i Masonerisë se janë të arsyeshëm dhe shkencor është krejtësisht e zbraztë. Sikurse materialistët tjerë, edhe ata, përkundër faktit se ata përdorin vazhdimisht termet e arsyes dhe shkencës, duke këmbëngulur në mbrojtjen e një filozofie e cila nuk ka përkrahje logjike apo shkencore, dhe largohen nga faktet që shkenca ka zbuluar. Para së gjithash, ajo çfarë i dërgoi masonët në lajthitje të tillë apo me të vërtetë që i ka magjepsur, është lidhshmëria e tyre e verbër ndaj traditës së tyre.

Kjo tregon se mësimi i Masonerisë është mashtrues. Ajo largon njerëzit nga besimi i tyre në Zot, duke i bërë ata që të bijnë në bestytni duke pasuar ligjet, mitet dhe legjendat e kota. Se çfarë thotë Kur'ani për paganët e Sabas, që braktisën Zotin dhe filluan t'a adhurojnë Diellin, vlen gjithashtu edhe për Masonerinë: Madje takova atë dhe popullin e saj se adhurojnë diellin e jo All-llahun, po djalli ua kishte hijeshuar atë veprim të tyre dhe i kishte shmangur prej rrugës së drejtë, andaj ata nuk gjejnë udhëzim. (Kur'an, 27:24). Masonët mohuan fenë e Zotit dhe e zëvendësuan me një doktrinë të vjetër që ata e zbatojnë me simbole të përaruara dhe elemente mistike.

Përveç kësaj, nuk iu mjaftonte vetëm mohimi i Zotit, saqë ata luftuan kundër fesë së Tij, në një luftë që u angazhuan për një kohë të gjatë.

## VI
## LUFTA MASONIKE KUNDËR RELIGJIONIT

Ekzistenca e masonerisë më së pari u shpall zyrtarisht në Angli më 1717. Para kësaj date, ajo ishte shpërndarë së pari në Angli e pastaj edhe në Francë dhe në pjesën tjetër të Europës, dhe u bë vendtakim kryesor për kundërshtarët e religjionit. Shumë masonë europianë u takonin nëpër llozhat masonike, duke shpallur veten si "mendimtarë të lirë," me të cilën ata mendonin se nuk pranonin fetë hyjnore. Një artikull me titull " Etapat e para të Masonerisë" në Mimar Sinan, thuhet, "Vendi ku masonët takoheshin që të kërkonin të vërtetën jashtë kishës u bë si një ngushëllim." 119

Megjithëse ky grup, ka parë të vërtetën jashta religjionit, ai gjithashtu vendos një antipati të madhe ndaj religjionit. Për këtë shkak, organizata u bë shumë shpejt një qendër e fuqishme që e solli kishën, sidomos kishën katolike në një gjendje të pavolitshme. Ky konflikt në mes të Masonerisë dhe Kishës vazhdoi të rritej, duke lënë shenjat e saj në Europën e shek. të 18-të dhe të 19-të. Masoneria filloi që të përhapej edhe në vendet tjera jashta Europës, në pjesën e dytë të shek. të 19-të, dhe çdo vend që është shfaqur është bërë qendër për filozofi dhe aktivitete antireligjioze.

Artikulli me titull "Politika dhe Frankmasoneria" që u botua në Mimar Sinan, përmban këtë tekst që flet për luftën kundër religjionit:

Duke mos qenë parti politike, Frankmasoneria bëhet e organizuar në fillim të shek. të 18-të si një institut shoqëror me një shtrirje ndërkombëtare e përshtatur me rrymat politike dhe shoqërore. Ashtuqë të ndihmojë sektet në tentimet e tyre që të praktikojnë liri fetare, Frankmasoneria

angazhohej në luftë kundër fuqisë dhe ndikimit të klerit në përpjekje që të arrijnë qëllimin e vetëm që të përmbysin fuqinë dhe ndikimin e kishës në njerëz. Për këtë shkak, më 1738 dhe 1751 ajo u shpall si e pafé nga Papa... Në ato vende ku u adoptuan parimet e lirisë fetare, Frankmasoneria ishte një shoqri sekrete dhe mistike vetëm në emër; në këto vende ishte edhe e injoruar edhe e inkurajuar, antarët themelues nga klasa e mesme dhe zyrtarët e lartë që kishin kohë dhe mjete, dhe zyrtarët udhëheqës shtetërorë duke instaluar nëpër pozita të larta të organizatës së vet. Në vendet jugore ku çdokush duhej të jetë katolik, ata mbajtën karakterin e tyre si të fshehtë, të ndaluar, organizatë revolucionare i prirur për mbikqyrje. Në këto vende njerëzit me karakter të mendimit të lirë, dhe zyrtarët e pakënaqur me administrimin në qeveri, filluan që të hyjnë në llozhat masonike dhe kështu planet revolucionare ishin inicuar dhe drejtuar kundër këtyre regjimeve në Spanjë, Portugali dhe Itali që ishin nën dominimin e Vatikanit.120

Nuk ka dyshim se shkrimtari mason këtu përdor gjuhën që e favorizon organizatën e vet kur thotë se Masoneria lufton kundër dominimit të kishës. Por, kur të shqyrtojmë çështjen më afër, shohim se në shumë vende, “dominimi” i njejtë ishte i volitshëm për regjimet e themeluara apo të mbështetura nga masonët. Prandaj, shumë lehtë mund të dallojmë se pohimi i Masonerisë se lufta kundër “dominimit” është vetëm pretendim apo shtirje. Përkundër faktit se Kisha- pasi krishterizmi u shtrembërua- kishte ruajtur idetë skolastike dhe zakonet shtypëse, armiqësia e Masonerisë ndaj kishës nuk bazohej në këtë por nga urrejtja e traditës monoteiste.

Është e mjaftueshme të shikohet në strukturën e Masonerisë dhe ritet e saj që të kuptohet kjo çështje.

## SHEMBULLI I LOZHËS MASONIKE: “KLUBI I FERRIT”

Ashtu që të kuptohet se si ka qenë e organizuar Masoneria në shek. e 18-të, dhe çfarë ishin synimet e saj, njëra nga gjërat që duhet shqyrtuar ashtuqë të ekzaminohen shoqatat e ndryshme sekrete masonike që u paraqitën në atë kohë. Një shoqatë e tillë ishte “Klubi i ferrit (Hell-fire club)”, që ishte aktive në Angli në mesin e shek.18-të. Struktura masonike e këtij klubi dhe karakterit të tij pagan dhe antifetar, përshkruhet nga shkrimtari Daniel Willens në artikullin e tij “Klubi i Ferrit: Seksi, politika dhe religjioni në Anglinë e shek.18-të”. Ja disa pasuse interesante nga ky artikull të botuar në Gnosis, një e gazetë që merret me traditat e brendshme të Perëndimit:

Në një natë me hënë gjatë sundimit të mbretit anglez George III, antarët shumë fuqishëm të qeverisë së tij, intelektualët e rëndësishëm, dhe artistët me ndikim ndonjëherë mund të shiheshin duke shkuar deri tek lumi Temza (Thames) me gondola deri tek abacia (lloj kishe) e shkatërruar afër West Wycombe. Atje, tingujt e lartë të këmbanave të manastireve të çshenjtëruara, dhe visheshin me mantela të murgjëve dhe kënaqeshin në secilën metodë të mëkatshmërisë, duke e arritur kulmin me festimin e Meshës së Zezë në trupin e lakuriqar të ndonjë gruaje fisnike të shthurur duke u udhëhequr nga famëkeqi Sir Francis Dashwood. Ritet e tyre djallëzore përfundonin, rrethin e brendshëm që dëshironte të shtyejë intrigën gjatë sundimit të Perandorisë Britanike.

Kjo “shoqatë mbinatyrore” siç quhej, stilizohej me veçori gotike, “Vëllezërit murgjë e Shën Francisit të Medmenham,” edhepse ata kishin qenë të përjetësuar në bazë të epitetit të tyre të

popullarizuar "Klubi i Ferrit". Në ato kohëra të thashë e themeve ku kishte më shumë spekulime për aktivitetet e tmerrshëme, si dhe më 1765, kur Charles Johnstone boton një roman me titull Chrysai, apo aventurat e një guineje, që besonte shumë se ka zbuluar sekretet e "murgjive të Medmenhamit"…

…Paraardhës më i rëndësishëm i murgjive është Klubi i Ferrit themeluar rreth vitit 1719 në Londër nga Philipi, Duka i Whartonit (1698-1731). Wharton ishte një politikan prominent i Whigut, frankmason, dhe ateist që e pa qesharake çështjen e fesë me kryesimin e hapur të mbledhjeve festive me kostume solemne... dhe Wharton u bë mason Grandmaster i Llozhës së Madhe të Londrës më 1722…

Deri më 1739, Dashwood ishte në një rrugëtim për në shtëpi. Gjatë rrugës ai u ndal në Firencë që të vizitonte Abbe Nicolinin, dhe e takoi Lady Mary Wortley Montagu... që dëshironte përfundimisht të bashkangjitej... Dashwoodit në Divan Club... Për fat të keq gjërat nuk shkonin mirë për Frankmasonerinë në Itali. Papa Clement XII pak më herët kishte botuar In Eminenti Apostulas Specula, duke ndërsyer inkuizicionin kundër llozhave. Kah vitet e para të 1740-tave, papa vdes, ndërsa Dashwoodi shkoi në Romë për të zgjedhur papën e ri në mënyrë sekrete. Atje ai me shaka maskohet si Kardinal Ottiboni, si njëri ndër prokurorët kryesorë të masonëve, dhe e paraqet atë publikisht në një ritual përqeshës dhe të ndyrë..

"Dhoma e kapitullit" është çelës për të kuptuar aktivitetet e murgjive. Nozullimet e tyre mbetet ende të panjohura, dhe si pasojë mënyra se si është bërë kjo mbetet një mister. Autorët senzacionalë supozojnë se ishte një faltore satanike, edhepse duket më e arsyeshme të konkludohet se ishte shfrytëzuar për ceremoniale masonike. John Wilkes, një antar i rëndësishëm

i qarkut të Medmenhamit që nuk u bë mason deri kur u nda nga grupi i tij, duke u ankuar dhe duke e diskredituar një ish shok të tij: “Asnjë sy laik nuk ka guxuar që të depërtoj në misteret e Eleusinianit anglez të dhomave të kapitullit, ku murgjit e grumbulluar në të gjitha rastet solemne, ritet shumë sekrete janë performuar dhe pijet alkoolike u derdhnin me madhështi përpara BONA DEA-s”... Horace, djali i Sir Robert Walpole, njëri ndër armiqët më të mëdhenj politik të Dashwoodit dhe sigurisht i pamësuar me abaci, përqeshej: “Pa marrë parasysh se çfarë ishin doktrinat e tyre, praktikimi i tyre ishte rigorozisht pagan: Bacchusi dhe Venusi ishin zotërat që ata publikisht më së shumti i sakrifikoheshin; si dhe nimfat dhe fuçitë që vendoseshin në sfonde të festivaleve të kësaj kishe të re, informonin mjaft rrethin për kompleksin e këtyre oshënarëve.”...

Katalogu i antarësisë së murgjive të Medmenhamit më nuk ekziston, dhe nëse ndonjëherë ka ekzistuar, por emrat që besohet të jenë përfshirë në këtë grup janë vëllau i Dashwoodit, Joh Dashwood-King; John Montagu, Earli nga Sandwichi; John Wilkes; George Bubb Dodington, Baron Melcombe; Paul Whitehead; dhe një koleksion i zotërinjëve më të vegjël lokalë dhe profesionistë... dmth. një grup njerëzish që mjaftonte që në sytë e publikut të krijojnë skandal.

E tërë çështja kryesore që Dashwoodi vazhdoi të ushtrojë ishte çështja e fesë... Një interpretim më i sofistikuar mund të përmbledhet nga thashethemet e magjisë seksuale, librës kabaliste të abacisë, shëmbëllimi periodik i Harpokrateve, lidhjes së parëndësishme të Dashwoodit me Rendin masoik të Tempullit, dhe natyrisht motoja telemike në abacinë e Medmenhamit që konkludon se Klubi i Ferrit ishte një manifestim më i hershëm i “Crowleyanity”-së. Një çasje më e përmbajtur do të gjej kontaktet masonike të Dashwoodit dhe nxjerr, me sa duket me drejtësisht, se “dhoma e kapitujve” ishte një tempull masonik. 121

Arsyeja për përfshirjen e këtij citati të gjatë është që të fitohet një ide për atmosferën në të cilën Masoneria e shek.18-të zhvillohej dhe ndikimin që e ka pasur tek njerëzit. Masoneria lind, si një organizatë tërheqëse sekrete dhe interesante, kundërshtimi që i bëhej besimeve të përgjithshme të shoqërisë siguronte njëlloj kënaqësie psiqike tek antarët e vet. Karakteristikë themelore e riteve masonike, siç u cek edhe në citatin e mësipërm, ishte shenjtërimi i simboleve dhe koncepteve pagane në vend të atyre tradicionale të feve monoteiste. Në këtë mënyrë, ata që bëheshin masonë, dhe ia kthenin shpinën krishterizmit, bëhehin paganë, edhepse nuk ishte e domosdoshme që të adoptohej paganizmi si besim, por së paku kjo shprehej me adoptimin e simboleve të saj.

Sidoqoftë, Masonerisë nuk i mjaftonte vetëm praktikimi i cermonialeve të çuditshme; por ajo pasonte edhe strategjinë e planifikuar që largojë Europën nga fetë hyjnore, dhe t'i joshë në paganizëm. Në kapitullin e ardhshëm do t'i shqyrtojmë disa çaste të veçanta të historisë europiane, vend pa vendi, dhe t'i përcjellim gjurmët e ksaj lufte masonike kundër religjionit. Vendi i parë që duhet t'a shqyrtojmë është Franca.

## LUFTA KUNDËR RELIGJIONIT NË FRANCË

Në veprat e mëhershme kemi shqyrtuar rolin e rëndësishëm që Masoneria luajti në Revolucionin Francez. Një numër i madh filozofësh të Iluminizmit, posaçërisht ata me pikëpamje më të qarta antifetare, ishin masonë. Jakobinët, të cilët përgaditën skenën e revolucionit dhe që u bënë ndër udhëheqësit, ishin masonë. 122

Roli i luajtur nga masonët në revolucion pranohet nga një "agjent provokator" i quajtur konti Cagliostro. Calgliostro ishte arrestuar nga inkuizicioni më 1789, dhe ka pranuar disa fakte të rëndësishme gjatë marrjes në pyetje. Ai filloi me deklarimin se masonët përgjatë Evropës kanë planifikuar një zingjir revolucionesh. Ai tha se qëllimi kryesor i masonëve ishte që të shkatërrojë papacinë apo që të marrin pushtetin. Në rrëfimin e tij, Cagliostro pranon se bankierët çifutë kanë përkrahur financiarisht të gjitha këto aktivitete revolucionare, dhe se paratë çifute luajtën gjithashtu rol të rëndësishëm në Revolucionin Francez. 123

Revolucioni Francez ishte në parim një revolucion kundër fesë. Në përpjekjet e caktuara të revolucionarëve që t'a heqin qafe klerin, gjithashtu edhe artistokroacinë, shumë klerikë u vranë, u shkatërruan institutet fetare, si dhe vend-adhurimet. Jakobinët dëshironin që të shkatërrojnë krishterizmin në tërësi, dhe që t'a zëvendësojnë me një besim pagan të quajtur "religjion i arsyes". Por, për një kohë të shkurtër, ata humbën kontrollin mbi revolucion kështuqë Franca u gjend në një kaos total.

Misioni i Masonerisë në atë vend nuk mbaroi vetëm me revolucion. Kaosi që erdh si rezultat i revolucionit u rregullua kur erdh Napoleoni në pushtet. Por, ky stabilitet nuk zgjati shumë.

Ambicjet e Napoleonit për të pushtuar tërë Evropën vetëmsa e solli atë në fund të sundimit të tij. Mëpastaj, konflikti në Francë vazhdoi në mes të monarkistëve dhe revolucionistëve. Më 1830, 1848 dhe 1871, ndodhën edhe tri revolucione tjera. Më 1848, u formua "Republika e dytë"; më 1871 u themelua "Republika e tretë".

Masonët ishin shumë aktivë gjatë kësaj periode të trazirave. Qëllimi i tyre kryesor ishte që të dobësohej Kisha dhe insitituciionet e saja fetare, të zhvleftësojë vlertat e religjionit dhe ndikimin e

ligjeve të saja në shoqëri, si dhe të shfuqizojë edukimin fetar. Masonët e quanin antiklerizmin si qendër të aktiviteteve të tyre shoqërore dhe politike.

Enciklopedia katolike jap informatë të rëndësishme për msionin antifetar të Grand Orientit, siç njihej masoneria franceze:

Nga dokumentet zyrtare të masonerisë franceze kryesisht nga "Buletini" zyrtar dhe "Compte-rendu" të Grand Orientit është dëshmuar se të gjitha masat antiklerike të aprovuara në parlamentin francez ishin urdhëruar më herët në llozhat masonike dhe ekzekutuar nën udhëheqjen e Grand Orientit, qëllimi i pranuar i të cilit ishte që në Francë të ketë çdogjë dhe çdokend nën kontroll. "Thashë në kuvend më 1898", thotë deputeti Massé, folës i kuvendit më 1903, "se është detyra më e lartë e frankmasonerisë që të ndërhyj çdo ditë shumë e më shumë në luftërat politike dhe laike." "Suksesi (në luftimet antiklerike) në masë të madhe është për shkak të frankmasonerisë, për shkak të shpirtit, programit, metodave të saj që ka triumfuar."'"Nëse do të themelohej Blloku, kjo do t'ia kishte borgj frankmasonerisë dhe disciplinës së mësuar në llozha"..." Neve n'a nevojitet syqeltësia dhe mbi të gjitha besimi i ndërsjellë, nëse ende është i pakryer dhe se duhet kryer punën tonë. Kjo punë, e dini... lufta antiklerike, ende vazhdon. Republika duhet t'a largojë vetveten nga kongregacionet fetare, duke i fshirë nga faqja e dheut me një goditje të fuqishme. Sistemi me gjysëm masa çdokund është i rrezikshëm; kundërshtari duhet që të asgjësohet me vetëm një goditje." 124

Enciklopedia katolike vazhdon vlerësimin e luftës së masonerisë franceze kundër religjionit: Në të vërtetë të gjitha reformat masonike "antiklerike" u bënë në Francë që nga viti 1877, siç ishte laicizmi i arsimit, masat kundër shkollave private të krishtera dhe shoqatat bëmirëse, shuarje të

urdhërave fetare si dhe grabitjen e pronave kishtare, gjoja se ka arritur kulminacioni i një riorganizimi antikrishterë dhe jofetare të shoqërisë njerëzore, jo vetëm në Francë por edhe në tërë botën. Prandaj frankmasoneria franceze, si bartës standard i gjithë frankmasonerisë, pretendon që të hap periudhën e artë të republikës universale masonike, duke përfshirë në vëllazërinë masonike gjithë njerëzit dhe të gjitha kombet. "Triumfi i Galileanit," tha kryetari i Grand Orientit, senatori Delpech, më 20 shtator 1902, "ka zgjatur që njëzet shekuj. Por tani e ka radhën që të vdes... Kisha katolike, e themluar sipas mitit të Galileut, filloi të kalbet me të shpejtë pikërisht në ditën kur u themelua Shoqata masonike" 125

Me fjalën "galilean" masonët mendojnë në Jezunë, pasiqë sipas Ungjillit, Jezuja ishte lindur në qytetin palestinez, Galile. Prandaj, urrejtja e masonëve ndaj kishës është urrejtja e shprehur e tyre ndaj Jezusë dhe të gjitha feve monoteiste. Ata mendojnë se ata kanë shkatërruar efektin e feve hyjnore me filozofitë materialiste, darviniste dhe humaniste që ata i themeluan në shek. e 19-të dhe e kthyen Evropën në paganizmin e parakrishterë.

Kur janë shqiptuar këto fjalë më 1902, një varg ligjesh miratohen në Francë duke e zgjëruar shtrirjen e kundërshtarëve të fesë. U mbyllën 3.000 shkolla fetare dhe u bë e ndaluar çdo arsimim fetar në shkolla. Shumë klerikë u arrestuan, disa ikën në ekzil dhe njerëzit fetarë filluan të konsideroheshin si qytetarë të rendit të dytë. Për këtë shkak, më 1904, Vatikani prishi të gjitha mardhëniet diplomatike me Francën por kjo nuk e ndryshoi qëndrimin e këtij vendi. Kjo mori me qindra mijëra jetëra të francezëve në luftë kundër ushtrisë gjermane në Luftën e parë botërore para se arroganca e vendit ishte zbutur dhe filloi prapë që të pranoj rëndësinë e vlerave shpirtërore.

Siç pohohet në Enciklopedinë katolike, lufta kundër fesë, që nga Revolucioni francez e deri në shek. 20-të, ishte bërë nga "masat antiklerike që ishin aprovuar në parlamentin francez" që "ishin urdhëruar më herët në llozhat masonike dhe ekzekutuar nën udhëheqjen e Grand Orienti". 126 Ky fakt është i qartë nga shkrimet masonike. Për shembull, nga citimi i një botimi turk të " Fjalimit të bërë nga vëllau Gambetta më 8 korrik 1875 në llozhën Clémente Amitié", shkruan:

Kur spektri reaksionar kërcnonte Francën, dhe doktrinat fetare dhe idetë e prapambetura shkuan në ofenzivë kundër parimeve dhe ligjeve moderne, në gjirin e organizatave industriale dhe largpamëse siç ishte masoneria që i përkushtohej parimeve të vëllazërisë, gjetëm forcën dhe shpëtimin në luftën kundër pohimeve ekstravagante të kishës, ekzagjerimeve të saja qesharake dhe teprimeve të rëndomta... duhet të jemi të kujdesshëm dhe të vazhdojmë luftën. Në mënyrë që të themelojmë idetë e rendit njerëzor dhe të përparojmë, të qëndrojmë në atë mënyrë që mburojat tona mos të thyhen. 127

Do të vërehet se literatura masonike në mënyrë konsistente paraqet idetë e veta si "largpamëse" derisa akuzon njerëzit fetarë se janë "të prapambetur". Sidoqpftë, kjo është vetëm një lojë me fjalë. Termi "spektri reaksionar" i përmendur në citimin e mësipërm, është diçka që fetarët e sinqertë gjithashtu kundërshtojnë , por masonët e shfrytëzojnë këtë që të bëjnë me gisht në fenë e vërtetë në përpjekjet e tyre për t'i larguar njerëzit nga ajo. Përveç kësaj, duhet prapë që të theksohet se fiozofia materialiste- humaniste e përqafuar nga masonët është me të vërtetë paragjykuese , dhe me ide të prapambetura, që vazhdon me civilizimet pagane të Egjiptit të vjetër dhe Greqisë së vjetër.

Prandaj, masonët përdorin shprehjet si” largpamje” dhe” prapambeturi” nuk ka bazë në realitet. Në të vërtetë, është e pabazë për shkak se konflikti në mes masonëve dhe fetarëve nuk është asgjë më tepër se përjetësimi i konfliktit mes dy ideve që kanë ekzistuar edhe më herët në etapat e hershme të historisë. Është religjioni ai që shpall këto ide: se humaniteti ishte krijuar me vullnetin e Zotit dhe se njerëzit janë të obliguar që t'a adhurojnë Atë. Kjo është e vërteta. Ideja e kundërt, se njerëzit nuk janë të krijuar por jetojnë jetë të kotë dhe pa qëllim, është e propozuar nga ata që e mohojnë ekzistencën e Zotit. Kur të kuptohet në mënyrë të drejtë, mund të shihet se përdorimi sipërfaqësor i termeve “prapambeturi” dhe “largpamësi” nuk ka bazë.

Me përdorimin e termit “përparim”, masonët kërkojnë që të shkatërrojnë fenë. Enciklopedia katolike thotë:

Këto janë mjetet parimore që mendohet të jenë (për Frankmasonerinë):

Të shkatërrojnë në mënyrë radikale me persekutim të hapur ndaj Kishës apo me një sistem jo të sinqertë dhe hileqar për ndarjen e Shtetit me Kishën, tërë ndikimin shoqëror të Kishës dhe të fesë, me qëllimi i quajtur “klerikalizëm”, dhe, sa është e mundur, të shkatërrojë Kishën dhe çfarë është e vërtetë, dmth., një fé mbinjerëzore, që është më shumë se një kult i paqartë i atdheut dhe humanitetit,

Të laicizojë, apo shekullarizojë, me një sistem jo të sinqertë dhe hileqar i “unsektarianizmin”, në tërë jetën publike dhe private dhe, mbi të gjitha, edukimin dhe këshillat popullore. Siç është kuptuar “unsektarizmi” nga partia e Grand Orientit, është një sektarizëm (fanatizëm) antikatolik e bile edhe antikrishterë, ateist, pozitivist apo edhe agnostik me maskë të unisektarizmit. Liria e mendjes dhe vetëdijës se fëmijëve duhet zhvilluar sistematikisht në fëmijët e shkollës dhe të

mbrohet, sa është e mundur, kundër të gjitha ndikimeve turbulluese, jo vetëm nga Kisha dhe nga priftërit, por gjithashtu edhe nga prindërit e vet fëmijëve, nëse është e nevojshme, bile edhe me mjete detyruese morale dhe fizike. Partia e Grand Orientit e konsideron atë si të domosdoshme dhe mënyrë shumë e sigurtë deri tek themelimi përfundimtar i republikës universale shoqërore... 128

Mund të vërehet se Masoneria e ka aktivizuar një program, nën emrin e "çlirimit të shoqërisë", qëllimi i së cilit është që të çrrënjosë fenë, një program që ende është duke implementuar. Kjo nuk duhet që të n'a hutojë me modelin që përpiqet që të siguroj mundësi për secilin qytetar që të praktikojë fenë e vet lirshëm, pa marrë parasysh përcaktimin fetar. Ose më mirë, modelin të parashikuar nga Masoneria është një model tru-shpërlarës, modeluar për të shuar plotësisht fenë nga shoqëria si dhe nga mendje e individëve dhe, nëse është e nevojshme, t'i persekutoj pasuesit e saj.

Në secili vend ku është themeluar Masoneria përpiqet që t'a aktivizojë këtë program, edhepse në një mënyrë pajtohet me kulturën dhe kushtet që dominojnë në atë vend.

Një vend i tillë është Gjermania.

## FUSHATA ANTIFETARE NË GJERMANI: “*KULTURKAMPF*”

Para 150 vjetëve, nuk ekzistonte Gjermania fare. Territori që tani njihet si Gjermani sundohej nga një numër principatash. Më e madhja ishte Prusia, që përfshinte pjesën lindore të Gjermanisë së sotme dhe një pjesë të madhe të Polonisë. Në vitet 1860-ta, Prusia filloi që të bashkojë shtetet tjera të vogla gjermane në një shtet dhe formoi Perandorinë Gjermane më 1871. Sunduesi i këtij shteti të ri ishte kryeministri i Prusisë dhe Kancelar i Perandorisë së re gjermane, Otto von Bismarck.

Bismarcku ishte një burrështetas i suksesshëm, sidomos në politikën e jashtme, por nuk pati sukses edhe në punët e brendshme të shtetit. Njëra ndër arsyet për këtë gjë ishte një grup i vogël i intelektualëve të njohur si “Liberalët nacionalë”, të ngjajshëm me antiklerikët francezë, që adoptuan politikën antifetare. Në mënyrë që të arrihej bashkimi i Gjermanisë, Liberalët nacionalë besonin se është e domosdoshme që t’i largojnë njerëzit nga sensi i bashkimit jashta kufijëve të tyre, dhe panë mardhënjen mes një të tretës së popullatës dhe Papës si pengesën më të madhe. Inkurajuar nga liberalët, Bismarcku u lëshua në fushatën antikatolike të quajtur Kulturkampf, apo “lufta kulturore”. Kjo ishte përshkruar si luftë mbi koontrollin e intelektit të gjermanëve. 129

Gjatë Kulturkampfit, katolikët, e posaçërisht në jug të Gjermanisë, përjetuan tirani. Më 1872, në pajtim me ligjin që u aprovua, të gjithë priftërinjët jezuitë në vend ishin rrethuar në një natë të vetme dhe iu konfiskuan institutet e tyre. Në pëlqim me “ligjin e majit” (maigesetze) aprovuar më 1873, të gjithë priftërit që punonin në qeveri u pushuan nga puna, Kishës iu ndalua përzierja në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesat dhe arsimin, si dhe temat gjatë predikimit. Një numër kryepeshkopësh ishin arrestuar dhe 1300 kisha mbeten pa priftër. Por, për shkak se këto taktika

gjeneruan reaksion të fortë në mesin e katolikëve të këtij vendi kundër qeverisë, Kulturkampf u zbut. Bismarcku injoroi sygjerimet e liberalëve nacionalë, të cilët e përzien atë në këtë fushatë, dhe ngadalë e shtrëngoi Kulturkampf dhe përfundimisht u pezullua krejtësisht. Krejt kjo fushatë rezultoi me tirani ndaj katolikëve të devotshëm gjermanë, dhe shkatërroi sensin për mirëqenien sociale të vendit. Sot shumë historianë besojnë se ishte një fiasko që shkatërroi sensin gjerman të sigurisë shoqërore. Përveç kësaj, pas Gjermanisë, vala e këtij Kulturkampf-i përfshiu edhe Austrinë, Zvicrën, Belgjikën dhe Holandën, duke shkaktuar tension të madh shoqëror në këto vende.

Gjë që duhet përmendur është se intelektualët masonikë ishin ata që joshën Bismarckun në këtë politikë. Enciklopedia katolike thotë:

